

VITO KOÇI

# vështrim i kthjellët

88H-32

K 77



VTIO KOQI

MECH I TRIN I KTHUELL ST

NOV 10



STIPIA FLOXLE-OR-KAHLI BRAWOOL-

1.

Kryeinxhinieri i uzinës, Petro Lisi, kishte shumë punë atë pasdite. Derën e zyrës e mbante të kyçur dhe telefonin e kishte hequr nga priza. I përkulur mbi tryezë, shfletonte dosje pas dosjeje, bënte anëshkrime në shkresa; mbante shënime në blokun kalendar dhe pinte pareshtur cigare.

Kur mbaroi, e ndjente kokën të rëndë dhe i digjnin sytë, por ishte i kënaqur që u dha zgjidhje gjithë atyre problemeve. U shtriq, fërkoj sytë me pëllëmbë, u end disa herë nëpër zyrë, pastaj iu afrua dritares.

Sapo kishte pushuar shiu dhe asfalti i sheshit të fabrikës kishte një shkëlqim të mugët. Portieri po i çelte portën e madhe prej hekuri një kamioni të ngarkuar. Përtej kangjellave priste një vajzë e re. Qielli kishte filluar të çelej dhe andej nga përrëndimi flakëronte me ngjyra të purpurta.

Petros i pëlqeu ajo pamje. Ju duk sikur i derdhi në brendësi një farë freskie dhe gjallërie. U largua nga dritarja dhe vështroi syprinën e tavolinës.

«Duhet futur dokumentat në kasafortë!» mendoi dhe iu vu punës.

I renditi nëpër dosje kontratat, evidencat e realizimit të planit, raportet dhe shkresat e tjera, që i kishin shkaktuar aq mund gjithë pasditen. E mbajti një çast në dorë vendimin e dhënë në favor të uzinës së tyre nga arbitrazhi, që e kishte gëzuar së tepërmi, pastaj e vuri bashkë me të tjerat.

Kur çeli kasafortën, i vajtën sytë tek një dosje e vjetër, jeshile, që dergjej në raftin e fundit. E shfletoi, vështroi skicat, fletët e mbushura me llogaritje, pastaj e mbylli me një farë keqardhjeje. Ishte projekti i papërfunduar i një shpikjeje, për të cilën kishte punuar me zell kohë më parë, kur nuk ishte akoma kryeinxhinier.

Mbylli kasafortën, e dyllosi dhe u ndie i lehtësuar, duke vështruar syprinën e boshatisur të tavolinës. Kishte mbetur edhe gjysmë ore nga orari i punës. U kujtua se Andrea, inxhinieri përgjegjës i repartit të tretë, e kishte kërkuar disa herë atë ditë. Vendosi ta thërriste. Ngriti receptorin e telefonit, mori dezhurnin dhe e urdhëroi ta lajmëronin Andean.

Inxhinier Andrea erdhi menjëherë. Ishte i gjatë, me fytyrë të hequr, ballëlartë dhe me sy të vegjël, por të ndritshëm. Në të vërtetë, nuk ishte aq i ri sa dukej. Kishte kohë që punonte në uzinë. Kur Petrua qe bërë kryeinxhinier, e kishin emëruar në vend të tij. Reparti që drejtonte ishte ndër më kryesorët.

— Ç'problem kishe me mua? — e pyeti Petrua, pa e ftuar të ulej.

Andrea bëri sikur nuk e vuri re këtë dhe u ul.

— Desha të bisedojmë për riorganizimin e repartit të tretë — tha, duke mbështetur pëllëmbën mbi dosjen që kishte vënë përpara.

— Çfarë, riorganizimin e repartit të tretë?! — u çudit Petrua. — Kujt i shkrepni kjo?

— Neve të repartit! — tha Andrea. — Është e nevojshme. E kemi diskutuar disa herë në mbledhjet tona. Bile të kam vënë në dijeni.

— Nuk më kujtohet!

— Organizimi i tanishëm nuk u përgjigjet kërkesave të kohës! — vazhdoi Andrea.

— Ashtu, hə! — ja bëri Petrua, me ironi.

Ai e kishte ngritur vetë atë repart. Në fillim me makineri të pakta, pastaj duke e plotësuar ca e nga ca. Reparti që rritur nën sytë e tij, si një foshnje. Ishte puna për të cilën ai krenohej më tepër. Dhe ja, tani po dilte një tjetër që donte t'ja hidhte poshtë veprën e tij.

— Me sa di unë, gjer tani reparti i tretë ua ka dalë mbanë me nder gjithë detyrave të planit, bile edhe detyrave suplimentare — tha.

— Me kosto të lartë dhe me shumë përpjekje! — ja priti Andrea. — Po të riorganizohet, mund të japë rreth pesëdhjetë përqind më shumë nga ç'jep. Kjo është gjë e madhe, po të marrim parasysh sa janë rritur kërkesat ndaj prodhimeve të këtij reparti.

«Sa i pëlqeka mendja e vet! — mendoi Petrua. — Me siguri, ky e ka shpikur çështjen e riorganizimit dhe ka cytur të tjerët pastaj. Dashka të dali më i zgjuar se ne!»

— Akoma s'kemi marrë frymë nga ngritja e repartit special dhe ju dashkeni t'i futemi një punë të tillë! — tha, duke vështruar poshtë. — Aq më tepër se është fundi i vitit dhe duhet menduar në radhë të parë për realizimin e planit.

— Por është e nevojshme! — nguli këmbë Andrea. — Realizimi i planit nuk pengohet. I kemi bërë llogaritë.

— Tani uzina është rritur shumë. Kemi mjeshtra të zotët, inxhinierë në çdo repart dhe plot punëtorë të specializuar. Kurse unë jam kaq i zënë me punën drejtuesel!»

Kaloi më tej, duke u ruajtur se mos njolloste pardesynë. Shkëmbeu pak fjalë me inxhinierin e ri të repartit. Pothuaj nuk i dëgjoi treguesit mbi realizimin e planit.

«Nesër në mëngjez do m'i sjellin në zyrë!» — mendoi.

I pëlqente ta ndjente veten të rrëmbyer në atë valë zhurme, ku nuk dëgjohej zilja e bezdisshme e telefonit dhe fëshfëritja e shkresave. Duke vështruar atë mori makinerish dhe punëtorësh të përkulur pranë tyre, duke dëgjuar tingëllimat e panumërta metalike, duke kujtuar sa e vogël dhe primitive ishte kjo uzinë dikur, e ndjeu veten krenar për punën që kishte bërë dhe për faktin se tani ishte kryeinxhinieri i saj.

Kur doli në rrugë, ajo iu duk tepër e qetë. Nuk e priti autobuzin urban. I pëlqeu më mirë të ecte në këmbë. Me gjithë punën e lodhshme të pasdites, e ndjente veten mirë dhe të gëzuar. Bile iu duk e çuditshme pse ishte i trishtuar një kalimtar, i cili duke kaluar pranë tij, e çiku pa dashur me bërryl. Për një çast iu kujtua propozimi i Andreas, i cili e kishte pezmatuar disi, por menjëherë e flaku nga mendja, duke thënë me vete «hajt, se do rregullohet dhe ajo punë!»

Gjallëria karakteristike e qytetit në mbëmje, njerëzit që mbushnin trotuarët, që hynin e dilnin nëpër dyqane ose qëndronin para vitrinave të ndriçuara, siluetat e klientave pas xhamave të lokaleve, makinat që kalonin rrugës, të gjitha këto iu

dukën të bukura, plot gjallëri dhe optimizëm. I përshëndeste me qejf të njohurit dhe ndjente krenari që ishte kaq i njohur.

2.

Petrua qe shtrirë në divan dhe po thithte me ëndje një cigare. Ndjehej aq mirë pas banjës dhe pas darkës së shijshme që i kishte servirur e shoqja! E kishte pushtuar një plogështi e këndshme, aq sa nuk i bëhej për asgjë. Librin e porsafilluar e kishte lënë të çelur mbi gjoks dhe po ndiqte me sy dredhat e tymit të cigares.

Ani, e shoqja, thurte fanellë në kolltukun pranë sobës, kurse Flora, e motra, lexonte e përqëndruar një dispensë të trashë. Në dhomë ishte pothuaj qetësi. Radion e kishin ulur, aq sa mezi dëgjoheshin meloditë. Lavjerësi i sahatit të murit lëshonte një «tik-tak» monoton. Binte erë patate dhe mish të zier. Mbi sobë po vlonte dreka për të nesërmen. Heraherë Ani ngrinte kapakun e kuisë dhe kontrollonte gjellën.

«Sa mirë, sa mirë që është!» — tha me vete Petrua, duke lëshuar një shtëllungë të gjatë tymi. I vajtën sytë tek korniza që ndodhej mbi kreun e divanit, në të cilën qe vënë një fotografi e zverdhur nga koha. Ishte e vetmja fotografi e prindërve.

«Të shkretët, nuk patën fatin t'i arrinin këto ditë! — mendoi. — Dhe sa e vështirë qe rruga që na solli gjer këtu!»

Atij nisi t'i parakalojë para syve të mendjes, si në një film të përshpejtuar, gjithë e kaluara.

«... Sa të gjatë dhe të largët më duken vitet e fëmijërisë! Kujtimet e tyre të hershme, disa më të turbullta e disa më të kjarta, përbëjnë një lëmsh që tani s'ja gjej dot fillin.

Nga fshati mbaj mend vetëm një qen të madh, të zi, me veshë të varura dhe bisht të gjatë, të cilit i trembesha së tepërmi. Se kur zbritëm në qytet, nuk më kujtohet.

Im atë, si mbeti pa tokë e pa katandi, e la fshatin, me shpresë që të gjente ndonjë punë në qytet. Kur kishte punë, unë e shikoja vetëm në darkë. Kthehej i lodhur, me rrobet aq të ndotura, sa kur ja lante nëna, nxirrnin ujë të turbullt. Binte e flinte bashkë me ne dhe të nesërmen dilte që pa gdhirë. Kur nuk kishte punë, sorollatej nëpër shtëpi i zyrtë dhe grindej për asgjë. Në këto raste unë zija një qoshe dhe s'ma mbante të bëja as gëk.

Nëna, veç punëve të shtëpisë, lante edhe rrobet e botës. Mua më vinte inat, kur ja sillnin ato bohçet e mëdha, se lodhej shumë me to. Por edhe kur nuk i sillnin, ajo dukej e pezmatuar.

Kur vajta në shkollë, e kuptova më mirë sa të varfër ishim. Në klasën tonë, unë mbaja robet më të vjetra dhe në pushimin e madh haja vetëm bukë me qepë. Megjithëse merrja nota të mira, drejtori i shkollës nuk më nxirrte asnjëherë të dalluar përpara klasës.

Kur isha në klasën e tretë, u bëra me motër. Qante shumë dhe nuk më linte të mësoja, por megjithatë e doja dhe gëzohesha kur nëna, që kishte shumë punë, ma besonte mua. Atëhere e merrja hopa dhe luaja me të.

... Si tani më kujtohet ajo ditë, kur na vdiq babai. Sapo kisha mbaruar shkollën fillore. Në mën-



gjez doli nga shtëpia mirë e shëndoshë, por s'u kthye i gjallë. E kishte zënë rrota e fabrikës, ku punonte. Dikush erdhi e i tha nënës dhe ajo zuri të lebetitej. Ne, fëmijëve na çuan tek shtëpia e fqinjit, po unë dola fshehurazi dhe e pashë kur e sollën tim at. E mbanin katër burra në krahë. Ai e kishte kokën të lidhur me fasha të bardha dhe fytyrën të verdhë, të verdhë. Tani, sa herë dua ta sjell ndër mend, ashtu më del para sysh.

Kur u tkhyem të nesërmen në shtëpi, nënën e gjetëm të raskapitur, me sy të skuqur dhe fustan të zi. Fjetëm të tre, pranë e pranë. Ajo më shtrëronte fort dhe e ndjeja se qante, duke fshehur kokën nën jastëk.

Tani vetëm Flora dyvjeçare e prishte qetësinë që kishte pllakosur në shtëpinë tonë. Nëna e ngryste ditën mbi govatë dhe natën i dhimbte mezi. Megjithatë, nuk ankohej. Unë s'vajta më në shkollë. Vendosa të ndihmoj nënën. Shisja, sipas stinës, kikirik, gështënja të pjekura ose bajame të qëruara. Ëndesha gjer vonë nëpër pijetore, duke shkuar tavolinë më tavolinë, me një tufë kaushash në dorë. Nëna më priste në dritare. Me të kaluar pragun, më përqafonte dhe më pyeste në isha lodhur shumë. Kurrë s'më pyeti sa fitova. Unë ndjeja kënaqësi të madhe, kur i ndaja veç fitimet dhe ja jepja.

Pas çlirimit, nëna hyri kuzhiniere në një mensë punëtorësh. Rrogën e kishte të vogël, por ajo që e kënaqur. Me nikoqirllëk ja dilte mbanë, prandaj nguli këmbë që unë të vazhdoja shkollën.

Në fillim më vinte zor, se isha më i madhi i klasës, por pastaj u mësova. Uniken e mbarova shkëlqyeshëm dhe më doli bursë për në shkollën politeknike. Kështu u largova për të parën herë nga familja.

U mësova shpejt me jetën e re. Më pëlqenin klasat me dritare të larta, laboratorët me rafte sa faqja e murit dhe salla e studimit, ku dëgjohej vetëm fëshfëritja e fletëve, hapat e kujdestarit dhe rrallë ndonjë pëshpëritje. Më pëlqente mensa jonë e madhe, me atë kundërmimin e saj të veçantë. Më pëlqente edhe fjetorja me shtretër të mbivenosur, ku bëhej shumë zhurmë. Më pëlqente kjo lloj zhurme, që kishte diçka të bukur e të gëzueshme në vetvete. Nganjëherë ngjitesha në shtratin tim, i cili ndodhej në skaj të dhomës, në radhën e sipërme dhe vështroja se si rrihte jeta në fjetoren tonë. Dikush lexonte, një tjetër mbulonte kokën me batanije dhe mundohej të flinte, ndonjeri kujtohej t'i shkruante letër familjes, të tjerë bisedonin apo bënin shaka. Të shumtën e herës, kjo lloj jete më përfshinte edhe mua në valën e saj, megjithëse isha më i heshtur dhe më i përmbajtur se të tjerët.

Në konviktin tonë, si në çdo konvikt, ndodhnin edhe çapkënllëqe, por unë s'kam qenë kurrë pjesëtar në to. Kur kujtoja me sa vështirësi ja kisha arritur asaj dite dhe premtimin që i kisha dhënë nënës, dridheshja vetëm nga mendimi se mund të dënohesha për thyerje të disiplinës. Gjatë katër vjetëve, vetëm një herë vajta në konvikt pas orës së mbylljes. Do të kisha fjetur jashtë sikur një shok i dhomës të mos ma kishte mbushur mendjen, pas shumë hezitimesh, që të hynim nga dritarja e koridorit, të cilën ai enkas e kishte lënë të çelur para se të dilte. Atë mbrëmje u vonova duke përcjellë në shtëpi Valën, të cilën e kisha njohur gjatë verës, në hekurudhë.

Qysh në aksion ishim bërë miq të ngushtë. Bisedat tona të gjata na dukeshin gjithmonë të bu-

kura dhe interesante. Ja ndjenim nevojën njëritjetrit, sidomos kur fillonte shkolla dhe takoheshim rrallë. Sapo ndahesha prej saj, mendoja për takimin e ardhshëm dhe sajoja diçka, që ky takim të bëhej sa më parë. Kur ajo më çikte me dorë, ndjeja mornica të ëmbla. Kjo, ndoshta, ishte dashuria ime e parë, sidoqë asnjëherë nuk shkuam më tej nga një shtrëngim i zgjatur dore. Pasi mbaruam shkollën e mesme, jeta na largoi dhe dikur mora vesh se Vala ishte fejuar. Por akoma sot ndjej një nostalgji të ëmbël për atë kohë, kur vështronim njëri-tjetrin me dëshira të përmbajtura, ndërsa komentonim «Si u kalit çeliku», bisedonim për mbledhjet e gjata të organizatës së rinisë dhe ëndërronim për vepra të mëdha.

Si mbarova teknikumin, u emërova në një fabrikë të qytetit tim. Kështu filluan ditë më të mira për familjen tonë. Më janë ngulitur në kujtesë ato mbrëmjet e vakëta të verës, kur bisedonim për planet e së ardhshmes në oborrin e vogël që kundërmonte nga lulet. Apo ato mbrëmjet e lagështa të dimrit, kur cikërrinte shiu në dritare dhe bubullinte zjarri në sobë, ndërsa nëna gatuante darkën, Flora përgatiste mësimet e së nesërme, kurse unë studioja për provimet e ardhshme. Isha regjistruar në fakultetin e inxhinierisë me korrespondencë.

Gëzimi ynë qe i shkurtër. Nëna u sëmur rëndë. Ne i qëndruam te koka dhe s'i lamë gjë mangut, po organizmi i saj, i stërmunduar vite me radhë, s'i bëri dot ballë sëmundjes. Me zemër të drithëruar e shikonim qysh keqësohej dita-ditës, por gjithmonë shpresonim, edhe kur mjekët tundnin kokën me keqardhje. Nëna vdiq dhe ne mbetëm si zogjt pa kllonjë. Në shtëpi nuk na rihej. Flora qe tronditur aq shumë,

sa e çova tek një kushëri, ku qëndroi gjersa mbaroi provimet e shtatëvjeçares. Pastaj i doli bursë për teknikumin e ndërtimit, në Tiranë. Atëhere kërkova edhe transferim. Nuk më rihej vetëm. Dëshiroja një punë që të më rrëmbente në valën e saj.

U transferova në kantierin e ndërtimit të hidrocentralit «Karl Marks». Fillova përsëri jetën zhurmëmadhe të fjetores e të mensës. Isha njëzetepesë vjeç atëhere, mjaft i fortë fizikisht dhe s'e kurseja veten në punë. Kur kthehesha mbrëmjeve në barakë, me t'u shtrirë në shtratin prej dërrase, më zinte gjumi. Nuk më shqetësonte as zhurma e shokëve, as buçima e pandërprerë e motorave. Përkudrazi, këto më ngjnin si një muzikë nanuritëse. Të nesërmen ngrihesha me të zbardhur, freskohesha me ujët e Matit, gllabëroja racionin në mensë dhe, duke pritur orën e ndërrimit të turnit, strukesha në ndonjë qoshe dhe mësoja. Atje, në kantier, duke punuar e duke mësuar, i përgatita ca e nga ca provimet e fakultetit dhe e mbrojta me sukses projektin e diplomës.

Qysh atëhere u emërova në uzinë. Ajo ishte e vogël, me disa reparte primitive. Më duhej të punoja shumë, se isha i vetmji inxhinier i saj. Me sa përpjekje i shtuam dhe i paisëm repartet e rinj, sa net gdhimë duke montuar makineritë në sallat e posandërtuara! Dhe nuk kisha as shtëpi! Banoja në hotel. Sikur të mos isha miqësuar me portierin e natës, kushedi sa herë do të kisha mbetur jashtë, nga që vonohesha në uzinë. Kur bënte ftohtë, futja edhe kokën nën batanije, mblidhesha kuspull dhe mendoja për punët e së nesërmes. Takonte që flija pa ngrënë, se i gjeja të mbyllur restaurantët. Më kujtohet se një herë nuk më zinte gjumi nga uria, sa u shtrëngova t'i kërkoj një copë bukë rojtarit të

natës. Sot do të më dukej e vështirë një jetesë e tillë. Mirë thonë, çdo gjë në kohën e vet!

Flora mbaroi teknikumin dhe u emërua në një kantier ndërtimi në veri. Atëhere mbeta vetëm përsëri. Isha mësuar aq tepër me të, sa ja ndjeva menjëherë mungesën. Megjithëse dhjetë vjet më e re, ajo kishte qenë për mua jo vetëm motër e dhëmshur, por edhe shoqe. Me ngrohtësinë e saj, dinte të ma largonte çdo shqetësim.

Atë vit vendosa të martohem. Edhe shokët kështu më këshillonin.

Anin e njoha në një mbrëmje shoqërore për vit të ri. Qysh më parë kisha dëgjuar fjalë të mira për të. Të atin e kishte avokat dhe ajo vetë ishte në vitin e fundit të fakultetit të mjekësisë. Që në njohjen e parë më la përshtypje të mirë. M'u duk jo vetëm e pashme, por edhe e pjekur, e përmbajtur dhe e sjellshme. Fjalë s'ishin dëgjuar për të.

Me ndihmën e rrethit shoqëror u takuam disa herë. Më në fund m'u mbush mendja t'i propozoj për fejesë. Ajo e priti mirë propozimin tim, më tha se ishte dakord, veç më drejtoi tek prindërit. Ata hezituan ca, por pastaj pranuan. Siç mora vesh më pas, Ani kish ngulur këmbë, gjersa i kishte bindur.

Fejesa jonë qe e shkurtër. U martuam gjashtë muaj pasi mbaroi ajo fakultetin. Ndërkohë unë kisha marrë apartament. E paisëm dalëngadalë dhe ja, tani s'na mungon gjë.

Qysh atëhere jeta jonë familjare ka rrjedhur në paqe dhe mirëkuptim. Ani ka qenë gjithmonë e sjellshme dhe e dëgjueshme. S'kam pse ankohem prej saj. Shtëpinë e kam gjetur ngahera të rregulluar, drekën dhe darkën të ngrohtë, ndërresat dhe rrobet të pastërta, megjithëse ajo ka shumë punë edhe në ambulancë.

Për fat, vjet Florës i doli e drejta e studimeve të larta, në fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit. Ajo, budallaqja, deshi një herë të banonte në konvikt. Sigurisht që nuk e lashë. Ja, tani jetojmë bashkë, për bukuri. Nuk kemi patur asnjëherë mosmarrëveshje ose grindje. Flora është aq e sjellshme, por edhe Ani s'ja ka prishur.

Që të ndjehet sa më mirë motra, sakrifikova për të studion time të vogël. Ja kam rregulluar për bukuri dhe ja kam lënë krejtësisht asaj. Le të sjellë shoqe, le të mësojë, le të bëjë ç'të dojë. Dua të mos i mungojë ngrohtësia familjare, gjersa të krijojë të sajën. Kur të mbarojë fakultetin, ishalla i gjejmë një burrë të mirë.

Ja, kjo është jeta ime! Ndoshta s'ka asgjë të jashtëzakonshme, por më duket aq e pasur, aq e larme...

Tani jemi mirë. O, sa mirë që jemi! Sikur të jetonin prindërit e shkretë, sa do të gëzoheshin!...»

### 3.

Flora po punonte për projektin e gjeodezisë në njërën nga sallat e fakultetit. Kishte tre orë përmbysë mbi llogaritjet dhe ndjehej e lodhur, aq sa shifrat filluan t'i ngatërrohen para syve.

— Arben, të lutem ma kontrollo këtë mbledhje, se e bëra për të tretën herë dhe përsëri nuk më kuadreron! — i tha shokut që punonte pranë saj.

— Ma jep! — tha ai.

Zgjati dorën, mori fletën dhe u përkul mbi shifrat e vockëla e të dendura, të renditura njëra nën tjetrën, me një kujdes prej femre.

Flora i qëndronte pranë dhe e vështronte tek po përshkonte me majën e kalemit njëshet, dhjetëshet, qindëshet. Një copë herë e ndoqi në llogaritje, pastaj e humbi fillin dhe nisi të vështrojë fytyrën e përqëndruar të Arbenit.

Ai kishte tipare të rregullta dhe të zakonshme, por Flora gjente diçka të veçantë në qenien e tij, diçka që ajo s'dinte ta përcaktonte, por që i dukej se e dallonte nga të tjerët. Njiheshin prej dy vjetësh, me fillimin e fakultetit, dhe bënë pjesë në të njëjtin grup mësimor. Qysh në fillim ishin afruar, sado që Arbeni, ndryshe nga Flora, ishte fjalëpakë dhe i përmbajtur. Para se të vinte në fakultet, edhe ai kishte punuar në një kantier ndërtimi. I pëlqente ta kujtonte dhe të tregonte për jetën e kantierit. Bisedat e para me Florën i kishin bërë pikërisht rreth kësaj teme dhe kështu që lidhur nyja e parë e miqësisë së tyre. Duke gjykuar për të kaluarën e ngjashme, duke marrë pjesë bashkërisht në ndodhitë e përditshme të jetës studenteske, ata kishin gjetur tek shoku-shoku shumë veçori, mendime dhe ndjenja të përbashkëta, që ua kishin forcuar miqësinë.

— Kjo këtu është tresh, apo tetë? — pyeti Arbeni, duke treguar me majën e lapsit një shifër.


— Kush? Po, tresh! — tha Flora, e shkëputur befaz nga mendimet.

— E ke mbledhur për tetë, prandaj ke gabuar. Merre, tani të kuadron!

— Faleminderit. Vetë s'do ta kisha gjetur, se jam turbulluar fare.

— Dukesh Lere me kaq për sonte. Kemi kohë gjer në afatin e dorëzimit.

— E ç'të bëj? Është akoma herët për të shkruar në shtëpi.



— Unë kam ndër mend të shkoj në kinema. Po deshe, ec edhe ti. Është një film i vjetër, po i bukur. Si thua?

Flora u mendua, duke luajtur me zinxhirin e çantës.

— Veç, do më presësh sa të mbyll llogaritjen e fundit! — tha Arbeni. — Pesë minuta punë. Mirë?

— Ej, mjaft me llafe, se po na ngatërroni! — i qortoi dikush andej nga fundi.

Flora bëri «po» me kokë dhe filloi të mbledhë fletoret. Si e mbylli çantën, iu afrua dritares, e çeli dhe u mbështet në prevazin e saj.

Po ngrysej. Në sheshin përballë u ndezën llambat e neonit. Kaloi një veturë dhe karrocëria e saj e zezë llamburiti. Dëgjohej fëshfëritja e plepave të parkut të madh. Disa nga gjethet e tyre të zverdhu-  
ra era i zvarriste mbi pllakëzat e sheshit të gjërë. Në ajër ndjehej kundërmimi i vjeshtës.

Në sallë dëgjohehin fëshfëritje fletësh dhe rrallë pëshpëritje. Krisi dera. Flora ktheu kokën. Dikush po dilte. Bankat po boshatiseshin. Arbeni qëndronte i përkulur mbi fletoren e tij, aq i përqëndruar në llogaritje dhe i shkëputur nga gjithë ç'e rrethonte, sa Flora dyshoi mos e kishte harruar premtimin. Sakaq, ai nënvizoi me të kuqe një shifër, mbylli fletoren dhe brofi në këmbë.

— Mbarova! — tha. — Për fat, kuadroj me të parën. Shkojmë?

I zbritën shkallët mes një trumbe të gëzueshme studentësh. Para tyre kaloi një studente me biçikletë, që po e mësonte atë me ndihmën e një shoku i cili vraponte pas saj. Në godinën e konservatorit një këngëtar bënte vokalizma. Dikush tjetër



i binte pjanos me pushime të vogla, duke përsëritur të njëjtin fragment.

— Secili ka hallin e vet! — tha Flora, duke treguar me kokë andej.

— Këta e kanë mirë! — tha Arbeni, duke treguar me dorë nga salla e palestrës, prej ku dëgjo-heshin të rrahurat e topit në dysheme. — Sa do të më pëlqente të luaja basketboll tani! E di, Flora, më shijon së tepërmi pushimi pas një dite të ngarkuar.

— Edhe mua. Kur e kalon ditën bosh, asgjë s'të shijon.

Kur arritën tek sporteli i kinemasë, nuk patën nevojë të prisnin radhën. Sportelistja, që po shfletonte me nge revistën «Ylli», u dha shpejt e shpejt biletat dhe u përkul përsëri mbi revistë.

Salla ishte pothuaj bosh. Arbeni u mat të zinte vend nga fundi, ku qenë grumbulluar ata pak spektatorë, por Florës i pëlqeu të uleshin diku në mes.

— Sigurisht, këtu shihet më mirë! — tha Arbeni. — Por, mendova se s'do të të pëlqente një vend i tillë, i veçuar! — Ai tregoi me kokë karriget bosh rreth tyre.

— Mos mendon se u tregova mendjelehtë ose e pakujdesshme që erdha në kinema vetëm me ty? — e pyeti Flora, me një buzëqeshje të çiltërt.

— Jo, përkundrazi...

— Atëhere, pse u dashka që unë të mendoj ndryshe nga ti?

Arbeni uli kokën, i zënë ngushtë dhe luajti me fletoret që kishte në duar.

— M'i jep t'i fut në çantën time! — tha ajo. — Do t'i zhubravitësh!

Ai ja zgjati pa fjalë. Ndërkaq filloi dokumen-

tari. Arbeni e kishte parë, prandaj nisi të mendojë për Florën.

Nga të gjitha shoqet e vitit, Flora i qe dukur gjithmonë më interesantja, megjithëse në fillim e pati të vështirë të krijonte një bindje për karakterin e saj. Ishte guximtare ajo apo mendjelehtë, e zgjuar apo e shtirur, e shkathët apo lozonjare, e sinqertë apo naive? Kishte raste që mendonte edhe ashtu, edhe kështu, por gjithmonë një forcë e brendshme e kishte shtyrë të anonte nga e mira. Një ditë e dëgjoi Florën tek i fliste ashpër një shoqeje të vitit, Hajries, e cila kishte thënë se jeta e kantierit nuk u përshtatet femrave. Me sytë prush dhe me gojën brisk, Flora dënonte ato vajza që vijnë në fakultet sa për të siguruar një diplomë, me shpresë se do të gjejnë ndonjë qoshe të rehatshme. Qysh nga ajo ditë balanca kishte anuar përfundimisht nga e mira. Paskëtaj Arbeni nuk çuditej, kur ajo thoshte ndonjë mendim të zgjuar, po entuziazmohej; nuk neveritej kur ajo qeshte fort dhe vraponte si çamaroke, po i admironte shkathhtësinë. Ndjehej mirë pranë saj dhe, pa e kuptuar, kishte filluar t'i pëlqente shoqëria me të.

Duke menduar për Florën, ai ktheu kokën dhe e vështroi.

Vija e profilit të saj, e ndriçuar zbehtë prej dritës së ekranit, fillonte me një ballë të vogël, nën baluket rebele ngjyrë kalliri, vazhdonte me hundën e drejtë e të shkurtër, me buzët e holla dhe mjekrën e imtë, harku i së cilës mbyllej rrëzë veshit, pothuaj të mbuluar prej flokëve të prera shkurt.

Befaz ajo ktheu kokën dhe, kur sytë e saj të mëdhenj e të hirtë u ndeshën me të tijtë, patën një shkëlqim të veçantë.

— E kam parë këtë dokumentar! — pëshpëriti ai, si i zënë në faj.

— Edhe unë. Më duket se ky është kuadri i fundit.

Mbas pak filloi filmi. Ajo e vështroi disa herë vjedhurazi, por ai, si gjithmonë kur përqëndrohej në diçka, qe shkëputur nga gjithë ç'e rrethonte.

Florës i dukej sikur prej tij buronte një ngrohësi e ëmbël dhe me mend e me trup prirej drejtë saj. Ishte çuditërisht e ndjeshme në ato çaste dhe kuadrot e bukura të filmit e mallëngjenin gjer në lot.

Kur dolën nga kinemaja, ecën një copë herë të heshtur, duke jetuar akoma me mbresat e ngjarjeve që kishin parë në ekran.

— Film i bukur! — tha më në fund Arbeni.  
— I thjeshtë, por sa i singertë dhe njerëzor!

Flora aprovoi me kokë.

— Në rrethana të atilla, të vështira, del më kjartë në pah bukuria dhe fisnikëria e karakterit të njeriut! — tha.

Pastaj përsëri heshtën. E lanë bulevardin dhe kthyen në një rrugë të dytë, më pak të ndriçuar. Në të dy anët e saj ngriheshin apartamente të lartë, që vështronin njëri-tjetrin me sy të panumërt, të ndritshëm. Mbi siluetat e tyre dhe mes degëve gjysmë lakurige të panjave buzë trotuareve, dukeshin yjet që puliteshin si të përgjumur.

Diku krisën kanatet e një dritareje dhe për një çast u dëgjua fragmenti i një melodie. Era mori hov dhe degët e panjave u drodhën.. Një gjethe ra mbi supin e Florës, iu zvarris mbi gjoks dhe treti pas capeve të saj.

Arbeni e vështronte pa ja shqitur sytë. Ajo

ecte me gjoksin pak të nxjerrë, krahët të lëshuar, kokën të nderur përpara, buzët paksa të çelura dhe qerpikët të afruar. Vështrimi i saj qe tretur diku larg. I ngjante një shpendi të madh që matet të fluturojë.

Befaz ajo zgjati krahët përpara, me pëllëmbët e kthyer drejtë qiellit.

— Vështro, Arben, sa bukur që është! Ç'natë!

— Po! — pëshpëriti ai. — E bukur është! — Dhe ndjeu mornica mallëngjimi.

U erdhi keq të dyve kur arritën tek apartamenti, ku banonte Flora.

— Sa larg e ke konviktin prej këtej! — tha ajo, duke i dhënë dorën.

— S'ka gjë! — tha ai. — A nuk thamë se nata është e bukur? — Buzëqeshi.

— Sikur të isha djalë, tani do vija unë të të përcillja! — tha Flora.

— Pastaj përsëri unë. Por kjo dikur do të mbaronte.

— Po. Çdo gjë ka një fund. Veç për të bukurën njeriu dëshiron të mos ketë kurrë fund. Natën e mirë, Arben!

— Sa e çuditshme që je, Flora! — tha ai me zë të ngrohtë, duke i shtrënguar fort dorën. — Sa e mirë je! Natën e mirë, pra!

Ajo ngjiti me nxitim shkallët, po kur arriti në katin e saj, u ndal, u var tek prevazi i tyre dhe e ndoqi me sy siluetën e Arbenit, ndërsa hapat e tij të njohura kumbonin gjithnjë më larg.

Florës i dukej sikur diçka po i shkëputej nga vetja, duke i lënë një boshllëk.

Mbledhja e organizatës së rinisë kishte tri orë që vazhdonte pa ndërprerje. Asnjëri nuk kërkonte pushim. Diskutimet kishin marrë flakë.

Tre nga anëtarët e organizatës kishin ardhur të papregatitur në seminarët e ditës. Edhe herë tjetër kishte ndodhur që ndonjëri të vinte i papregatitur, po kësaj radhe çështja merrete rëndësi të veçantë, sepse të djeshmen gjithë grupi kishte punuar në një objekt ndërtimi në qytetin e studentëve.

Folësit, kush me të urtë e kush me të ashpër, e dënuan që të gjithë këtë qëndrim.

— I mbështes plotësisht parafolësit, kjo është e palejueshme, shokë! — tha Arbeni, kur e mori fjalën. — Plot nga njerëzit tanë, që derdhin djersë nëpër kantieret e vëndit, ditën punojnë dhe natën mësojnë. Jo një herë në javë, po ditë për ditë, për vite me radhë. Do t'ju tregoj një shembull. Kishim një mekanik në kantier. Burrë i shkuar, baba i katër fëmijëve. Ishte i vetmi mekanik i kantierit dhe kishte shumë punë. Gdhihej dhe ngrysej mbi tornio. Megjithatë, gjente kohë edhe për të mësuar. Vazhdonte me korrespondencë shkollën e mesme. Ndodhte që na vinte në fjetore atëhere, kur ne mezi prisnim të binim dhe na pyeste për diçka që s'e zgjidhte dot. Pyeste pak, sa për t'i hyrë problemit, pastaj ikte me fletoren e zhubrosur në dorë dhe strukej në punishten e tij. Nuk e di kur flinte ai njeri. Tani së fundi, mora vesh se e paska mbaruar të mesmen dhe mendon të vazhdojë fakultetin. Ky është vetëm një shembull. Ka mijëra të tillë. Djersa e tyre na mban ne këtu, me profesorë, auditore, salla studimi, laboratorë, me konvikte e mensa, me gjithë të mirat.

Vetëm një detyrë kryesore kemi: të mësojmë, të bëhemi kuadro të mira që t'ja shpërblejmë popullit. E ka harruar vallë këtë Agimi, Skënderi, Hajria? Si nuk i vjen turp kësaj që thotë se gjoja u lodh në punë vullnetare dhe prandaj nuk mundi të pregatitej! Po të tjerët nuk u lodhën? Vëri gishtin kokës, Hajrie, se fakulteti nuk është, sa për të marrë një copë diplomë. Duhet të dërsish, të mësosh dhe njëkohësisht t'i futësh duart në llaç, të ngjitesh në skelë, të veshësh kominoshe doku në vend të fustanit prej deveje, të mbathësh çizme llastiku në vend të këpucëve me taka. I tillë është ndërtimi. E tillë është gjithë jeta jonë. Nuk ka rrugë tjetër. Prandaj, në vend që të fshish lotët me shami të mëndafshhtë, siç po bën, ngreu e folë siç është për të folur dhe pranoje gabimin. Pranoje, jo sa për të kaluar radhën, po duke bërë një kthesë në vetvete, një kthesë të fortë...

Flora e dëgjonte Arbenin me admirim. I dukej sikur lehtësohej nga ndjenjat dhe mendimet që i vlonin përbrenda. S'ka gjë se ai ja dogji të gjitha çështjet e diskutimit të saj, mjafton që u thanë ato çka donte të thoshte ajo.

— Të lumtë, Arben, fole mirë! — e përgëzoi pas mbledhjes, ndërsa po kalonin nëpër korridorin e gjatë të fakultetit.

— Edhe të tjerët folën mirë! — tha ai. — Ku do të shkosh tani?

— Në shtëpi. U bë vonë. Do më përcjellësh një copë rrugë?

— Jo. Do rri të punoj në sallën e studimit. Kam mbetur mbrapa me projektin.

— Mirë pra! — tha ajo, duke i zgjatur dorën.

-- Punë të mbarë, atëhere. Pastaj të bëftë mirë dhe në fund, natën e mirë.

Kur doli në rrugë, Flora nuhati me ëndje pëllëmbën e djathtë. I dukej sikur ruante aty një grimcë nga kundërmimi i dorës së tij. Ndjente një hare të brendshme, aq sa i vinte të vraponte, të këndonte, të nxirrte një klithmë gëzimi. Vështronte me radhë godinat aq të njohura të rrugës së fakultetit dhe i dukeshin më të bukura se zakonisht.

«Ç'kam kështu?» — mendonte. «Ç'po ndodh me mua?»

Nxitonte pa vetëdije, prandaj arriti shpejt në shtëpi. Tek ngjiste shkallët e hyrjes, pa disa fëmijë që luanin. Njëri prej tyre kishte në dorë një copë qymyr dhe po shkarraviste muret. Flora ja hoqi nga duart copën e qymyrit dhe e qërtoi.

Me të futur çelësin në bravën e apartamentit, krisi dera kundruall dhe në pragun e saj u duk një gjysmë fytyrë gruaje.

— Mirëmbërëma, shoqja Ksanthipi! — e përshëndeti enkas me zë të lartë Flora.

— Oh, ti qenke! — Ksanthipi nxori gjysmën tjetër të fytyrës. — Kujtova se ishte Ani.

— Ajo ka ardhur, besoj. Dëgjohen që këtu hapat e saj nëpër korridor. Keni punë me të, doni ta thërres?

— Jo, faleminderit. Natën e mirë! — tha komshia dhe u mat të futej brenda.

— Shoqja Ksanthipi! — e ndaloi Flora.

— Urdhëroni!

— Tek po ngjitesha, gjeta djalin tuaj, duke shkarravitur muret me qymyr. Edhe vetë ishte nxirë, si mos më keq.

— Ah, shejtani, sa i prapë që është!

Flora mbylli derën, la çantën dhe pardesynë në korridor dhe hyri në dhomën e bukës. Anin e gjeti duke pregatitur darkën.

— Si shkove sot? — e pyeti. Vuri një përparëse dhe nisi ta ndihmojë.

— Lere mos e nga! — u ankua ajo. — Pata shumë vizita. Ma morën shpirtin. Vijnë kot, për gjëra të vogla. Njëra ankohet se nuk i ka oreks fëmija, tjetra se i kollet natën e kështu me radhë.

— Më mirë të vijnë kot, se sa vonë, apo jo? — tha Flora, duke qeruar një patate.

— Ç'kusur kemi ne, se? Kur mbaron orari i vizitave më merren mendtë nga lodhja.

— Çdo punë ka telashet e saj, Ani. Sidoqoftë, profesioni juaj është aq njerëzor, aq i bukur.

— Ej, posi! Të jesh një ditë tek unë dhe të shikosh se ç'bëhet! S'ta dijnë as për faleminderit. U duket sikur ua ke për borxh.

«Ta merr mendja, për borxh ua kini!» — mendoi Flora.

— Më mirë të kisha mbaruar për arësimitare!  
— vazhdoi Ani. — Kot e bëri im at.

— Pse, nuk hyre me vullnetin tënd në mjekësi?

— Mua më doli për shkenca, por babai nguli këmbë të kaloja në mjekësi se qënkësh zanat më i mirë. Plasi sa ma ndërroi. Ta dija kështu...

— Po ty, ç'do të të pëlqente më tepër?

Ani ngriti supet dhe mendoi një hop.

— S'di ç'të them, por sidoqoftë një punë më e lehtë, që të më linte më shumë kohë për punët e shtëpisë. Ndoshta arësimitare...

— Ç'flet kështu, Ani! — u çudit Flora. — Ta thoshte këtë ndonjë femër e prapambetur, hajde de



por një mjeke...Pse, punët e shtëpisë qenkan kryesoret, ky është qëllimi tënd në jetë!

— Ke hak, se ti nuk e di ç'është familja! — tha Ani, duke buzëqeshur me ironi. — Pa e bërë këtë, ç'do hanim për darkë? — Ajo tregoi kokrrën e patates, të qëruar përgjysmë. — Apo të shkonim në restaurant, si disa? Atëhere, ç'kuptim ka familja? Dëgjo mua, Flora, shtëpia ka nevojë për amvisë, që ta presë dhe ta përcjellë burrin me buzë në gas, që t'ja shtrojë drekën dhe darkën të ngrohtë e të gatuar mirë, që të rritë dhe të edukojë fëmijët.

— Ky problem nuk është i pazgjidhshëm!

— Qysh, duke u robëtuar kështu? — Ani hapi krahët dhe vështroi veten me keqardhje.

— Duke punuar të dy palët edhe në shtëpi, secili për atë që i vjen më tepër ndoresh.

— Ha-ha! — qeshi Ani, me shpoti. — Këto thuhën nëpër mbledhje, por nuk ndodhin në jetë. E ke parë tët vëlla sa bëhet merak për punët e shtëpisë?

— Vetë e ke mësuar kështu. Po që dashuria dhe mirëkuptimi në një familje, të gjitha bëhen, të gjitha vështirësitë kapërzen! — tha Flora.

— Dashuria? Gjepura! Dashuria është si vesa e mëngjezit. Me kohë, fjalët e bukura, vështrimet e zjarra dhe premtimet i merr era. Jeta është ndryshe nga ç'e mendon ti, Flora.

— Më vjen keq se nuk jemi në pozita të barabarta, por në asnjë mënyrë nuk pajtohem me mendimet e tua! — tha vajza.

— Mirë, mos u pajto! — ja priti Ani, duke ngritur supet.

Një copë herë ato heshtën. Dëgjohej vetëm

zjarri që kërciste në sobë dhe zhuama e patateve që hidhnin në kusi.

— Ani, ti e dashuroje Petron para martesës?  
— pyeti dikur Flora.

Ajo ngriti sytë, e habitur. «Ç'tu shkrep me këtë pyetje?» thoshte vështrimi i saj.

— Më pëlqente! — u përgjegj pastaj.

— Po sikur ndërkohë të të kish dalë një rast tjetër, më i mirë, do ta kishe shkëmbyer?

— Mundet.

— Pra, ti s'ditke ç'është dashuria.

— Dhe as që jam e penduar! — tha Ani.

— Si i paske krijuar këto bindje atëhere, ku i mbështet?

— Pashë ç'fituan ato që dashuruan! — u përgjegj ajo. — Në rastin më të lumtur janë martuar. Dhe martesë, me dashuri apo njohje qoftë, është çështje fati. Madje, martesat me njohje janë më të qëndrueshme, se nuk fillojnë me iluzione, pra s'kanë as deziluzione.

— D'ziluzioni mund të vijë pas një pasioni kalimtar, ndoshta! — tha Flora. — Por mendoj se dashuria që mbështetet sa në ndjenjë, aq edhe në njohjen e mirë të njëri-tjetrit, nuk sjell deziluzione, nuk shuhet. Kam lexuar diku se pas krijimit të familjes, me kohë, ajo ndryshon, por në thelb mbetet e njëjtë, madje bëhet edhe më e fortë, edhe më e thellë. Unë e besoj plotësisht këtë.

— Gjepura, punë librash! E si mund ta dallosh në është dashuri, apo pasion kalimtar një ndjenjë? — pyeti Ani. — Ka ndonjë termometër për këtë?

— Jeta sjell plot rrethana, në të cilat kjo del në pah! — tha Flora.

— Po në dalç e gënjer?

— Keq është, s'ke ç'i bën, edhe dashuria ka rreziqet e saj.

— Mua s'më ka pëlqyer kurrë të rrezikoj!  
— tha Ani.

— Po të arësyetonim kështu, s'duhej të dilnim as shëtitje, se mund të na ndodhte ndonjë aksident! — ja priti Flora.

Ani buzëqeshi, siç buzëqeshet me gafën e një kalamani.

— Thuaj më mirë se nuk e ka në dorë njeriu të dashurojë ose jo! — tha. — Dashuria është si loja me zjarrin. Mendja e kthjelltë gjykon kurdoherë më mirë se mendja e turbulluar nga pasioni.

Ajo fliste së larti, me një farë shkujdesje, duke dashur të nënvizojë se këto gjëra ishin aq të njohura dhe të vërtetuara nga jeta, sa ishte e kotë t'i diskutoje.

— Po, llogaritë bëhen më mirë ashtu! — tha Flora. — Por unë s'e kuptoj qysh mund të krijohet familja, duke u mbështetur në llogari. Kjo do të ishte baza më e dobët për të.

«I ka marrë koka erë!» — mendoj Ani dhe vendosi të mos ja zgjaste.

— Sidoqoftë, unë s'do ta lidhja kurrë jetën me një njeri që s'e dashuroj! — përfundoi Flora, duke hedhur në kusi pataten e fundit.

— Na gjej ndonjë muzikë të bukur, se këto biseda janë pesë me hiç! — tha Ani, duke u hedhur kripë patateve.

Përzjeu gjellën me lugën e drunjtë, futi një dru në zjarr, lau duart dhe u ul në cepin e divanit.

Flora vërtiste rotëzën e valëve, por mendjen s'e kishte aty. Ndjente një farë zemërimi të papërcak-

tuar dhe i dukej sikur nuk i kishte thënë të gjitha. E vështronte të kunatën me bishtin e syrit. Flokët e gjatë e të zes i kishin rënë pak përmbi sy. Lëkura bardhoshe e fytyrës i shkëlqente butë, si kadife. Nën mjekër i qe formuar një gushë e vockël, e kolme. Gjithë qënia e saj rezatonte paqe dhe mirqënie.

Florës iu duk sikur ndërmjet së kunatës dhe maces së bardhë leshatore, që ishte strukur pranë saj, kishte një ngjasim të çuditshëm. Qeshi me vete për këtë krahasim.

Ani po shfletonte një revistë «Ylli» dhe shtirej sikur lexonte.

«Flet përçart kjo vajzë! — mendonte për Florën. — Me kokën që ka, do ta marrë lumi. Por, ç'më duhet mua! Mjaft kam hallet e mia. Le të nxjerrë sytë në dashtë. E keqja është se mos i mbetet në derë të vëllait dhe mua bashkë! Për hatrin e Petros do ta duroj sa të mbarojë, po pastaj nga majat, thëmbërat. Dua rehatin tim, s'ja kam për borxh. Shumë edhe kaq.»

Flora, me bërrylet mbi tavolinë dhe kokën në pëllëmbë, vështronte orenditë aq të njohura të dhomës dhe mendonte për jetën monotone të familjes. Ajo e dinte se ç'do të ndodhte pas pak.

Ja, do të kërciste brava e derës së jashtme dhe do të hynte Petrua, ndoshta me një pamje disi të lodhur. Ani do t'i uronte mirëseardhjen me buzë në gaz. Gjithmonë me të njëjtin ton, me të njëjtën buzëqeshje. Dhe mbrëmja do të vazhdonte si të djeshmen, si të pardjeshmen.

Duke menduar kështu, asaj iu duk sikur muret

e guzhinës u afruan së tepërmi dhe po e ndrydhnin midis tyre. Brofi në këmbë.

— Ç'pate? — e pyeti Ani.

— Asgjë, më pihet ujë.

Ndërkohë mbërriti Petrua dhe gjithshka ro-dhi ashtu siç e pat menduar Flora. Biseduan një copë herë për cikërrimat e ditës, pastaj u shtruan në tryezë dhe hëngrën në heshtje. Pas darke ai zuri qoshen e tij të zakonshme dhe ndezi cigaren. Ato të dyja ngritën tryezën dhe lanë enët.

— Petro, më pate premtuar të shkojmë në kinema këtë javë! — tha Ani. — Filmi ka ditë që luan dhe mund ta heqin. Shkojmë nesër?

— Mirë, në mos më daltë ndonjë punë! — pranoi ai, disi i bezdisur.

— Po atë shokun, që do na gjente një stof të mirë për pallton time, a e takove?

— Jo.

— Kështu i lë punët ti, zvarrë! — e qërtoi ajo.

— Eh, edhe ti Ani, se ku të punon mendja! — tha Petrua, duke bërë një grimasë padurimi.

Një copë herë sundoi heshtja. Dëgjohej vetëm gërhitja e maces, bubullitja e zjarrit, gurgullitja e gjellës mbi sobë dhe tik-taku i sahatit, që përbënin një zhurmë monotone, të plogët dhe të mërzitshme.

— S'na the ndonjë të re, Petro! — e prishi qetësinë Flora.

— Ç't'ju them?

— Ç'bëhet andej, nga uzina juaj?

— E ç'do bëhet, ja, punë, telashe. Ai Andrea, që na dukej burrë i mirë, po na ngatërron.

— Si? — u çudit Flora.

— Po, po, pikërisht ai, gjoja miku im. Ngul këmbë të riorganizojmë një nga repartet kryesore

të uzinës, në një kohë kur na vjen mendja vërdallë për ta mbyllur mirë planin vjetor. E keqja është se ka bërë me vete edhe punëtorët. Nuk i pëlqeka, zotërisë së tij, si e kam organizuar unë repartin! Dashka të dalë më i zgjuar. Megjithatë, s'ka për t'i shkuar fjala. Jam i bindur se këshilli teknik do të mbajë anën time.

— Je i bindur se ke të drejtë? — pyeti Flora, si me ndrojtje.

— Posi s'jam i bindur! Ç'janë këto pyetje? — u zemërua ai.

— Më fal që të pyeta! — vazhdoi ajo. — Unë nuk i njoh punët e tua. Ti flet aq pak për to në familje. Por, ndruhem se mos gabosh. Me sa të njoh, ti e ke zakon të qëndrosh me kokfortësi në mendimet e tua. Po të ishte i padrejtë propozimi i Andreas, pse do ta përkrahnin punëtorët?

— Ej, edhe kjo na duhej! — tha Petrua, me ironi. — Dashke të hedhësh kripë në punët e mia! Vështro mësimet më mirë, ato janë për ty!

Flora heshti e hidhëruar. I vëllai mori gazetën dhe nisi të lexojë. Ajo vështroi fytyrën e tij të ftohtë, indiferente dhe ndjeu se i thëri diçka përbrenda.

Lavjerësi i sahatit të murit përkundej majtas-djathtas, majtas-djathtas dhe tiktaku i tij sikur e theksonte heshtjen.

— Natën e mirë! — tha Flora dhe doli nga dhoma.

— Megjithatë, tregohu i kujdesshëm, mos shko kundër rrymës, Petro! — guxoi pas pak Ani. —

Ai nuk iu përgjegj. Vetëm bëri një grimasë padurimi.

— Sot ishte Ksanthipi nga ne! — ndërroi bisedë Ani, duke vënë pjatat në raft.

— Ah, ajo llafazanja!

— Llafazane, llafazane, por të tillat të marrin në qafë. Diç më tha për Florën.

— Çfarë? — pyeti përnjëherësh Petrua.

— E paskësh parë njëditëzaj në kinema me një djalë, shtatë gjer më nëndë.

— E pastaj, ç'të keqe ka?

— Jo, s'është gjë e madhe, por pse t'u japësh shkas të tjerëve për thashetheme?

— Flora nuk është e mitur! — tha Petrua.

— Sidoqoftë, duhet këshilluar nganjëherë, se vajzë është.

— Mirë, mirë! — ja preu ai. — I mbarove punët?

— Ja, edhe pak. Po deshe, shko e bjerë.

— Po shkoj. Ec shpejt, se mos më zgjuash. Ai fiku cigaren dhe u ngrit.

## 5.—

Arbeni bridhte ecë e jak në stacionin e autobuzave dhe vështronte shpesh orën. Atë pasdite fakulteti i tyre do të bënte një eskursion në malin e Dajtit dhe e kishin lënë të niseshin në orën dy e gjysmë nga kinostudjua, kurse ora ishte dy e njëzetepesë dhe Flora ende s'po dukej. Kur po e humbiste durimin dhe mendonte të nisej pa të, e pikasi tek nxitonte mes turmës së kalimtarëve.

Ajo e bëri pothuaj me vrap copën e rrugës që i kishte mbetur.

— Më fal, Arben, të bëra të presësh! — tha, duke marrë frymë dendur.

— Ky është një zakon i lashtë i femrave! — ja priti ai me ironi, por nga zëri kuptohej se i kishte kaluar sakaq zemërimi.

— Kur dola nga shtëpia, kujtova se kisha harruar pasa...

— Shpejt, se mbetëm! — e ndërpreu ai, duke e tërhequr prej dore.

Sa vunë këmbën në shkallën e pasme të autobusit, porta pneumatike u mbyll me tërsëllëm dhe ai u nis rëndë-rëndë. Ata zunë vend në cepin e platformës, pranë xhamit. Nënë rrotat e pasme buronte shiriti i gjerë e i murrmë i asfaltit, i spërkatur me gjethet që shkundte era. Kalimtarët dhe automjetet që lëviznin në sens të kundërt, duke-shin sikur nxitonin gjithnjë e më shumë.

— Kujtova se të kish ndodhur gjë, prandaj prita! — tha Arbeni.

— Harrova pasaportën dhe m'u desh të kthehem nga rruga!

Florës ende nuk i ishte qetësuar frymëmarrja dhe gjoksi i hovte dëndur. Faqet e saj, të veshura me një push të hollë e të ndritshëm, të skuqura dhe pak të djersitura, i ngjanin një pjeshke të ardhur e të lëngshme, të njomur nga vesa e mëngjezit.

— Ju vajzat gjithmonë harroni diçka! — e ngacmoi Arbeni.

— Më hutoi kunata! — tha Flora. «Moj e shkretë, ku do vesh?!», më thoshte. «Nuk shikon ç'thëllim që fryn, ç're ka në qiell? Tani është kohë për të qëndruar pranë sobës e jo për të tilla marrëzira!»



— Sa e brishtë qenka! — vërejti Arbeni.

— Ouuu! Ajo, po të laget pak, vjen me ngut në shtëpi, fut këmbët në ujë të nxehtë dhe pi një ibrik me çaj të vluar. Megjithatë, gripi s'i shqitet tërë dimrit.

Në stacionin tjetër autobuzi u mbush, sa nuk nxinte më dhe ata të dy u shtrënguan më tepër në cepin e tyre. Arbeni u ktheu shpinën pasagjerëve, shtrëngoi fort duart në hekurin mbajtës dhe mundahej ta ruante Florën nga ndrydhja. Nën gjoks i ndjente prekjen e supit dhe mjekra i çikte në flokët e saj ngjyrë kalliri, që lëshonin një kundërmim të athët, por të këndshëm.

— Jemi njëzetë minuta vonë! — tha ai.

— Mos u shqetëso, se aty do t'i gjejmë. S'e besoj të jenë mbledhur të gjithë. Mu duk sikur pashë Ibrahimin që hipi në stacionin e dytë.

— Ç'zakon i keq është mungesa e përpikmërisë; kurse sot po e shkel vetë!

— Për fajin tim! Të lutem më fal, Arben, por janë gjëra që ndodhin.

— Iku tani, u bë!

Autobuzi pakësoi shpejtësin dhe ndaloi në stacionin e fundit. Pasagjerët, të bezdisur nga ndrydhja, zbritën me ngut.

— Oh, sa mirë qenka jashtë! — tha Flora dhe mori frymë thellë.

— Ja shokët! — Arbeni tregoi me dorë nga cepi i sipërm i kinostudjos.

— Ja që i gjetëm! Të thashë unë.

— Tungjatjetani! Po të tjerët? — pyeti Arbeni, kur i arritën.

— U nisën gjer në gurore me një kamion! — iu përgjegj Rina, një studente e pakët nga trupi,

me syze. — S'na mori të gjithëve, se ishim shumë.  
— O burrani të gjejmë një tjetër, se na zuri nata këtu! — tha Ibrahim.

— Brrr, sa ftohtë që është! — ja bëri Hajria, një tjetër studente zeshkane dhe e kolme. — Ku ka më mirë se pranë sobës tani!

«I ngjaka kunatës së Florës kjo!» — mendoi Arbeni dhe i doli përpara kamionit që po vinte.

Makina ndaloi. Sakaq studentët e rrethuan nga të gjitha anët. Shoferi, një djalosh i parruar, me flokë të shpupurisura, nxori kokën nga dritarja, i vështroi me buzë në gaz dhe u a bëri me shënjë të hipnin. Dhjetra duar u kapën pas anëve të karrocerisë.

— Uluni, uluni të gjithë! — briti shoferi. — Përndryshe do t'u zbres!

— Ou, pse këtu do ulemi! — tha Hajria, duke vështruar me ndot karrocerinë e zhyer.

— Të kishe sjellë një kolltuk nga shtëpia! — iu shkreh Ibrahim.

Studentja me syze, e heshtur, shpalosi shaminë dhe e shtroi në një cep, andej nga fundi.

— Dil këtu se është më mirë! — i tha Arbeni, duke i liruar vendin.

— Faleminderit! — Ajo kapërxeu me ndrojtje gjer tek vendi i ri.

— Shpejt, se më vonuat! — tha shoferi. — U ulët të gjithë?

— Pooo! Jepi!

Pas pak kamioni përshkonte kthesat e kodrave të Linxës dhe godinat e Tiranës largoheshin dalëngadalë.

— Obobo, ç'erë! — tha Hajria dhe mbërtheu kopsën e sipërme të bluzës.

— Hajt, pa të shëron doktori yt ty! — e ngacmoi Ibrahimi.

Studentja me syze qe kuspullosur aq, sa dukej sikur nga një çast në tjetrin koka e saj e vockël do të humbiste nënë jakën e gjërë të xhakaventos.

Flora qëndronte me gjoks drejtë erës. I pëlqente freskia dhe fishkëllima e saj ndër veshë. Prej kohe nuk kishte udhëtuar ashtu dhe po çmallej. I dukej sikur po ngjitej përsëri drejt kantierit të dikurshëm.

Kur arritën tek gurorja, qiellit s'i kishte mbetur asnjë pëllëmbë e kthjellët. Në njësh kolonë, studentët filluan t'i ngjiten shtegut. Dëgjohej krisma e guriçkave nën këpucë, fëshfëritja e shkurreve që fërkoheshin pas këmbëve dhe rrallë ndonjë thirrje «merrni nga e majta», «mos shkëputni kollonën»...

Retë u dëndësuan dhe drita u pakësua. Era pushoi. Për ca kohë plakosi një heshtje e madhe, sikur natyra të ishte stepur. Pastaj filloi të bjerë shi, një shi i dendur dhe i hollë, që cikërinte mbi gjethet e shkurreve, mbi tokë dhe në bar. Natyrën sikur e përshkoi një dridhmë gjallërimi.

— Ububu, do bëhemi qullë! — tha Hajria.

— Mos ki frikë, se nuk je prej sheqeri! — e ngacmoi përsëri Ibrahimi.

Një mjegull e dendur po rrokullisej më të poshtë faqes së malit.

«Afrojuni pranë njëri-tjetrit!» — briti dikush nga krei i kollonës.

— Kur të zbresi mjegulla, shiu duhet të pushojë! — tha Flora.

— Ashtu qoftë! — uroi studentja me syze. — Më ka hyrë ujët në këpucë.

— Edhe mua. Nuk dëgjon sesi më pllaqurisin këmbët në to?

Mjegulla rrokullisej më të poshtë, duke marrë trajta të çuditshme dhe duke gllabëruar shkrepat, drurët, shtigjet. Ngjyrat e natyrës u bënë të zbehta, të shpëlara dhe pastaj gjithshka u tret në një bardhësi të lagësht. Piklat e shiut u imtësuan, u rra-lluan dhe cikërritja e tyre dëgjohej gjithmonë e më e shurdhër.

Flora mezi e dallonte siluetën e Rinës, që kishte përpara. Dëgjonte frymëmarrjen e saj të rëndë e të dendur dhe pllaquritjen e këpucëve në shtegun e lagur. Befas iu duk sikur po rijetonte diçka të njohur. Një klithmë që dëgjoi pranë saj e bëri të shkundet. Ngriti sytë dhe nuk e pa më siluetën e Rinës. Sakaq doli nga shtegu dhe, pa menduar se mund të rrëzohej, kërceu drejt tatëpjetës.

Rinën e gjeti të shtrirë buzë një proske. Ishte kapur fort, me të dy duart pas një kaçubeje dhe kishte mbetur e varur në faqen e rrëpirtë.

— Mos u tremb! — i tha dhe ra barkas kundrejt saj, duke ngulur fort majat e këmbëve mes gurëve.

Zgjati duart, e kapi shoqen nga krahët dhe filloi ta tërhiqte.

— Ç'ka ndodhur! — tha Arbeni, që mbërriti sakaq.

— Mbamë fort nga këmbët! — ja priti Flora.

Rinën e nxorën në breg, të lagur dhe të zhyer me baltë. Ajo dridhej e tëra nga tronditja dhe të ftohtit.

Flora zgjidhi çantën e shpinës dhe nxorri një bluzë tutash.

— Hiqe xhakaventon, se të është bërë qull dhe vish këtë! — i tha.

— Po ti? Je po kaq e lagur sa edhe unë.

— Merre, se s'më gjen gjë mua. Jam e mësuar.

— Ja edhe gjyslykët! — tha Arbeni. — Për fat, s'qenkan thyer. I gjeta mes shkureve! — I fshiu me shami dhe ja dha.

Pas pak u kthyen përsëri në shteg. Rina akoma s'e kishte marrë veten dhe shkeltë me ndrojtje. Arbeni iu afrua dhe e mbante nga krahu.

— Më falni, se ju bezdisa! — mërmëriste ajo, e shqetësuar. — Por s'kam ç'të bëj. Më vjen kaq inat!

— Ç'janë ato fjalë, Rinë! — e qërtoi Arbeni. — Ne shokë jemi. Së shpejti dalim tek një shteg i mirë dhe atje do ecësh vetë.

— Megjithatë, është kaq bukur! — tha ajo dhe u mundua të buzëqeshë. Nuk e kisha marrë kurrë me mend një pamje të tillë.

— Oiii! — klithi aty pranë Hajria.

— Ç'pate, moj?

— Më ra një pikë e madhe në zverk!

— Kjo do të thotë se hymë në pyll! — tha Ibrahim. — Kampi s'është larg. Guxim, të dashura shoqe! — Por i rrëshqiti këmba dhe ra ndënjur, mu në mes të shtegut. U ngrit sakaq, u shkund dhe si të mos kishte ndodhur gjë, ja mori këngës me një zë të trashë:

«Bashkojuni shokë me ne në çetë  
Malit të lartë, t'i shkojm' përpjetë...»

Mjegulla filloi të hollohet dhe prej saj dolën gjithnjë e më qartë siluetat e drurëve, me trungjet e tyre të lagur, që shkëlqenin butë. Prej tyre ku-

Ilonin pika të mëdha uji, që kërcisnin mbi legushë.

Kaluan pranë një përroi. Dy ushtarë, me mu-  
shama të qullura, po mbushnin një bidon të madh.

— Më pihet ujë! — tha Hajria dhe u afrua  
tek burimi.

Njëri nga ushtarët i nderi gavetën e tij të  
mbushur.

Ajo ngurroi, duke menduar «Uf! Gavetë ush-  
tari!». Pastaj, pak e ngatërruar, tha:

— Jo, faleminderit, desha vetëm të laj duart!

Flora e vështrou me inat, i mori gavetën nga  
dora ushtarit dhe piu.

— Më jep edhe mua! — tha Arbeni.

Ajo deshi ta shplante, por ai s'e la dhe piu  
në po atë anë.

— Urraaa, arritëm! — brohoriti dikush andej  
nga krei.

Një murmuritje gjallërimi përshkoi kolonën dhe  
hapat u shpejtuan pa vetëdije. Pas pak njëshkolona  
u shndërrua në një lëmsh të madh e të gëzueshëm  
studentësh, që vështronin me ëndje pamjen që u  
çelej nga veranda e pallatit të pionierëve.

Poshtë, përtej livadhit të madh, ndërej mje-  
gulla, si një det i bardhë e i paanë. Majat e dru-  
rëve, që dilnin prej saj, ngjasonin me dyrekët e  
ca anijeve fantastike. Një yll vetmitar zuri të  
shndrisë në horizont.

Rina po fshinte përsëri syzet dhe buzëqeshte  
si ndonjë fëmijë. Ibrahim mundohet të pastronte  
pantallonat. Hajria buzëvarur vështronte këpucët  
e lagura. Flora, duke qëndruar me njërin këmbë,  
shtrydhte çorapen dhe kërkonte me sy Arbenin.

Erdhi përgjegjësi i kampit dhe i ftoi të merr-  
nin në dorëzim dhomat. Veranda u boshatis. Stu-

dentët dhe bisedat u shpërndanë nëpër kthinat e katit të parë.

Flora zbriti ndër të parat. Zuri vend në njerën nga tavolinat e sallës së madhe dhe priti shoqet. Pas pak erdhi Hajria, e ndërruar dhe e rregulluar si për ditë feste.

— Flora, ti s'po më uron? — tha, duke u ulur pranë saj.

— Qenka e vërtetë pra se u fejova me një doktor?

— Po. Nuk gëzohesh?

Flora u mendua një hop.

— Të them të drejtën, më tepër çuditëm.

— Pse, nuk të duket i mirë ai?

— S'mund të them as i mirë, as i keq, se nuk e njoh. Vetëm çuditëm si ndërrove kaqë shpejt. Ti, para dy javësh, mendoje për një tjetër.

— S'është e vërtetë! — kërceu Hajria.

— Hajrije, mos kërko të më gënjesh! — e këshilloi Flora, butë. — Të kam parë vetë. Më gjithëse ke ndërruar rrugë, ke kthyer kokën mënjane ose ke bërë sikur rregulloje flokët, për të fshehur fytyrën, unë të kam njohur. Mos u trëmb, as i kam thënë e as do t'i them njeriu. Por, a mund të zgjidhet në këtë mënyrë shoku i jetës, si një fustan që sot të pëlqen kështu dhe nesër, ashtu! Mos u zemëro pse po ta them troç atë që mendoj. Nuk më pëlqen të flas prapa krahëve. Hajt, ngrije kokën dhe nëma dorën. Të daltë për mbarë dhe qofsh e lumtur!

— Faleminderit! — tha Hajria ftohtë, dhe iku.

Ndërkohë zbriti Rina, Arbeni, Ibrahimimi dhe të tjerët. Ca nga ca tavolinat u mbushën plot. Studentët shtruan mbi to ç'kishin sjellë për darkë,

morën ndonjë çaj a ndonjë birrë nga banaku dhe u shtruan të hanë. Për një copë herë bisedat u mekën, pastaj gjallëria shpërtheu përsëri.

Dikush propozoi të vallëzonin. Propozimi u rit me duartrokkitje dhe sa çelje e mbyllje sytë, tavolinat u mënjanuan, orkestra u sajua aty për aty, dhe mbrëmja e vallëzimit filloi.

Radhën e parë Flora nuk arriti të kërcejë me Arbenin, se e ftoi më parë një shok tjetër. Ajo dëshiroi që melodia të mbaronte sa më shpejt, po ata të orkestrës, sikur t'ja bënin për inat, e zgjatën shumë. Me të filluar tingujt e së dytës, Arbeni, që i kishte ardhur pranë se qe krizë për dama, e zuri për dore dhe e tërhoqi drejt mezit të sallës.

Ajo u mbështet me ëndje në supin e tij dhe nisi të vallëzojë. E pushtoi një ngazëllim i çuditshëm. Ndjehej e lehtë, e lehtë, si pëndë. Do dëshironte të shkëputej nga toka dhe të fluturonte bashkë me të. Sa herë ndjente në bel shtrëngimin e dorës së tij, e përshkonin mornica të ëmbla. I vështronte gjoksin muskuloz dhe kishte mall të mbështetej në të.

— E paske mjaft të lagur xhaketën! — i tha.

— Kurse ti, flokët. Të bien era mjegull.

— Të tuat qënkan tharë. I ke më të shkurtëra!

— buzëqeshi ajo dhe e vështroi në sy.

Nëpërmjet vështrimit, një fluks i padukshëm dhe shqetësonjës kaloi nga njëri tek tjetri.

Arbeni i ndjente çikjen e gjoksit, dorën mbi sup dhe dëshironte ta shtrëngonte fort, fort. Në ato çaste tingujt e muzikës i kumbonin në bren-dësi dhe sikur dridheshin bashkë me ndjenjat e tij të thella, të fshehta dhe aq të bukura.

Porta e jashtme u çel me vrrull dhe bashkë



me rrymën e ajrit të ftohtë, hyri një student me flokë të shpupurisur.

— Nesër do kemi kohë të mirë. Ngjitja në majë ka për të qënë e mrekullueshme! — tha ai, me zë të lartë. — Qielli është plot me yj.

— Sa i bukur duhet të jetë! — pëshpëriti Flora.

— Dalim e vështrojmë? — tha Arbeni.

Ajo miratoi me kokë.

— Ej, ej, ku shkon? — iu sul Ibrahim. — Këtë radhë ma ke premtuar mua.

— Dua të vështroj pak qiellin me yj! — tha Flora. — Do të kthehem.

Dolën në verandë. Atje poshtë vezullonin kjar-të dritat e Tiranës. Mbi qytet shtrihej një brez i ndritshëm që tretej dalëngadalë në errësirën e paanë të qiellit plot yje të panumurt. Ata dukeshin më të afërt dhe më xixëllonjës se zakonisht.

— Ja, atje duhet të jetë apartamenti juaj! — tha Arbeni, duke treguar me gisht një pikë të papërcaktuar në atë pellg dritash.

— Kurse atje, konvikti juaj! — tha Flora. — Ç'bukuri!

Si gjithmonë pas shiut, ajri që i mbushur me kundërmime të freskëta, ndër to shquhej aroma e dheut të lagur dhe legushës së pyllit.

— Eja të zbresim gjer tek livadhi! — tha Arbeni dhe i zgjati dorën.

Ndjenë sesi shtrydhej bari nën këmbët e tyre. Zhurmat e sallës dhe tingujt e muzikës u larguan. Dëgjoheshin më kjashtë fëshfëritjet dhe pipëtimat e panumërta të natës.

Ata ngadalësvan hapin, pastaj qëndruan.

— Sa e mirë je ti, o trimëresha ime! — pëshpëriti Arbeni dhe i shtrëngoi lehtë dorën.

Mbetën të shtangur përballë njëri-tjetrit. Secili e ndjente se kishte ardhur çasti i dëshiruar.

Ai ngriti ngadal dorën, i përkëdheli flokët e lagur dhe e tërhoqi butë pranë vetes. Ajo i mbështeti kokën në gjoks, shtrëngoi fytyrën në të dhe i nuhati me ëndje kundërmimin e trupit. Pastaj ndjeu pëllëmbat e tij mbi faqe. Ngriti vështrimin dhe ja pa nga afër buzët gjysmë të çelura, që kërkonin të sajat, i ra në fytyrë fryma e tij dhe pastaj i ndjeu mbi gojë buzët e lagëta e të ngrohta. Zgjati duart drejtë kokës së tij, i futi me mall gishtat në flokë dhe e shtrëngoi fort.

Qëndruan një copë herë të përçafuar dhe vështruan natën që nderej para tyre, me gjithë bukurinë dhe fshehtësinë e saj.

Florës i vinte të bërtiste me zë të lartë, aq sa ta dëgjonin gjer dhe banorët e Tiranës, atje larg:

«Hej, njerëz, sa bukur qënka kur dashuron!»

## 6.

Orari i punës ishte në të mbaruar dhe Petro Lisi po përgatitej të dilte, kur ja mbërriti përgjegjësi i repartit të tretë.

— Hë, Kastriot, ç'ka ndodhur? — e pyeti Petrua, duke mbyllur sirtarin e tavolinës.

— Shoku kryeinxhinier, zyra e planit na solli për zbatim një porosi të re.

— Mirë, e pastaj?

— Por, ne ende nuk kemi përfunduar porosinë e tregëtisë! Do ketë ndonjë ngatërresë në këtë mes!

— Nuk ka asnjë ngatërresë!

Përgjegjësi i repartit mbeti i çuditur.

— Ju i përfunduat gjysmat e artikujve të tregëtisë, apo jo? — nisi ta sqarojë Petrua.

— Po.

— Bukuri. Pjesën tjetër do t'ua prodhojmë në Janar. Ndërkohë do të plotësojmë disa nevoja urgjente të një enti tjetër.

— Por, këto nevoja nuk duken të jenë aspak urgjente! — tha Kastrioti.

— Këtë e çmon më drejtë drejtoria e ndërmarrjes! — ja preu Petrua.

— Kemi kohë që po e zvarrisim porosinë e tregëtisë! — nguli këmbë Kastrioti. — Dihet, artikujt e saj nuk ngrenë ndonjë peshë të madhe në realizimin e planit të uzinës, por janë të nevojshëm për popullin. Në treg mungojnë këta artikuj. Ne duhet t'i prodhojmë sa më parë shoku kryeinxhinier.

— Do t'i prodhojmë, pra! Ja, erdhi Janari! — u mundua ta hiqte qafe Petrua. — Pastaj ti, more Kastriot, sikur të ishte përfaqësuesi i tregëtisë dhe jo punonjës i uzinës sonë.

— Dje u ndodha në një dyqan, shoku Petro. Dëgjova plot njerëz që kërkonin artikuj nga ata që ne duhej t'i kishim prodhuar me kohë. Më erdhi turp. A na lejohet ta zvarrisim ende këtë punë, vetëm e vetëm pse porosia e re është më e leverdisshme për tejkalimin e planit? Ky tejkalim nuk do të ishte i ndershëm.

— I paske marrë së prapthi ato që të thashë! — u zemërua Petrua. — Nuk është fjala aspak për tejkalime plani, po për të plotësuar disa porosi që drejtoria i ka çmuar të ngutshme, pavarësisht në se ti i gjen të tilla ose jo. Prandaj, zbatoni urdhërin.

Petrua vështroi orën, u ngrit nga tavolina dhe veshi pardsynë.

Kastrioti nuk luajti nga vendi një çast, pastaj u kthye përnjëherësh dhe tha:

— Megjithatë, ky nuk është një urdhër i drejtë, kryeinxhinier!

Doli i zemëruar, pa përshëndetur.

«Si shumë e ka ngritur hundën ky!» mendoi Petrua. — «Dale, pa do vijë rasti që t'ja ulim ca!»

Mbylli zyrën dhe u nis të hante drekë në mensë, po rrugës ndërroi mendim. I qe tekur për një gotë birrë dhe vendosi të shkonte tek një bufe e afërt, që zakonisht mbante meze të freskëta dhe të mira.

Me të hyrë në lokal, e goditi një re tymi, që kundërmonte duhan dhe yndyrë të djegur. Pranë banakut gjeti xha Vasilin, një ndër mjeshtërit më të vjetër të uzinës, bashkë me të cilin kishin punuar për montimin e shumë makinerive të uzinës.

— Si je, xha Vasil? Kemi kohë pa u takuar! — iu drejtua, duke i zgjatur dorën.

— E ku do takohemi, more bir! — ja priti ai, me një buzëqeshje dinake. — Ti atje sipër, në zyrë, me punë të mëdha si duket, kurse unë, si gjithnjë, në repart.

— Hej, xha Vasil, si s'hoqe dorë nga romuzet ti! — buzëqeshi Petrua. — Pandi, një birrë dhe një meze të përzier! — porositi pastaj.

— Siurdhëron! — buçiti banakieri, një burrë i thinjur e rrumbullak që jepte e merrte me klientat, shishet, gotat dhe salçiqet që piqeshin në skarë, duke çercëritur e duke kulluar yndyrë mbi prush.

— Urdhëro, vëllaço! — tha, duke i vënë Petros porosinë përpara.

— Me Pandin jemi miq të vjetër! — iu drejtua xha Vasilit Petrua. — E kemi patur guzhinier, kur ishim vullnetarë në hekurudhën e parë. Të kujtohet, Pandi?

— Më kujtohet, posi, vëllaçko! Më duket sikur ishte dje. Mban mend si m'i thyenit xhamat e guzhinës me top? Të fortë ishit, bre! Mbarnit gjithë ditën dhë me tezga, pastaj luanit edhe futboll... Urdhëroni, gati birra!... Dhe nuk i bënit naze hiç gjellës time, sado që atje e mësova zanatin dhe helbete... Obobo, mu dogjën salçiqet! — Pandi rrëmbeu mashën dhe u kthye nga skara.

— Sa e bukur më duket tani ajo kohë, xha Vasil! — tha Petrua.

Heshti një çast, si për të rikujtuar pesëmbëdhjetë vjetët e shkuara, piu një gllënjë birrë dhe vazhdoi:

— Më kujtohet sesi mbrëmjeve, i këputur nga puna e nga loja, shtrihesha në dyshekun prej kashte dhe ëndërroja syhapur për të ardhshmen, gjersa më mundte gjumi. Për ç'nuk ëndërroja atëhere! Ej, rinia, rinia...

— Se mos tani u plake! — tha xha Vasili, duke përtypur një copë salçiçe.

— Sidoqoftë, ndryshe është! Ja, tani shumë nga ato që ëndërroja, i kam arritur, por megjithatë sikur isha më i lumtur atëhere.

— Shiko, more bir! — filloi xha Vasili, duke fshirë buzët me kurrizin e dorës, — Ndonjëherë njeriut i duket se gjithshka që mund të arrihet në jetë, e ka arritur. Atëhere fillon të mendojë si mund ta ruaj dhe ta plotësojë atë që ka fituar. Nuk ka më qëllime të mëdha, dëshira të mëdha. Këtu fillon plogështia, mërzia. Se, ujët që nuk

rrjedh, zë erë. Dhe ujërat e ndënjura, vetëm bretkocat i pëlqejnë.

— T'jua mbush edhe nga një? — pyeti Pandi, duke treguar me gish gotat e tyre të zbrazura. — Birra është e mirë, si për të rinjtë ashu edhe për pleqtë.

— Mbushnai! — tha Petrua, duke ja afruar gotat. — Sot e paske të freskët.

— Unë gjithmonë të freskët e mbaj. Urdhëroni birrat. Edhe nga një meze të përzier? Po? Ja, në minut!

— Për shëndetin. tënd, xha Vasil! — uroi Petrua, duke ngritur gotën.

— Faleminderit. Shëndet paç! — ja ktheu ai. — Jam i gëzuar që e solli rasti të shkëmbejmë dy fjalë bashkë.

— Vërtetë, rrallë jemi takuar kohët e fundit.

— Rrallë e për mall. Dikur ndodhte ndryshe. Apo ke harruar?

— Nuk harrohet ajo kohë, xha Vasil. Sa herë e kemi gdhirë bashkë, duke montuar makineritë, sa herë na ka nxjerrë nga sikleti përvoja tënde dhe kjo qesja e duhanit, që s'e paske ndërruar. Të kujtohet sa u lodhëm me montimin e repartit të tretë?

— Posi. Tri herë u a ndërruam vendin makinerive, po pastaj ua gjetëm kararin, ama!

— Kurse tani kanë dalë ca të zgjuar, inxhinier Andrea me ca të tjerë, që thonë se organizimi i këtij reparti s'qenka i mirë.

Xha Vasili u mendua një copë herë, duke rënuar me gishta në qesen e duhanit.

— Kushedi, mund të kenë të drejtë! — tha pastaj. — E mira s'ka kurrë fund.

— Ej, posi! Erdhën e i gjetën të gjitha gati

dhe tani duan të shesin mend! — tha Petrua, me qesëndi.

— Në i paçin të mira, le t'ua blejmë! — buzëqeshi xha Vasili. — Ne e ngritëm repartin, ashtu siç na u duk më mirë, por koha s'qëndron në vend. Atëhere përvoja ime dukej punë e madhe, kurse tani janë plot mjeshtra në uzinë, që dinë më shumë se unë. Ti ishe atëhere i vetmi inxhinjer i uzinës, sot janë edhe pesë të tjerë. Shumë kokë mendojnë më mirë se një e vetme. Ndoshta me të vërtetë duhet ndryshuar organizimi i repartit të tretë!

«Mos ja kanë mbushur mendjen edhe këtij!»  
— dysmoi Petrua.

— Do studjuar thellë kjo punë! — tha, duke i bërë bisht kësaj bisede. Dhe tani, le ta pijmë me fund, se duhet të kthehemi në punë! — vazhdoi, duke marrë gotën e birrës. — Gëzuar, xha Vasil!

— Gëzuar qofsh!

Petrua iu afrua banakut dhe pagoi për të dy, pa i përfillur kundërshtimet e mjeshtrit.

— Faleminderit dhe na urdhëroni përsëri! — i përshëndeti me bujë Pandi ndërsa po delnin.

Ecën të heshtur, gjer në uzinë. Petrua mendonte për punët që e prisnin atë pasdite, ndërsa mjeshtri, për bisedën që kishin bërë.

Ishte i pakënaqur xha Vasili. Kishte dashur t'i thoshte diçka më shumë Petros, kishte dashur ta qortonte pse nuk tregohej i afërt dhe i përzemërt me njerëzit, si dikur. Edhe përzemërsia që kishte treguar karshi tij gjatë takimit, i qe dukur e thatë, e shtirur, si një lëmoshë, edhe mënyra si kishte ngulur këmbë të paguante, i qe dukur si gjesti i një njeriu që do t'i bëjë nder vetes, jo tjetrit. Nuk

e dinte ç'e kishte penguar që t'ja thoshte të gjitha këto, fundi i papritur i bisedës, apo ndrojtja. Inatosej me vetveten, duke dyshuar mos edhe ai, që dikur e trajtonte Petron si birin e vet, kishte filluar të ndruhej prej tij.

— E po, mirupafshim! — i tha Petrua kur arritën tek porta e uzinës, duke i zgjatur dorën.

— Mirupafshim. Kujtona më shpesh, Petro! — ja ktheu mjeshtri, duke psherëtitur. — Në mos u kujtofsh për mua, s'prishet gjë, po për njerëzit tanë, për repartet...

— Ç'tu bësh punëve, xha Vasil! — e ndërpreu Petrua, me një buzëqeshje të shtirur.

— Për ç'punë thua, për ato shkresurinat që djeg Aspasia mbrapa uzinës? — shpërtheu xha Vasil. — Ti nevoitesh më shumë këtu, more djalë!

Ai tregoi me gisht portën, ku po hynte dhe u zhduk mbrapa saj, duke mërmëritur diçka.

Petro Lisi i ngjiti shkallët me një ndjenjë të papëlqyeshme, që ja kishte lënë biseda me xha Vasilin. Zyra iu duk e ftohtë. Mbylli dritaren, vuri në prizë reflektorin elektrik, pastaj zuri vend në tryezë dhe nxori nga sirtari dosjen «Çështje që presin zgjidhje».

«Si nuk mbeti një herë bosh kjo!» — mendoi, duke e shfjetuar me bezdi.

Duhej t'u përgjigjej disa shkresave, kishte për të hartuar edhe një informacion për dikasterin. Nuk i bëhej të fillonte dhe, që të kalonte koha, nisi të mprehë majat e kalemave me një kujdes të tepëruar. Pastaj rregulloi takëmin e bojës, shpërdrodhi kordonin e telefonit, zbrazti tavllën e cigareve, por së fundi e detyroi veten të fillonte.

Nuk i ecte kalem. Frazat i dilnin të gjata, të



ndërlikuara, me përsëritje fjalësh. Më shumë prishte me gomë, sesa shkruante e, megjithatë, s'po nxirrte gjë në dritë. Për një çast i doli para syve Aspasija, tek digjte shkresat e vjetra mbrapa uzinës dhe iu neverit pura që po bënte. Mblodhi shuk fijen e letrës që kishte përpara, e flaku në shportë dhe brofi nga tryeza. Siç e kishte zakon, kur nevríkosej, filloi të endej nëpër zyrë, duke thithur shpesh cigaren. Si u qetësua disi, u kthye përsëri në tryezë.

«Tek e fundit, mua më presin!» — mendoj, duke marrë nga sirtari një fije të re letre, i vendosur t'i jepte fund punës së filluar.

Sapo kishte mbaruar hyrjen e informacionit dhe pikërisht kur po i goditeshin më mirë frazat, e ndërpreu një trokitje në portë. Hyri Andrea, duke u kolovitur mbi këmbët e tij të gjata. Erdhi e qëndroi buzë tavolinës dhe mbështeti njëren pëllëmbë në të.

«S'mu nda ky!» — mendoj Petrua. E vështroi një hop në mënyrë pyetëse, pastaj i uli përsëri sytë.

— Erdha të pyes për mbledhjen e këshillit teknik! — tha Andrea.

Petrua nuk iu përgjegj, dhe as që i ngriti sytë nga fija e letrës, që kish përpara.

— Kaluan dy javë që kur e paraqitëm studimin për riorganizimin e repartit! — vazhdoi Andrea.

— Shokët duan të dijnë se kur do të shqyrtohet.

— Këshilli teknik ka një program të caktuar mbledhjesh! — tha Petrua. — Nuk mund ta thërrsim me kohë e pa kohë. Në mbledhjen e parë do të shqyrtohet dhe propozimi yt.

— I kolektivit të repartit! — e korrigjoi Andrea. Po, kur do të bëhet kjo mbledhje sipas programit?

— Të mërkurër, që vjen.

— Domethënë, pas afro dy javësh të tjera?

— Po.

— Kjo çështje po zvarritet! — u zemërua Andrea. — Ne kërkojmë që këshilli teknik të mblidhet sa më parë.

Petro Lisi heshti, gjithnjë me sytë të mbërthyer në informacionin që po hartonte.

Andrea e ndjeu veten të fyer nga ky qëndrim. Në majë të gjuhës i erdhi t'i thoshte, «ngreje vështrimin, se po flet me një shok!», por e përmbajti veten.

— Njerëzit presin t'i përvishen punës, kurse ju po i pengoni, shoku Petro! — tha, ashpër.

— Do t'ua njoftoj anëtarëve të tjerë të këshillit teknik kërkesën tuaj! — u përgjigj Petrua, sikur po i drejtohej murit. — Nesër ju them përfundimin.

Mori lapsin dhe vazhdoi të shkruante informacionin. Nuk e ngriti kokën gjersa u largua Andrea, i cili doli duke përplasur derën. Pastaj, me një lëvizje nervoze, i prishi ato që kishte shkruar, e shtyti mënjanë fijen e letrës dhe u kredh në mendime, duke brejtur me dhëmbë bishtin e kalemit.

«U mblodh lëmshi! — mendonte. — Duhet të marrë një farë fundi kjo çështje...»

Qe mësuar t'i shkante fjala në këshillin teknik. Shpresonte se edhe kësaj radhe nuk do të ndodhte ndryshe. Të paktën, do të arrinte ta shtynte riorganizimin për vitin e ardhshëm. Në fakt, edhe ai vetë që i bindur për nevojën e këtij riorganizimi. Po t'i kishte shkuar ndër mend atij të parit, ndoshta do të ishte dakord që të zbatohet menjëherë. Kësaj radhe i kishte shpëtuar inisiativa nga dora. Një tjetër, ose disa të tjerë donin të reviziononin veprën e tij. Kjo nuk i pëlqente.

«Ka për të qënë e vështirë fitorja kësaj radhe! — i thoshte një zë i brendshëm. — Duhet përgatitur mirë!»

Mori në telefon zyrën e planit.

— Alo, Astritin desha pak... Astrit, të lutem më nxirr gjithë detyrat e repartit të tretë, gjer në fund të vitit. Çdo detyrim që ka ndaj reparteve të tjerë... Po, po, të gjitha, me hollësi.

«Duhet çuar gjer në fund kjo punë!» — mendoi, duke lëshuar receptorin e telefonit.

Në zyrë ishte qetësi. Që poshtë vinte zhurma e punës së reparteve, si një bubullimë e largët dhe e pandërprerë.

## 7.

Doktoresha Ani hoqi fonendoskopin nga veshët, e mblodhi lëmsh dhe e futi në çantën e vogël prej lëkure.

— Fëmija s'ka gjë! — i tha së ëmës. — Visheni!

— Atëhere, pse grindet kaq shumë, doktoreshë?

— Do t'i kini prishur regjimin e ushqimit.

Tregoni më tepër kujdes!

— Po ndonjë recetë, nuk do më jepni?

— Nuk ka nevojë.

Ani vështroi orën, e bezdisur. Sapo kishte kaluar nga gjashta.

— Obobo, u vonova! — tha dhe shkopsiti mantelin e bardhë.

— Doktoreshë, kanë mbetur edhe dy vetë. Do t'i prisni? — pyeti infermiera e shërbimit.

— Nuk mundem! — tha Ani. — Kam lënë takim me tim shoq dhe jam vonë. Në paçin urgjencë, drejtoi tek mjeku i rojes. Të lutem, rregulloje këtë punë!

Shkoi tek lavamani dhe filloi të sapunisi duart. Pastaj, ndërsa përtej derës së bardhë të kabinetit ata që kishin pritur po bënë fjalë me infermieren, ajo rregulloi flokët, forcoi të kuqt e buzëve dhe veshi pardesynë.

Doli si plumb nga dera dhe gjersa arriti tek fundi i shkallëve nuk e ktheu kokën, as majtas, as djathtas.

Në rrugë mori frymë, e lehtësuar. Pas atyre orëve të gjata që kishte kaluar në ajrin e mbyllur të ambulancës, e kënaqi filladi i freskët i mbrëmjes. Vështroi përsëri orën dhe nxitoi hapat.

Takimin me Petron e kishte lënë përballë mapos. Do të shkonin në provën e parë të palltos së saj, pastaj në kinema.

Trotuari i rrugës së barrikatave ishte i cytur me kalimtarë. Sado që mundohej të dredhonte midis tyre, e bezdiste heraherë çikja e ndonjë bërryli. Dëgjonte fragmente bisedash, zvarritje e trokitje këpucësh në trotuar, zhurmë automjetesh, vështronte vajtje-ardhjen e pandërprerë të njerëzve dhe ndjente një marrjemendsh të lehtë.

Së largu vuri re dy kolegë të vjetër, që s'i kishte takuar prej kohe. Kur kaloi pranë tyre, i përshëndeti shkurt, pastaj menjëherë ktheu kokën nga reklamat e kinemasë.

«Ç'më duhet të ndaloj me ta në mes të rrugës!» — mendoi.

Petron e gjeti tek vështronte vitrinat.

— U vonove! — e qërtoi ai dhe i futi krahun.

— Mezi shpëtova nga vizitat. Pastaj, ka kaq njerëz trotuareve, sa nuk nxiton dot.

Në sallonin e rrobaqepësisë kishte plot klientë dhe mjeshtri, që të mos humbisnin durimin, i merr-

te me të mirë duke i drejtuar kujt një fjalë, kujt një pyetje e kujt një buzëqeshje.

Ani zuri vend në kolltuk dhe shfletoi një revistë mode, kurse Petrua, i mërzhitur, si gjithmonë në të tilla raste, sodiste rrugën nëpërmjet xhamit të madh të sallonit. Kur i erdhi radha Anit, ai vështroi i shkujdesur provën dhe aprovoi çdo mendim ose vrejti të mjeshtrit që nguli e shkuli gjilpëra, bëri vija me sapunin e rrobaqepësit dhe lëvdoi thurrjen origjinale të stofit.

— Mezi e gjeta! — tha Ani. — Stofat e mapos nuk janë të këqia, por ç'e do, prej tyre kanë të gjitha. Kurse kjo është diçka e veçantë, apo jo?

Mjeshtri aprovoi me një buzëqeshje të shtirur dhe i dha fund provës duke uruar «me shëndet».

— Po tani? — pyeti ajo, sapo dolën nga rrobaqepësia.

— Më pihet një kafe! — tha Petrua. — Shkojme në pasticerinë «Tirana»?

— S'thua keq. Edhe mua më hahet diçka. Atje mbajnë torta të freskëta. Por nuk jam e veshur!

— Ecë, se mirë je!

— Posi, mirë jam, me rrobet që mbaj në punë!

— Ecë moj, se atje nuk vijnë për të parë rrobet e tua!

— Ashtu kujton ti, po ta dish sa vëmë re ne gratë! Megjithatë, vemi. Po e mbaj pardesynë edhe në lokal. Të mirë e kam.

Lokali ishte i qetë dhe kamarjerja u vajti menjëherë. Petrua porositi, ndezi një cigare dhe vështroi njëherë nga tablotë e mëdha përballë: Sipërfaqen e qetë dhe plot reflekse të liqenit artificial, djaloshin që peshkonte buzë tij dhe malin e Dajtit përtej, të kredhur në dritën e kuqërremtë të perë-

ndimit. Ndjeu mall për të jetuar çaste të atilla  
prehjeje dhe qetësie.

— Pse je kështu, i hutuar, Petro? — pyeti  
Ani, duke e lënë përgjysmë tortën.

— Hë, si the, i hutuar? — u përmënd ai.

— Po, po, i hutuar! — përsëriti ajo. — Ke gjë?

— Jo, jam fare mirë.

Ani filloi përsëri të hajë tortë, duke këpu-  
tur prej saj copa të vockëla.

Petrua vuri re kafënë që po ftohej, e rufisi gjer  
në fund dhe ndezi një cigare tjetër.

— Sot patëm një mbledhje në ministri! — tha.  
— Gjatë pushimit ministri ma hodhi fjalën larg e  
larg, nëse do dëshiroja të transferohem në uzinën  
e re që po ndërtohet.

— Ku? — e ndërpreu Ani, që iu duk sikur  
copa e tortës i mbeti xhëng në gjoks.

— Këtu, në Tiranë.

— Gjene mirë! — Anit iu tret xhëngu. — Thua  
ta kenë vendosur?

— Nuk e besoj.

— Po ti, ç'i the?

— As po, as jo. Ç'është e vërteta, më josh  
ky propozim.

— Më e madhe është rroga atje?

— Nuk e di. S'e besoj. Por uzina është më e  
rëndësishme. Sigurisht, në fillim do ketë ca telashe...

— Ç'je i marrë! — e ndërpreu Ani, duke shtyrë  
mënjandë pjatëzën e boshatisur. — Nuk mjafton sa  
u rropate për t'i vënë punët në vijë këtu ku je,  
por t'ja fillosh përsënjëzaj gjetkë! Kësaj i thonë, si  
breshka tek nallbani. E ke në dorë t'i shmangesh?

— Besoj se po. Aq më tepër se edhe drejtori i  
uzinës nuk është dakord.

— Ta merr mendja. Ti ja bën punën. Të ishte fjala për ndonjë vend më të mirë, në universitet për shëmbëll, hajde de, por të biesh nga shiu në breshër!. Rri, more burrë, vështro shëndetin dhe hallet e familjes tënde!

— Mirë, mirë! — ja bëri Petrua, duke fërkuar duart me një shprehje kënaqësie. — Shohim e bëjmë. Sidoqoftë, kjo do të thotë se ata ma dinë vlerën. Të pëlqeu torta? — e pyeti me një zë gazmor.

— Shumë e mirë ishte.

— Do edhe një tjetër?

— Jo, se më pret oreksin.

— Ohu, gjersa të hamë darkë!... Kamerjere, edhe një tortë, të lutem!

Kamarjerja vonoi këtë radhë; se qenë shtuar klientët. Bashkë me ta shumoheshin bisedat, tingëllimat e qelqurinave, lëvizjet e karigeve, dhe tymi i duhanit.

Në tri tavolinat aty pranë, të vendosura njëra pranë tjetrës, po festohej një fejesë. Nusja, që pikasej se ishte e vetmja femër e re dhe me buzë të paskuqura, rrinte me turp dhe mezi hante diçka nga torta që kishte përpara.

Ani e vështroi me nostalgji, sepse i kujtoi fejesën e saj. Pastaj i tërhoqi vëmendjen dikush që kërkonte cigare në banak.

— Petro, e shikon atë djaloshin atje? — tha, duke i rënë të shoqit me bërryl. — Ja, atë me flokë të zez dhe pardesy gri.

Ai ktheu kokën dhe e vështroi me indiferentizëm.

— E pashë. E pastaj?

— Është Arbeni, ai studenti që shoqërohet me Florën! S'është çudi që ajo të jetë jashtë, duke e pritur.

— Ashtu? — Petrua u ngrys në fytyrë.

— E ka zgjatur, e ka bërë tërkuzë me të! — tha ajo. — Kudo bashkë janë, në bulevard, në kinema, në teatër, e bile nëpër parqe:

— E moj, se i shtojnë bota!

Ai bëri me dorë një gjest mosbesimi.

— Posi, i shtojnë bota! — tha ajo, me ironi. — Unë i kam parë vetë. Dje i ndesha ballëpërballë. Kujtova se mos u vinte rëndë dhe ktheva kokën, po motra tënde s'deshi t'ja dinte hiç. Madje më foli.

— Pa shiko, pa shiko! — ja bëri Petrua, duke tundur kokën. — Ndoshta i ka dhënë fjalën se do ta marri!

— Posi, në atë krah fli ti! Se mos ka mend për martesë ai. Është akoma student dhe prindërit mezi e presin të mbarojë, se janë nevojtarë. Ja, do bredhi ca kohë me të, sa t'i mërzhitet, pastaj do t'i kthejë krahët. Ti e ke fajin për këtë, ta dish!

— Pse e paskam unë?

— Sepse nuk ja mblodhe qysh në fillim, pa u trashur puna. Unë e shkreta të thashë, të dola borxhi, por nuk më dëgjove!

— Flora është e rritur tashmë dhe s'mund t'i ndërhyj vend e pa vend në punët e saj! — tha Petrua. — Megjithatë, do bisedoj.

— Të bisedosh, posi! — tha Ani. — Se në bëtë ndonjë proçkë, turpi të zë edhe ty.

— Mirë, mirë! — ja preu ai dhe ktheu kokën nga ana tjetër, për ta mbyllur atë bisedë.

Thirri kamarjeren, pagoi dhe e ftoi Anin të dilnin. Ishte i shqetësuar.

— Po të përcjell gjer tek autobuzi! — i tha. —

— Si, nuk do vemi në kinema! — u çudit ajo.



— Tjetër herë. Sot më doli një punë. Do ta kohem me dikë për disa halle të uzinës.

— Si të duash.

Ajo uli kokën dhe eci pranë tij, pa nxjerrë fjalë nga goja.

«Ky paskësh qenë programi i bukur i mbrëmjes, që më premtove me aq bujë!» — mendoi dhe një buzëqeshje e hidhur iu vizatua në çipat e gojës.

Ndjeu sesi trishtimi po i mblidhej lëmsh në grykë. Vuri re shoferin e autobuzit urban që zuri vend pranë timonit dhe nxitoi. Tani dëshironte të ikte sa më parë. Të paktën, të çlirohej nga përpjekja që bënte për të fshehur zemërimin.

U ngjit me ngut në shkallinën e autobuzit, lëshoi monedhat mbi tryezën e vogël të faturinos, zuri vend pranë xhamit dhe mbështeti ballin në të.

Në krah të saj u ul një plakë e trashë, e cila lëshoi pranë këmbëve një torbë të madhe. Plaka dhe torba përhapnin një erë të rëndë thartire, që ja cingërisi më keq nervat.

U ngrit dhe çau rrugë gjer te krei i autobuzit. Shtrëngoi dorën tek mbajtësja dhe vështroi pa interes parakalimin e shpejtë të vitrinave dhe të kalimtarëve.

Zbriti gjithë inat në stacion, kapërxeu pa kujdes rrugën dhe i ngjiti me një frymë shkallët e apartamentit. Në krein e tyre, mu përpara portës, gjeti djalin e Ksanthipit, që po luante me baltë. E mbërtheu prej veshi dhe ja tërhoqi me një kënaqësi të egër, gjersa ai uluriti me të madhe. Pastaj hyri në apartament, duke përplasur derën.

Shkoi drejt e në guzhinë. Ajo qe e ftohtë dhe e lagësht. Tani ndjehej më tepër kundërmimi i saj i veçantë. Çeli dritën. Edhe ndriçimi i saj iu duk i

ftohtë dhe i trishtuar. Zhveshi pallton dhe mbeti si e hutuar në mes të dhomës. Nuk dinte ç'të bënte.

Çeli derickën e sobës. E rëqethi prekja e akullt e metalit.

«Përsëri harrova të blej pishë!» — mendoi.

Ndezi zjarrin me vështirësi. Vuri gjellën mbi të. Lëmshi që i qe mbledhur në grykë po i tretej dalëngadalë dhe trishtimi, bashkë me gjakun, po i përhapej në të gjithë trupin. I ndjeu gjymtyrët të ngathëta. U lëshua mbi divan. Duart iu dergjën mbi prehër. Sytë i nguli në diçka të paqenë. Një copë herë mendimet e saj qenë të turbullta, pastaj u kthjelluan, u përqëndruan.

### 8.—

«Ja, kjo na paskësh qenë edhe martesë! Si e mendoja kur isha vajzë dhe si më doli! As dy vjet të lumtura dhe na tani: këputem gjithë ditës së punuari në ambulancë dhe në shtëpi dhe, kur vjen mbrëmja, mbetem si qyqe me të katër muret. Kurse im shoq bredh kafeneve. Gjoja hallet e uzinës. Posi! Gjithmonë kështu ndodh, kur është fjala për të më shpënë gjekundi.

Se mos është vetëm kjo! Atij prej kohe s'i ka qeshur buza. Vjen dhe ikën nga shtëpia si ndonjë hije. Tregohet i zënë me punë, i lodhur, bisedon pak dhe mezi pret të dali.

Pse vallë? Ai s'ka qenë i tillë.

Në fejesë dhe vitin e parë të martesës, tregohet aq i dashur me mua. Madje më ndihmonte sa mundej, megjithëse nuk i vinin ndoresh punët e shtëpisë. Atëhere të shumtat e mbrëmjeve i ka-

lonim bashkë. Bisedonim gjatë, llogarisnim kursimet dhe bënim plane për të ardhmen, se shtëpinë e kishim akoma bosh. Megjithatë ishim të lumtur, të paktën kështu më dukej. Kurse tani...

Qysh sivjet, në plazh, e vura re se Petros i pëlqente më tepër të bridhte me shokë, luante gjithë ditën xhol me ta dhe, kur shëtiste me mua, sikur e bënte për detyrim. Mendova se do qe diçka e përkohshme, por ja që s'doli ashtu. Ai po bëhet gjithmonë më i ftohtë, më i largët.

Mos ka gisht ndonjë femër në këtë mes? Nuk e besoj, Petrua s'është i tillë! Megjithëatë, kush ua di burrave?

Apo nuk më do? Po pse? Nuk i kam dhënë asnjë shkak për këtë. I kam qëndruar besnike jo vetëm me vepra, por edhe me zemër. S'më ka shkuar ndonjëherë ndër mend për tjetër mashkull. Sjelljet e mia, si në punë, ashtu edhe në shtëpi, s'kanë të sharë. Asnjë fjalë e keqe s'është dëgjuar për mua. Shtëpinë ja kam mbajtur si ska më mirë. Nga hiçi, arritëm që s'na mungon asgjë. Atij vetë s'i kam lënë gjë mangut. Farefisnin dhe shokët ja kam pritur dhe përcjellë për bukuri, motrën jo vetëm që ja pranova pa kundërshtuar, por kujdesem edhe për sjelljen e saj, fjalë e hidhur s'ka dalë kurrë nga goja ime. Atëhere, pse kështu?

Eh, jetë o jetë, sa e ngatërruar qënke! Ku ma ke kohën e vajzërisë! I gjeja të gjitha gati dhe isha e rrethuar me dashuri, kurse unë, budallaqia, ëndërrroja për martesë.

Kushedi sa herë kam qëndruar orë të tëra, e mbyllur në dhomën time, duke u munduar të përfytyroj atë që do bëhej burri im. Herë e imagjinoja me sy të mëdhej, të kaltër dhe shpatullgjerë, herë syzi dhe ballëlartë, por gjithmonë të pashëm dhe

pa tjetër të mirë, që të më donte fort. Kur njoha Petron, kujtova se gjeta njeriun e ëndërrimeve të mia. Ai m'u duk jo vetëm i pashëm, por edhe i sjellshëm e i pjekur, tamam burrë. Më vinte inat me prindërit e mi që hezitoinin aq, vetëm e vetëm pse ai nuk qe nga familja e njohur, s'kishte shtëpi të ngritur dhe kishte një motër për të martuar. Unë ngula këmbë atëhere, po atyre s'do t'u qe mbushur mendja, po të mos ishte çështja e transferimit tim kushedi se ku, sepse për gjashtë muaj mbaroja fakultetin. Sikur t'i kisha dëgjuar prindërit atëhere, mbase do të më kishte dalë për mbarë.

He, sa u gëzova atë ditë që shpallëm fejesën! Përqafoja nënën dhe babanë, qeshja me shkak e pa shkak, bridhja si e marrë nëpër shtëpi dhe kisha dëshirë t'ja tregoj kujtdo sihariqin tim. Gjer dhe maces i bërtita «kupton moj, u fejova!» dhe e shtrëngova aq fort, sa mjaulliti nga dhëmbja dhe më grici duart.

Sa e lumtur dhe krenare isha atëhere kur shëtisja me Petron! E shtrëngoja për krahu dhe përshëndesja buzagaz gjithë të njohurit. Dëshiroja të më shihnin sa më shumë syresh.

Më dukej sikur po më plotësoheshin gjithë ëndërrimet e vajzërisë. Shëtisnim ngado, s'linim shfaqje pa parë, shkonim në plazh, nëpër lokale dhe ishim përherë të gëzuar. Edhe pas martesës nuk ishim keq, sidoqë na mbuluan menjëherë hallet. Na duhej të paisnim shtëpinë, se Petrua nuk kishte pothuaj asgjë, kurse paja ime sikur humbi në ato dhomat boshe të apartamentit.

I kufizova sa munda shpenzimet dhe e nxirrja muajin vetëm me njërën rrogë. Për fat, nëna më kishte mësuar nikoqire. Lodhesha, por megjithatë isha e lumtur. Madje mundohesha ta lehtësoj Petron

nga barra e shtëpisë, se atëhere kishte shumë punë dhe kthehej gjithmonë i lodhur e i këputur. Ndodhte që atë e nxitja të delte shëtitje me shokë që të çlodhej, kurse vetë u përvishesha punëve. Nuk e ndjeja lodhjen, se e kisha shpirtin të lehtë e të gëzuar.

Tani s'na mungon gjë, por ç'e do, iku e shkoi dashuria. Po vallë, a më ka dashur ndonjëherë me të vërtetë Petrua?...

Pse të mos më donte? Unë isha e pashme, e mësuar, e paisur me edukatë të zgjedhur, siç i kishte hije një bije prej familjeje si e jona dhe mbi të gjitha, e pastërt si vesa. Asnjë njollë nuk pata në të kaluarën time.

Ka rastisur të më pëlqejë edhe mua ndonjë djalë, po kurrë nuk kam shkuar më tej se një vështrim ose një bisedë e shkurtër. Vetëm në ëndërrimet e mia kam shkuar më tej, por edhe atëhere me një ndjenjë të turbullt frike dhe turpi.

Unë dija ta përmbaja veten. Kur isha në vitin e tretë të fakultetit më pëlqente sa s'thuhet Agroni. Sytë e tij, sikur më shponin tejte, zëri i tij sikur jehonte në brendinë time, prekja e tij më shkaktonte mornica të ëmbla, por megjithatë kurrë s'pranova t'i shkoj në takim.

Ja, e tillë kam qënë unë. Kështu më kishin edukuar prindërit. Sidomos im atë ishte i rreptë. Gjersa mbarova shkollën e mesme, nuk më lejoi t'i prisja flokët, fustanet i mbaja gjithmonë tre gisht nën gju dhe të qepur thjesht, kurse këpucë me taka mbatha vetëm kur u fejova. Megjithatë prindërit nuk kurseheshin për mua. Më blinin çdo gjë të nevojshme për pajë. Shumica e fustaneve që kam sot; janë të asaj kohe. Sa dëshira, ëndë-

rime dhe gëzime janë të mpleksura me shumë prej tyre!

Ja, fustani i zi i mbrëmjes, që kam tre muaj pa e veshur! Stofa i kishte ardhur dikujt me pako, nga jashtë. E shiste shtrenjt. Nëna bëri si bëri dhe ma bleu, por pastaj mezi i nxori shpenzimet e muajit. Unë sa s'fluturoja nga gëzimi. Herë pas here e nxirrja nga komoja dhe e admiroja gjatë. Një mbrëmje, pasi ranë të flenë prindërit, e kyça derën e dhomës, leva buzët me të kuq, u dhashë formë flokëve, hodha stofin në trup dhe u vesh-trova gjatë në pasqyrë. Qysh atëhere vendosa ta qep pa mëngë dhe me dekolte të madhe, siç e kam sot. Por, ç'e do, ka mbetur në dollap i shkreti!

Sa i rreptë ishte babai! Asgjëkundi nuk mund të shkoja pa pëlqimin e tij dhe çdo mbrëmje du-hej të ndodhesha në shtëpi, para orës pesë në di-mër dhe para tetës në verë. Kur kishim ndonjë mbledhje ose aktivitet tjetër, që zgjaste tej orarit të caktuar, vinte ndonjëri nga familja dhe më priste tek porta e shkollës.

Kur arrita në maturë, bënë si bënë dhe më nxorën raport mjekësor që të mos shkoja në orët e fiskulturës, se pengohesha në mësim dhe s'më kishte hije të dilja sheshit me brekë të shkurtëra.

Megjithatë, ndodhte që më neveriteshin kufi-zimet, disa prej të cilave më dukeshin të tepërta, sidomos kur u bëra studente. Ua kisha zili shoqeve që ishin më të pavarura dhe më të lira se unë. Në thellësinë time ua kisha zili edhe atyre që bënë dashuri. Digjesha nga kureshtja për të fshehtat e saj, sido që vetë s'do veproja kurrë ashtu. Më ishin ngulur në mendje fjalët e tim eti se «vajza është si qelqi, po u thye, nuk ngjitet».

Eh, ajo kohë! Sa dëshira të ndrydhura, sa ëndrra që vyshkeshin pa lulëzuar! Dhe për të gjitha këto prisja shpërblim nga martesë. Na edhe martesë! Ç'humbën shoqet e mia që, sa ishin vajza, jetuan ndryshe? Asgjë! Madje shumë prej tyre janë më të lumtura, ose të paktën ashtu duken. Se, vetëm ato e dinë ç'kanë në zemër. Edhe unë e lumtur dukem nga jashtë...

Mos vallë kështu u ndodh të gjithave pas disa vjet martesë? Ndoshta kjo është jeta bashkëshortore dhe unë kërkoj më tepër nga ç'duhet prej saj. Apo mos jemi vonuar për fëmijë? Thonë se ata i lidhin më tepër bashkëshortët. Gjer tani sua kishim vaktin, se mezi u rregulluam, por tani është tamam koha.

... Eh, jetë, o jetë, sa e ngatërruar qënke! Njeriu i shkretë lakmon diçka që s'e ka dhe harron të gëzojë atë që ka. Kështu ikin ditët!..»

## 9.

Atë mbrëmje Ani shkoi të binte herët, se nuk ndjehej mirë. Në dhomën e zjarrit kishin mbetur motër e vëlla, njëri përballë tjetrit. Petrua lexonte, i shtrirë në divan, kurse Flora rrinte në tryezë, me dispensën e rezistencës së materialeve të çelur përpara.

Ajo shtirej sikur studjonte, por mendjen e kishte gjetkë. Ja, tani ishte rasti më i mirë për të çelur bisedën që kishte menduar prej kohe, po si? Disa herë ishte matur t'ja fillonte, por, me të parë fytyrën e të vëllait, stepej. Ajo fytyrë, aq e njohur dhe familjare, i dukej tani e ftohtë, e paafreshme.

Edhe Petrua, nga ana e tij, mendonte se ishte rast i volitshëm për të biseduar me të motrën rreth fjalëve që kishte dëgjuar, për sjelljen e saj. Dikur lëshoi librin mbi divan, ndezi një cigare dhe ja nisi tërthorazi:

— Motër, më dukesh e shqetësuar këto kohët e fundit!

— Si the, e shqetësuar? — pyeti ajo, duke ngritur sytë, e kënaqur që ai po ja çelte shtegun e bisedës.

— Po. Diç bluan përbrënda, diç ke!

— Ashtu është! — Ajo psherëtiu.

— Hë, si është puna?

— Për ne shqetësohem, vëlla!

Heshti një çast, e vështroi të vëllanë në sy dhe vazhdoi, disi e mallëngjyer:

— Petro, të kujtohet qysh vije atëhere e më merrje të shtunave në konvikti?

-- Kur punoja në Hydrocentral? Si s'më kujtohet!

E çuditi kjo pyetje, por vendosi të priste se ku do të dilte e motra.

— Po qysh e kalonim kohën bashkë, të kujtohet?

— Posi!

— Shëtisnim gjatë nëpër rrugët dhe parqet e Tiranës, bisedonim bashkë për gjithshka, shkëmbe-  
nim mendime, ti më qirasje me kasata që më pël-  
qenin aq shumë, shkonim në kinema dhe koha na  
fluturonte pa e kuptuar! — Flora e kishte tretur  
vështrimin diku larg. — Dhe sa keq më vinte kur  
ndaheshim!

— Mezi më lëshoje dhe porositë e tua s'ki-  
shin të mbaruar! — tha Petrua.



— Ti s'kujdëseshe hiç për vete! Ndoshta e hijje nga goja për të më blerë mua lloj-lloj dhuratash. Madje një herë më solle këpucë të reja pa veshur akoma të mëparshmet.

— Dëshiroja të mos kishe asgjë më pak nga shoqet me prindër, përkundrazi...

— Ta dije ti sa pak më hynin në sy dhuratat, në krahasim me shëndetin tënd! — Zëri i Florës dridhej nga mallëngjimi. — Sa mirë ishte atëhere, Petro!

— Pse, tani nuk është? — u çudit ai. — Të mungon gjë?

— Jo, vëlla, asgjë nuk më mungon; madje kam më tepër nga ç'më duhen, por...

— Por çfarë? — ai luajti nga vendi dhe e vështroi me kureshtje të motrën.

— Sikur kemi humbur diçka nga ajo lidhja jonë e dikurshme.

Petrua u mendua një copë herë, pastaj ngriti supet me çudi.

— Mua më duket se edhe tani kuptohemi për bukuri! — tha.

— Po, ne s'kemi bërë kurrë fjalë me njëri-tjetrin, po më mirë të grindeshim ndonjëherë, sesa ta kalonim në këtë qetësi kaq të mërzitshme, kaq të ftohtë!

— Ç'janë këto që thua, Flora?!

— Janë të vërteta, vëlla, të vërteta, megjithëse të hidhura. Prej kohe e kam vënë re këtë, por nuk ta kam thënë se nuk isha e bindur plotësisht. Mendova gjatë, pashë, dëgjova dhe më në fund u binda.

— Qysh kështu? — pyeti Petrua, që vazhdonte të ishte i habitur.

— Ja, kështu! — Flora heshti, u përqëndrua një copë herë në mendimet e saj, pastaj nisi të flasë qetë, por me dhëmbje: — Të kujtohet si bisedonim dikur bashkë, Petro, si i tregonim njëri-tjetrit për gjithshka, duke filluar nga çështjet më të rëndomta e gjer tek hallet e mëdha të punës dhe të jetës? Ti dije ç'nota kisha marrë gjatë javës, ç'ndodhte në konviktin tonë, ç'më kishte thënë mësuesi kujdestar, kurse unë dija ç'gjellë gatuheshin në mensën tuaj, si bëhej betonimi i digës, si e riparuat vinçin brenda një nate e kështu me radhë. Dhe për të gjitha i kërkonim mendimin njëri-tjetrit. Kurse tani...tani bisedojmë vetëm për drutë që duhen blerë, për xhaketën që duhet çuar në pastërti, për fejesën e filanit apo të filanes ose për ndonjë cikërrimë tjetër të tillë. Ti edhe kur më pyet mua si shkoj në mësimet ose Anin si shkon në ambulancë, e bën sa për të kaluar radhën. Kurse për punët e tua flet pak. Ndoshta të dukemi të paafta për të të ndihmuar ose këshilluar, megjithëse unë sot jam diçka më e pjekur nga ajo nxënësja e atëhershme. Të kujtohet si ëndërronim dikur për të ardhshmen? Tani kemi harruar të ëndërrojmë, thujse kemi arritur gjithë ç'mund të arrihet. Edhe kur rronte e shkreta nënë, takonte që mbrëmjeve rrinim gjatë pa folur, secili me mendimet dhe punët e tij, por gjithmonë na lidhte një fill i padukshëm, i cili e bënte të ngrohtë atë heshtje, kurse heshtja që sundon tani aq dëndur në shtëpinë tonë, ka diçka të ftohtë, larguese. Ne jo sikur jemi pjesëtarë të së njëjtës familje, po sikur ndodhemi rastësisht nën një çati, sa për të lehtësuar mirqënien e njëri-tjetrit. Jeta e secilit prej nesh jashtë mureve të apartamentit, ngelet rreptësisht persona-

le dhe sikur ndruhemi t'ja prekim shoku-shokut këtë të drejtë.

— Flora, ti ndoshta harron se koha ecën përpara! — tha Petrua, me një pamje të menduar. — Ne jemi rritur, jemi pjekur dhe e kemi fituar të drejtën për një farë pavarësie në jetë. Unë nuk shikoj ndonjë të keqe këtu për deri sa...

— Përderi sa në pamjen e jashtme gjithshka është në rregull, hə? — e ndërpreu Flora. — Por ajo që ti e quan pavarësi, vëlla, mua më duket ftohtësi, indiferentizëm. Dua të them indiferentizëm për botën e brendshme të tjetrit, se kur vjen puna që i ndryshohet orari Anit dhe ajo s'e pregatit dot drekën në orën e caktuar, nuk jemi aspak indiferentë, përkundrazi...

— Motër, ma thuaj troç, mos ke ndonjë pakënaqësi që flet kështu? — ndërhyri Petrua. — Mos je zënë gjë me Anin? Apo ke ndonjë hall tjetër?

— Jo, vëlla! — Ajo buzëqeshi hidhur. — Më vien keq që s'më paske kuptuar. Unë ndoshta s'kam plotësisht të drejtë, madje uroj të jetë kështu por, sidoqoftë, diçka nuk është në rregull.

— Gjepura! — tha Petrua, duke ndjekur me sy dredhat që bënte tymi i cigares.

I vinte inat që biseda kishte marrë një kthesë të tillë dhe po mendonte si ta nxirrte në shtegun që dëshironte. Sakaq, dëgjoi përsëri zërin e Florës:

— Petro, me që e filluam këtë bisedë, të të pyes diçka? Por, të lutem, mos më keqkupto!

— Fol! — ja priti ai, pa i shqitur sytë nga tavani.

— Të kujtohet, besoj, se unë e mora vesh fe-

jesën tuaj vetëm kur më lajmëruat për ceremoninë e rastit.

— Po.

— Ti asnjëherë s'më ke treguar si u fejuat. A e njihje mirë Anin, a e kishe dashuruar?

— Për të njohur, e njihja disi, po për të dashuruar... s'mund të them.

— Pse zgjodhe pikërisht Anin, atëhere?

— Dikë duhet të zgjidhja! — iu përgjigj ai, disi i çuditur nga pyetja e saj. — Ajo m'u duk e përshtatshme. Kisha dëgjuar fjalë të mira për karakterin, sjelljen dhe qëndrimin e saj, pastaj as e shëmtuar nuk ishte... S'mund ta kaloja gjithë jetën nëpër hotele dhe restaurante, në pritje të një dashurie të madhe.

— Kështu paska qënë, pra! Kishe nevojë për një çerdhe të ngrohtë. Mirë, po a je i lumtur me të?

— Lumturia është një fjalë e madhe, motër, por i pakënaqur nuk jam. Ani di t'i spikatë dëshirat e mia dhe vepron sipas tyre. Ajo është besnike, e sjellshme, nikoqire, cilësi këto që s'i gjen shpesh së bashku.

— Po mendimet, botëkuptimi i saj, Petro?

— Eh, s'ka të mirë pa të keqe!

Ai bëri një gjest që tregonte se nuk u jepte rëndësi këtyre.

— Pse, do të ishte më keq sikur t'i mungonte nikoqirllëku, hə? — ja bëri Flora, duke buzëqeshur hidhur. — Prandaj s'ja vë fort veshin, ose i bën udhë kur ajo thotë mendime që s'puqen gjëkund me kohën tonë? Këto qenkan një e keqe e pranueshme! Po mirë, ç'e ke Anin, shoqe jete, apo vetëm grua për shtëpi?

— E kam si e kam, të mirë apo të keqe, unë

e bëra ç'kisha për të bërë! — ja preu Petrua, i ngacmuar nga pyetjet e saj. — Le të bisedojmë më mirë për ty, që s'e ke bërë akoma. Madje, për këtë qëllim e nisa bisedën, por ti na e nxore gjetkë.

Flora heshti, duke u skuqur pakëz. E kuptoi se ku desh të dilte Petrua.

— Kam dëgjuar se shoqërohesh me një djalë, aq sa ke rënë në sy për keq! — filloi ai. — Desha të di, cili është dhe ç'të lidh me të?

Flora e vonoi përgjegjen, sa për të mposhtur turbullimin, pastaj tha:

— E kam shok. Bëjmë pjesë në të njëjtin grup mësimor. Arben e quainë. Më pëlqen shoqëria e tij.

— Thjesht shok fakulteti e ke? — pyeti Petrua, me një theks që linte të kuptohej dyshimi i tij.

Ajo e ndjeu veten ngushtë. Karshi nënës, ose një motre, do ta kishte pasur më lehtë, kurse nga vëllai i vinte zor. Megjithatë, vendosi të tregohej e sigurtë.

— Jo, s'e kam thjeshtë shok! — tha dhe ndjeu se gjaku i vërshoi në fytyrë. — Kam filluar ta dua! — I erdhi inat që ishte skuqur dhe ngriti menjëherë sytë.

— Ashtu?! — bëri sikur u çudit Petrua. — Po ai?

— Edhe ai.

— Nga e di këtë?

— Nuk ka ndonjë mjet për të matur ndjenjat e tjetrit, por kështu besoi.

— Po sikur të shtiret? Ke ndonjë fakt, ndonjë premtim, apo vetëm besimin e verbër të njeriut të dehur nga pasioni?

— Ti, vëlla, duhet ta dish se ka një mori rrethanash, një mori ndodhish të vogla, që e nxjerrin

në pah ndjenjën e vërtetë më mirë se fjalët dhe premtimet e mëdha.

— Megjithatë, ka edhe ndjenja të rrema, ka edhe vajza që gënjehen prej tyre. E ke menduar këtë, Flora?

— Jo. Ndjenja me dyshimin nuk rrijnë dot bashkë.

— Duhet ta mendosh, që të mos rrezikosh veten.

— Si «të mos rrezikoj»?! Mos vallë, duhet të pres që ju të më gjeni një burrë, me të cilin të takohem disa herë, për t'u bindur reciprokisht se pazarllëku është i leverdisshëm dhe pastaj të bëj një fejesë zyrtare në pasticerinë «Flora»?

— Nuk them këtë, por nuk bën të ekspozohesh kaq shumë, pa patur të paktën një premtim.

— Ndjenja, nuk është premtimi më i mirë? Apo mos është faj të dashurosh?

— Opinioni ynë publik...

— Nuk kam asnjë respekt për atë pjesë të opinionit publik që e quan më të arësyeshme kur martohen dy vetë, të cilët nuk e dashurojnë njëri-tjetrin sesa kur dy të tjerë dashurohen para se të martohen! — e ndërpreu Flora, gjithë duf.

— Paske vendosur të thyesh vargonjt e së vjetrës, hë? — ja bëri ai, me shpoti.

— Dikur ti thoshje se çdo njeri i vërtetë duhet të veprojë kështu! — tha ajo, duke buzëqeshur me keqardhje. — Por, si duket, e kishe fjalën për të tjerët, jo për familjen tënde!

— Unë për të mirën tënde e kam! — tha Petrua, i zemëruar. — Nuk dua të mbahesh në gojë për të keq as ti, as unë dhe as prindërit e gjorë.

— Nuk kam ndër mend të bëj ndonjë të keqe.

— Bukuri. Vëri gishtin kokës, pra! Shpresoj se nuk do më detyrosh të mbaj qëndrim tjetër...

Ajo nuk foli. Nuk deshi të acaroheshin më tepër për këtë çështje.

Petrua e quajti të përfunduar bisedën. Mori librin dhe vazhdoi leximin duke u munduar të tregohej i qetë.

Flora u ngrit dhe çeli kanatin e sipërm të dritares, se dhoma ishte mbytur me tym duhani, aqsa i digjnin sytë. Pastaj hoqi gjellën nga zjarri, pastroi sobën dhe shtroi tryezën për mëngjez. Matej t'i thoshte diçka të vëllait, por hezitonte.

— Petro, s'të bëri përshtypje diçka në bisedën tonë? — tha më në fund, duke fshirë duart me peshqir.

— Çfarë? — mërmëriti ai, pa i shqitur sytë nga libri.

— Mendimet tona nuk janë më të njëllojta, si dikur. Pse vallë? Cili prej nesh është larguar nga shtegu i drejtë?

— Koha do ta tregojë! — tha ai.

— Pse, në mëshirën e kohës do ta lemë?

Petrua nuk u përgjegj.

## 10.

Arbeni mori peshqirin, sapunin dhe doli të lahej.

Studentët sapo ishin kthyer nga puna vullnetare. Në korridorin e konviktit kishte një vajtjeardhje të pandërprerë. Dëgjoheshin krisje dyersh, hapa, thirrje, fragmente bisedash. Dikush këndonte me zë të lartë një melodi të njohur, një tjetër e

shoqëronte, duke rrahur pëllëmbat në ritmin e melodisë.

Tek lavamanët mbahej radhë. Arbeni priti sa priti, vështroi nja dy herë orën, pastaj e humbi durimin.

— Këtu e gjete të rruhesh! — iu shkreh atij që kishte përpara.

— Siurdhëron! — ja priti ai, me një ton ngacmonjës. — Pse, vetëm ti ngute të dalësh në qytet? Mos u mërzit, vogëlush, se në të dashtë, të pret, përndryshe s'ke ç'e do. Megjithatë, po ta lëshoj radhën. Fjala e urtë popullore duhet plotësuar kë-shtu «Të marrit, të dehurit dhe të dashuruarit, bëni udhë».

Të tjerët e pritën me të qeshura të bujshme shakanë, po Arbeni s'ua vuri veshin. Mbaroi punë shpejt dhe u kthye në dhomë.

Edhe atje dukeshin gjurmët e nxitimit. Mbi krevate qanë flakur rrobet e përditshme dhe nën ta. Këmishët e palara. Rrobet e reja dhe këmishët e pastra prisnin të krekosura mbi shpinoret e karrigeve. Mbi tryezë dergjeshin si në tablotë e natyrave të qeta, furçe dhëmbësh, sapune rroje, tubeta sapodonti, lëvozhga portokalli dhe fletore. Në cep të tavolinës, Ibrahim i po shkruante një letër.

— Si lum prindërit që të kanë! — e ngacmoi Arbeni. — Mezi u kujtove t'u shkruash dhe tani ngute, sikur të ndjek njeri pas.

— Vishu dhe qërou, se u vonove! — ja priti ai. Arbeni, duke lidhur nyjen e gravatës, u përkul mbi supin e Ibrahimit dhe u shtir sikur lexonte:

«Të dashur prindër, me shëndet jam mirë, por kam mbetur hollë nga xhepi»



— Hiqmu qafe, djall! — u nxeh Ibrahimimi.

Arbeni rrëmbeu pardesynë dhe doli. Sa zbriti në rrugë, vështroi orën. Kishte edhe njëzet minuta kohë, mjaft sa për të arritur në vendin e takimit. Eci ngadalë, duke shijuar me ëndje atë pasdite të bukur janari.

Rruga ishte plot me studentë që zbrisnin në qytet. Një grua po shtynte ngadalë karrocën e femiës. Foshnja luante duart dhe guiste. Më tej, një plakë po fshinte oragun e shtëpisë. Në liceun artistik dikush po bënte prova me trompë. Ajri qe i freskët dhe i tejdukshëm. Degët lakuriqe të dru-rëve ndereshin të palëvizura drej qiellit. Drita e butë e perëndimit përkëdhelte gjithshka. Dukej sikur gjithësia përcillte buzagas diellin.

Arbeni ndjente një ngazëllim të brendshëm. Mori frymë thellë, por nuk u ngop. Me të dalë tek bulevardi i madh, vështroi drejt vendit të caktuar për takim. Njohu siluetën e Florës dhe nxitoi drejt saj.

— Paske ardhur para kohe! i tha duke i shtrënguar fort dorën.

— Nuk më pritej. Arben! — iu përgjigj ajo duke buzëqeshur ëmbël.

Sytë i kishte plot dritë. Nuk e tërhoqi dorën. I pëlqente ngrohtësia e pëllëmbës së tij.

— Ç'po vështroje me aq kureshtje, reklamat e shfaqies? — pyeti ai.

— Po. Ne akoma s'e kemi parë.

— Prej kohe kemi vendosur, po kur?

— Nesër, po deshe.

— Vërtet? T'i marr biletat?

— I marr unë kësaj radhe.

— Ty të duhen paret për cigare, Arben.

Duke biseduar, po i ngjiteshin të përpjetës së

narkut të madh. Arbeni i shtrëngonte lehtë dorën. Dhe nëpërmjet të asaj prekjeje, ndjenin t'u kalonte ngrohtësia dhe dridhja e ndjenjës së tyre.

— Sot ke punuar shumë! — tha Arbeni. — A u lodhe?

— Jo fort. Bëra një dush dhe tani ndjehem për bukuri.

— Me ujë të ftohtë?

— Po.

— Brr, kësaj i thonë kalitje! — qeshi ai. — Të vura re gjatë punës. U a kaloje të gjithave. E fortë je!

Flora ngriti supet, duke buzëqeshur.

— Megjithatë, kam një vërejtje! — vazhdoi ai.

— Cfarë?

— Nuk më pëlqeu përgjigjja që dhe sot në seminar. Nuk ishte në lartësinë e duhur.

— Ke të drejtë. Por, dje pasdite, kumatës iu shkrep të pastronte shtëpinë. Të mos e ndihmoja? Mbaruam në mesnatë. S'munda të përgatitesha më mirë. Më zinte gjumi mbi dispensë.

— E di se ç'tha Hajria pas seminarit?

— Ç'tha?

— «Ka filluar të bierë nga forma, se nuk i del koha, të shkretës!» E kupton se ku qëllonte!

— Sa e ligë! — u zemërua Flora. — Në të vërtetë, ndodh e kundërta. Unë tani mësoj më shumë. Qe vetëm një përjashtim.

Ata e lanë rrugën kryesore dhe hynë në shtigjet dredharake të parkut. Dielli kishte perënduar dhe gjithshka po kridhej në një dritë të mjegullt, kaltëroshe. Konturet e godinave, të druve dhe të shtigjeve, dalëngadalë po e humbisnin kjartësinë. Sipërfaqja e liqenit kishte marrë një shkëlqim të

mekët, të plumbtë. Dukej si një copë e përmbysur e qiellit.

— Sa më pëlqen kjo mbrëmje! — tha Flora dhe mbështeti kokën në gjoksin e Arbenit.

Ai e shtrëngoi fort nga supet dhe e puthi vjedhurazi.

— Kur jemi bashkë gjithshka na duket e bukur! — tha pastaj.

Nga liqeni erdhi një puih e lagësht. Përtej u ndez një dritë që u dyfishua në sipërfaqen e ujit. Dikush thirri me zë të lartë. Vikama jehoi thellë në qetësinë e mbrëmjes. Pas pak iu përgjegj një vikamë tjetër, më e largët. Pastaj plakosi rishtazi qetësia, e trazuar paksa prej pipëtimave të natës. Dridheshin lehtë degëzat e drurëve dhe ato pak gjethe të mbetura në to. Trokisinin qartë hapat e çiftit në asfaltin e shtegut. Yjet ndizeshin një e nga një, në qiell dhe në faqen e lëmuar të liqenit.

Florës i dukej sikur vikamat, pipëtimat dhe hapat jehonin thellë në brendinë e saj.

Arbenit i dukej sikur qënia e tij që grimcuar dhe tretur në atë gjithësi të mrekullueshme, në gjethe, në drurët, në dritat dhe në tokën kundërmonjëse.

Arritën të heshtur tek bisedka që e quanin «shtëpia jonë». U ulën në stolin e njohur dhe vështruan me mall njëri-tjetrin.

— Oh, Arben! — pëshpëriti ajo dhe i mbështeti kokën në sup.

— Flora ime! — pëshpëriti ai dhe i përkëdheli flokët.

U përqaftuan fort, si të deshnin të shkriheshin në një të vetme.

— Përmbi kreshtat e kodrinave po dilte hëna e madhe, e kuqërremtë. Nga rrëza e gjithshkaje që

ngrihej mbi tokë u zgjatën hije të zbehta plot fshehtësi. Një mjegull e hollë, e ndritshme, kaltëroshe po nderej mbi faqen e dheut.

Pas në copë here e lanë me keqardhje «shtëpinë» dhe shkuan drejt lokalit të parkut që llamburinte nga dritat e neonit.

Përtej xhamave të mëdha dukeshin tryezat boshe, ndonjë çift aty këtu dhe banakieri, që gogësinte nga mërzia.

— Shkojmë e pijmë diçka? — propozoi Arbeni.

— Shkojmë. Marrim një shishe birra, sa për të shuar etjen!

— Marrim dy.

— Ç'i do. Bën ftohtë tani dhe nuk shkojnë.

— Mës më kurse, kam lekë.

— Mirë pra, si të duash!

Zunë tavolinën e qoshes, ku kishin qëndruar edhe herë të tjera. Arbeni iu afrua banakut, porosi, pastaj zhveshi pardsynë.

— Sonte nuk bëka ftohët! — tha.

— Mbrëmja është aq e vakët, sa duket pranverore! — tha Flora.

Banakieri solli të dy shishet dhe i çeli, duke e vështuar Florën me kureshtje.

— Të kujtohet ku më ke parë? — e pyeti pastaj.

Ajo e vështroi me vëmendje dhe ngriti supet.

— Më dukeni i njohur, po se nga!?

— Të pëlqejnë ende kasatat?

— Aaa! Jeni akulloreshitësi, ku blinim gjithmonë kasata!

— Dora vetë. E shikon, të mbaj mend, megjithëse atëhere mbaje bishtaleca dhe ishe ende një çupë e vogël. Sa qenke rritur! Ishe klientja

më e rregullt, sidomos të shtunave dhe të dielave nuk mungojë kurrë. Shpesh të shoqëronte një djalosh që të ngjiste.

— Vëllai! — tha Flora. — Sa herë vinte në Tiranë, më gostiste me kasata. Ju i pregatisnit aq mirë!

— Po tani, ku është ai? — pyeti banakieri.

— Këtu. Bashkë jemi.

— Bëni të fala. S'është dukur ndonjëherë këtej. Do ta kisha njohur. Kam kujtesë të fortë unë!

— Epo është i martuar tani! — bëri shaka Arbeni.

— Ç'ka të bëjë! Edhe për të martuarit është bukur këtu.

— Tani në dimër?! Kur ke apartamentin e ngrohtë, pse...

— Eh, more djalë, ku ka më bukur se të përtërish kujtimet e vjetëra! — psherëtiu banakieri dhe u largua duke vështruar përreth, i gatshëm për t'u plotësuar çdo kërkesë klientave të paktë.

— Sa mirë tha! — vërejti Flora. — Ne do të vijmë gjithmonë këtu, edhe në dimër, apo jo, Arben?

— Edhe për tre vjet, pastaj në klubin e kantierit!

— Qoftë edhe atje! — tha Flora. — Unë kam hyrë shpesh në klubin e kantierit tonë. Nuk jam ndrojtur. Njerëzit atje vinin shpesh me pambukore dhe çizme të spërkatura me llaç. Nuk kërkonin gota për birrën, por e pinin me shishe. Disa e përdornin me vështirësi pirunin e thikën. Qeshnin dhe bënin shaka me zë të lartë. E njihnin njëri-tjetrin. Dukej si të qe një familje e madhe, me

vëllezër dhe motra të panumërta. Ti e di, Arben, sa bukur që është!

— Po, e mënçura ime. E bukura ndodhet kudo në jetën tonë, veç të dish ta gjesh.

— Ah, sikur të jemi të dy në një kantier!

— tha ajo, duke përplasur gëzueshëm pëllëmbët.

— Ta merr mendja që bashkë do jemi!

— Në mëngjez do vemi në punë! — vazhdoi Flora. — Dhe kur të na shohin, njerëzit do thonë...

— ... Ja të dy bashkëshortët inxhinierë! — e plotësoi Arbeni, duke buzëqeshur.

— Nuk desha të them këtë! — u zemrua ajo.

— Mirë, mirë, vazhdo!

— Tek hyrja e kantierit do ndahemi, duke i uruar njëri-tjetrit punë të mbarë.

— Dhe pastaj do ngjitemi në skela. Je ngjitur ndonjëherë, Flora?

— Edhe pyet? Qindra herë! Mbjaj mend se herën e parë m'u morën mendtë aq shumë, sa do isha rrëzuar, po të mos më kishte mbajtur një mjeshtër i vjetër. Ai më këshilloi të stërvitesha dalëngadalë. Fillova qysh atë pasdite, kur ikën punëtorët, se më vinte turp. Pas ca kohe ngjitesha me aq shkathësi, sa çuditeshin të gjithë. Madje më quajtën «dhija e egër».

— Oj, sa mirë ta paskan vënë! — qeshi Arbeni. — Të përshtatet.

— Se mos e përhapësh! Këtu nuk ma dinë, kurse ata të kantierit kështu më thërresin akoma sot. Po ty, të pëlqen kur ndodhesh majë ndonjë skele?

Ai mbylli sytë përgjysëm, e përfytyroi veten atje dhe tha:

— Që andej njerëzit duken të vegjël, kurse

makinat, si lodra fëmijësh. Rrugët e ndajnë qytetin në thela vigane. Çatitë dhe terracat, të shtrira në plane të ndryshëm, të nxitin të ëndërrosh për jetën që gëlon nënë to. Ke aq horizont, aq hapësirë para vështrimit! E ndjen veten më të fortë, më të guximshëm. Provon një ndjenjë krenarie, kur mendon se puna e njeriut, e shokëve të tu dhe tëëndja, ka krijuar një lartësi të tillë.

— Oh, Arben, ne ndjejmë njësoj! — tha ajo, e ngazëllyer. — Por ti shprehesh më bukur.

— Për shëndetin tënd! — uroi ai, duke ngritur gotën.

— Për shëndetin tonë!

Tingëllitën gotat. Në banak shfryu aparati i ekspresit. Nga skaji i sallës u dëgjua e qeshura e shkujdesur e një vajze. Banakieri, me tabaka në dorë, shkoi të çonte porosinë diku. Arbeni e ndoqi me sy.

— Paska ardhur Hajria me të fejuarin! — tha pastaj.

Flora ktheu kokën andej. Hajria po përziente me durim limonadën. E kishte kapur bishtin e lugëzës me dy gishta, kurse të tjerët i mbante lart, të çelur në trajtën e një flatre shpendi. Pastaj e çoi gotën në buzë, e rrufisi pak, fare pak dhe e vuri mënjanë me një gjest gjoja indiferent, por të studjuar. I pëshpëriti diçka të fejuarit dhe sakaq ai porositi një tortë.

— Si shtiret! — tha Arbeni. — Thua se nuk është ajo Hajria që njohim ne! S'i paska vlejtur mjaft dushi që hëngri në mbledhjen e rinisë.

— Ashtu duhet të sillet një e fejuar delikate! — bëri shaka Flora.

— Ta merr mendja, mos do bëjë si ti që ha

si ulkonjë dhe pi birrë, duke e mbajtur gotën në mënyrë kaq banale!

Nga skaji i sallës u dëgjua përsëri e qeshura e shkujdesur e vajzës së panjohur.

— ... Apo mos do qeshi pa turp, si ajo!

Ndërkaq Hajria po hante tortë, duke shkëputur prej saj pjesë të vockëla, që i çonte në gojë me një ngadalësi të çuditshme. Herë pas here ndryshonte buzëqeshjen dhe pozën, ashtu siç ndryshohen reklamat me drita ose titujt e një filmi.

— Vë bast me sa të duash se edhe në pastë uri, tortën s'do ta hajë gjer në fund! — tha Arbeni.

— Në dashtë le ta hajë! — tha Flora. — E di ç'më tha dje? «Oi dhe ti, sa i beson Arbenit! Djemve nuk u duhet besuar, pa vënë këtë!» Dhe më tregoi unazën.

— Po ti, ç'i the?

— Arbeni, i thashë, nuk është nga ata që lidhen vetëm me anën e një verige të atillë, aq të hollë.

— Ha-ha-ha! — qeshi ai me të madhe. — Ç'ja paske punuar!

— Merre këtë! — tha Flora, duke i vënë në pjatë copën e mishit që i kishte mbetur. — Mua nuk më hahet!

— Po ti nuk hëngre fare! — vërejti Arbeni.

— Boll e pata. Duhet të lë pakëz vend edhe për darkën që më pret në shtëpi.

— Ç'bëhen njerëzit e tu? — pyeti ai.

— Me shëndet mirë janë. Por... diçka ndodh me tim vëlla, Arben. Ai ka ndryshuar dhe po ndryshon dita ditës. Sigurisht, jo për mirë, prandaj shqetësohem. Dje patëm rast të bisedonim. Ja



thashë troç mendimin tim. Erdhi fjala edhe për miqësinë tonë.

— Ç'tha?

— Ai nuk e shikon me sy të mirë këtë miqësi. Jo sepse ka gjë kundër teje, madje s'të njef fare, por sepse u ndruhet thashethemeve.

— Ti dikur ma ke përshkruar me ngjyra të tjera vëllanë! — tha Arbeni.

— Po. Të atillë e dija. E ke parasysh si ndryshojnë dritat në një skenë teatri, si e zevendësojnë gradualisht njëra-tjetrën? Ja, diçka e tillë po ndodh edhe me botëkuptimin e tim vëllai. Cilat janë arësyet? Sedra e tepërt? Petrua ka qenë gjithmonë njeri me sedër. Ndoshta, në fillim kjo e ndihmoi të shkonte përpara, kurse tani... tani po e dëmton. Kam vënë re se ai mundohet me çdo kusht të ruaj «emrin e mirë», qoftë edhe duke sakrifikuar parimet e shëndosha. Më mirë të mar-tohem unë me mblesëri, sesa të rrezikohet ky «emër i mirë» nga thashethemet. Nga ato pak gjëra që thotë në familje rreth punës, dyshoj se edhe atje njëlloj vepron. S'mund të jetë ndryshe. Njeriu s'mund të jetë tjetër në familje dhe tjetër në shoqëri. Në fillim kujtoja se mos ftohtësia dhe indiferentizmi që tregon në familje, shkaktoheshin nga martesja jo e goditur, por pastaj u binda se kjo martesë nuk ishte një gabim i rastit, por pasojë e kërkesave të tij të gabuara ndaj gruas dhe familjes.

— Këto janë gjëra që ndodhin në jetë! — tha Arbeni. — Kur fillon e rrëshqet nga rruga e drejtë, nuk gjëmojnë as topat, nuk bien as trompetat. Kjo vjen dalëngadalë, pa e kuptuar as vetë i zoti. Një lëshim sot, një tjetër nesër. I pari më i vogël, i dyti më i madh. Kështu vjen një ditë që gjendesh

në anën tjetër. Sigurisht, kjo ka arësyet e saj. Nuk e di cilat janë në rastin e vëllait tënd, ato që the, apo të tjera, por ty të përket t'i zbulosh dhe ta ndihmosh pa qenë vonë.

— Ashtu është, por ç'mund të bëj unë, që jam dhjetë vjet më e re se ai? Ka të ngjarë të mos ma vari!

— Ç'nuk mund të bëjë shoqja për shokun, ç'nuk mund të bëjë motra për vëllanë, Flora. Të kujtohet legjenda e Mujit dhe Halilit?

Ajo uli kokën dhe ra në mendime,

— Tani duhet të çohemi, se u bë vonë! — tha Arbeni, pas pak.

— Sa është ora?

— Tetë e gjysmë!

— Vërtet!? Unë kujtoja se nuk është më shumë nga shtatë. Si na fluturoi koha!

— Si gjithmonë! — buzëqeshi ai.

— E di ç'më pyeti dje një shoqe? — tha ajo, duke buzëqeshur. — «Si nuk mërziteni ju të dy, duke qëndruar kaq shumë bashkë?»

Pas pak ata zbrisnin në shtegun që dredhonte mes plepave. Dëgjonin si thërmoheshin gjethet e thata nën hapat e tyre. Nuhatin me ëndje kundërmimet e freskëta të natës. Ndjenin frymëmarrjen e njohur të njëri-tjetrit. Vështronin panoramën e ndriçuar të qytetit që shtrihej përballë. I pushtoi një shqetësim i këndshëm, ngazëllenjës.

— Shiko, sa bukur duket Tirana jonë! — tha Flora, duke shëtitur dorën si me përkëdheli gjatë brezit të dritave. — Sa shumë dritare! Mbas secilës prej tyre ka njerëz, ka jetë, mendime, dashuri, shqetësime, gëzim. E bukur, e madhe është jeta, Arben!

Ai e shtrëngoi më tepër pranë vetes dhe iu duk sikur ndjeu qysh rridhte jeta në trupin e saj.

Sytë e tyre ishin plot dritë. Rretheqark kryqëzoheshin hijet e natës. Përballë tyre vezullonin mijëra drita.

11

Sapo kishte mbaruar mbledhja e këshillit teknik. Zyra e kryeinxhinierit që mbushur me tym duhani, aq sa ajri dukej kaltërosh, kurse ngjyrat dhe trajtat e objekteve e kishin humbur kjartësinë.

— Na u zu fryma këtu! — tha Petrua, duke çelur dritaren.

Tymi i duhanit vërshoi me rrëmbim jashtë, duke formuar vorbuj të shumëtrajtshëm.

Inxhinier Andrea qëndronte pranë tryezës dhe vizatonte arabeska mbi një copë letër.

— Si duket, nuk i ke zbratur të gjitha! — tha Petrua, duke parë se shoku s'po tundej nga vendi.

— Po, kam edhe diçka për të të thënë si komunist, si shok! — ja priti Andrea.

— Davanë e fituat, ç'do më?

— Ne s'bëmë gjyq, prandaj fjala «dava» s'hyn këtu! — Andrea e mblodhi shuk letrën e shkarritur dhe e flaku në qoshen ku ndodhej shporta. — Këshilli teknik vendosi për të mirën e prodhimit, jo për të njëjës palë ose të tjetrës. Megjithëse, ti nuk e prisje një vendim të tillë.

«Vërtet, nuk e prisja! — mendoi Petrua. — Më kthyen kurrizin të gjithë. Pse kështu?»

— Nuk e prisje, sepse ishe mësuar të të shkonte fjala! — vazhdoi Andrea. — Kjo ndodhte jo

për autoritetin tënd, jo për meritat e tua, siç ndoshta kujtoje, por sa kohë që mendimet dhe propozimet e tua ishin të drejta, në dobi të punës. Sapo bëre të kundërtën, sapo iu kundërvure interesit të përgjithshëm, njerëzit nuk të përkrahën, përkundrazi, të dënuan. Pse mbajte një qëndrim të tillë, Petro?

— Sepse i tillë ishte mendimi im!

— S'është e vërtetë! — tha Andrea, sikur i lutej tjetrit që të tregohej i sinqertë. — Ti je kuadër me eksperiencë, specialist i mirë, Petro. Nuk është e mundur të mos e kuptosh nevojën e riorganizimit të repartit. Por, të erdhi thartë pse e propozuan të tjerë këtë riorganizim, pse të shpëtoi inisiativa nga dora. Pastaj, iu trëmbe vështrësive të...

— Nuk di t'u jem trembur ndonjëherë vështrësive! — e ndërpreu Petrua, me zemërim. — Ti duhet ta dish sa kam punuar, sa vështirësi kam përballuar, gjersa uzina arriti ku është sot.

— E di fort mirë! — tha Andrea. — Veç, kjo ndodhte dikur, jo tani. Për këtë desha të bisedojmë, prandaj qëndrova. S'ta kam thënë asnjëherë në sy, por dije se gjithmonë të kam dashur dhe të kam çmuar. Ti ke bërë shumë për punën dhe për njerëzit. Prandaj më ther në zemër, kur vërej se po të zbehen cilësitë e mira. Petro, ke ndryshuar, ka filluar të të pëlqejë qetësia, lavdia, rehatllëku. Ti pa dashur po e dëmton interesin e përgjithshëm. Synon ta realizosh planin sa më lehtë, jo me prodhimet më të nevojshme, por me ato më të leverdishmet. U gëzove kur, në saje të vendimit të arbitrazhit, ja shkarkove porositësit përgjegjësine për moszbatimin e porosisë dhe nuk mendove se nga

kjo u dëmtuan blerësit, populli. Që kur u sëmur drejtori dhe ti e zëver.dëson, të ka hyrë më shumë vetja në qejf. Ke filluar të sillesh së larti me njerëzit. Nuk i përfill mendimet e tyre. Po ta kishe dëgjuar Kastriotin, porosia e tregëtisë do që përfunduar me kohë. Të pëlqen kur të lavdërojnë. E propozove Selimin për brigadier, sepse të lan e të lyen dhe nuk e sheh dot me sy Kriston, sepse nuk të thotë «amin» për çdo gjë. Ja tashti edhe çështja e riorganizimit. Ti, si komunist nuk duhet të ecësh në një rrugë të tillë. Këto janë krejtësisht të huaja për figurën e komunistit të vërtetë, Petro!

Andrea i nënvizonte fjalët duke i rënë lehtë tryezës me gishtin tregues. Rudhat e dëndura të ballit i çenë thelluar më tepër, kurse sytë e vegjël e të hirtë i kishin marrë një shkëlqim të veçantë. Në timbrin e zërit dhe shprehjen e fytyrës i gërshetoheshin ashpërsia me dashuri, zemërimi me keqardhjen.

Petrua uli vështrimin mbi xhamin e tryezës, nderi dorën drejtë paqetës së cigareve dhe ndezi një, me nervozizëm.

— Për të parën herë dëgjoj të tilla fjalë! — tha, duke u munduar ta fshihte shqetësimin.

— Sepse nuk ke ditur, ose nuk ke dashur të dëgjosh ndryshe. Pse ua vije veshin pallavrave të Selimit dhe acaroheshe nga qëndrimi i drejtë i Kastriotit, pse i merrje me të qeshur romuzet e xha Vasilit dhe seriozisht servilizmat e ndonjë tjetri, pse nuk të bënte përshtypje mosaprovimi i hapur i shumë prej veprimeve të tua nga punëtorët më të përparuar, nga ata që dikur i mbaje për krenarinë e uzinës? Sepse ke filluar të largohesh prej tyre, Petro, sepse ke filluar të çelësh një

hendek ndërmjet vetes dhe tyre. Vetën e kujton diku lart, kurse ata, poshtë, nën urdhërat e tua të pagabueshme.

Petrua u ngrit dhe filloi të endej me hapa të rënda nëpër zyrë. Vërviti bishtin e cigares, pastaj mbylli sytë për një çast. I buçisnin veshët. Kokën e kishte të rëndë dhe gojën të hidhur. Mërdhinte.

— A i ke menduar mirë këto që thua, Andrea?

— pyeti, duke shtrënguar tëmthät me pëllëmba.

— Mos vallë, rrëmbimi të shtyn të thuash gjëra të paqena?

— Kjo është e vërteta, sado e hidhur qoftë!

— iu përgjigj Andrea, duke tundur kokën, në shenjë sigurie. — Jam fajtor që s'ta kam thënë troç qysh më parë, por kujtoja se ti do ta kuptosh edhe ndryshe.

Petrua vazhdonte të shëtiste ecë e jak. Po e pushtonte një plogështi e çuditshme. Tani edhe duart i ndjente të rënda, edhe këmbët po i mpiheshin. I dukej sikur fjalët e Andreas vinin që larg. Përnjëherësh zyra iu bë e neveritshme dhe Andrea i bezdisshëm, si një mizë që të zukaft ndër veshë, kur do të flesh. Ndjeu dëshirë t'u shpëtonte këtyre ngacmimeve.

— Mirë, të faleminderit! — tha duke marrë pardesynë nga varësja. — Herë tjetër mund të bisedojmë më gjatë. Tani jam shumë i lodhur. Na zuri nata këtu. Më pret gruaja për të shkuar diku.

Andrea u ngrit dhe qëndroi përballë shokut. Ai ishte një pëllëmbë më i gjatë se Petrua dhe iu desh të ulte sytë për ta vështruar në fytyrë. I pa ballin e zbehtë, sytë e skuqur e të zvogëluar, rrudhät e thelluara ndanë buzëve, shqetësimin

që ai më kot mundohej ta fshihte dhe ndjeu një shtrëngim përbrënda.

«Ta dish sa ta dua të mirën!» — mendoi me keqardhje, kur ndeshi vështrimin e ftohtë të shokut.

I shtrëngoi fort dorën, rrëmbeu çantën dhe doli.

Petrua mbylli zyrën, zbriti me nxitim shkallët dhe iu duk sikur shpëtoi nga zagushia, sapo doli në ajrin e freskët të mbrëmjes. Eci në këmbë drejtë qendrës së qytetit. Ju kujtua se Ani e kishte porositur të mos kthehej para tetës, sepse do të lante rrobat dhe do të pastronte shtëpinë. Nisi të endej pa qëllim nëpër rrugët e qytetit. Hyri nëpër librari e dyqane, u ndalua para reklamave të shfaqjeve, vështrroi vitrinat dhe mundohej t'u shpëronte mendimeve.

«... Si tha Andrea, ka filluar të më pëlqejë qetësia, rehatllëku? Mos u dashka të cfilitem së punuari si dikur, edhe tani që jemi gjashtë inxhinierë! Kur qe nevoja, e kam bërë natën ditë. Sa herë montohej ndonjë makinëri e re, gdhiesha në uzinë. Kam mbartur pjesët dhe kam shtrënguar dadot në një radhë me punëtorët. Kur kthehesha nga puna, s'gjeja as tryezë të shtruar, as dhomë të pastër e të ngrohtë, si Andrea tani. Vite me radhë nuk dita ç'është prehja. Kurse këta të rinjtë, i gjetën të gjitha gati. Le të dërsijnë një herë sa unë, pastaj të flasin!... Por, ç'e lodh akoma kokën. Mjaft më! Le të tjerat, po s'do të më lirojë edhe kjo dhimbja e kokës! Të shkoj të pi një kafe...»

Vendosi të kthehej në Vollga».

Ishte ora kur arrijnë autobuzat interurbanë dhe para agjensisë kishte gjallëri. Njerëzit përqafoheshin, përshëndeteshin, pyesnin për autobuzin

pasardhës, nxitonin për hotel, largoheshin me valixhe në duar.

I tërhoqi vëmendjen një djalosh me pamje të hutuar dhe me një valixhe dërrase në dorë. Ju kujtua vetja, kur u largua së pari nga qyteti i lindjes.

... Mëngjez shtatori. Kishte rënë shi gjithë natën dhe rrugica e tyre, me kalldrëm të prishur, që mbushur gjithë pellgje. Te kthesa ai kishte vështruar edhe një herë çatinë e vjetër të shtëpisë. I dukej sikur po linte atje një pjesë të vetes. Tek stacioni nëna e kishte mbajtur gjer minutën e fundit, duke i dhënë porosi të panumërta. Flora i shtrëngonte dorën dhe e vështronte me sy të mëdhenj. Shoferi ndezi motorin. Përqafime, porositë e fundit, një lot në sytë e nënës, xhami i dirsur i autobuzit, që ai u ngut ta fshinte, nëna dhe motra që ja bënin me dorë, pastaj drurët e rrugës që parakalonin me shpejtësi para xhamit. Mallëngjimi i ndarjes, shqetësimi i këndshëm i jetës së re që e priste, orët e gjata të udhëtimit dhe ja, stacioni i Tiranës. Po ky stacion, që tani i duket kaq i njohur dhe i rëndomtë...

Djaloshi me valixhe humbi në kthesë. Petrua hyri në kafene dhe porositi një ekspres. Priti në këmbë, pranë banakut. Vegimi i së kaluarës e bëri ta ndjente më thellë keqardhjen për ngatërresat që po i ndodhnin.

«...I qënkam kundërvënë interesit të përgjithshëm! Unë për të mirën e uzinës e kisha. Tremujorin e ardhëshëm ndryshonte puna, kishim gjithë vitin përpara. Pse ta rrezikonim planin vjetor? Punojnë njerëzit, pra le të dalë në pah merita e tyre. E tyrja dhe tona, që i drejtojmë.



Tona... timja, ndoshta. Vërtetë, për kë mendova më tepër, për veten, apo për ata?

E nxori nga mendimet shfryrja e aparatit të ekspresit. Vuri re kamarieren që mundohej t'u bënte ballë porosive të shumta, duke nxituar përmes tavolinave. Në disa prej tyre klientët qenë rrasur pranë e pranë, në trajtë rrethi. Mbi kokat e tyre ngriheshin parreshtur shtëllunga tymi dhe murmuritje që, nëpërmjet dritares së çelur, shkonin e treteshin në hapësirë.

Pagoi dhe iku, më i shqetësuar nga ç'erdhi. Megjithëse jashtë breronte një shi i imët dhe kallimtarët nxitonin hapin ose çelnin çadrat, ai nuk nxitoi. I pëlqeu therrja e ftohtë e piklave. Me cigaren të varur në buzë dhe me duart të rrasura në xhepat e pardesysë, ecte në asfaltin e lagur, vështronte reflekset e dritës në të, dëgjonte hapat e tij të ngjeshura, zvarriste pas hijen dhe mendimet.

«... Çudi, si janë njerëzit, pak t'ua prishësh dhe të gjykojnë ndryshe. Për Andrean isha i mirë, kur e propozova për dekorim, për Florën isha i mirë kur i çoja dhurata dhe e mbaja me përkëdheli, kurse tani... paskam ndryshuar! Si ndryshoka kështu, menjëherë, njeriu!... Megjithatë, pse kjo rastësi: të dy në një kohë, pak a shumë të njëjtat mendime...»

E verbuan dritat e një makine. Për një çast nuk diti nga t'ja mbante, pastaj hipi në trotuar. Ja bëri me dorë, sikur trembte ndonjë mizë. Dëshi të trembte mendimet, por ato nuk i shqiteshin.

«... Sa ngushtë u ndjeva në mbledhjen e këshillit teknik! Ata më gozhduan me argumenta. Nuk e dija që kishin kaq argumenta. Pse nuk

e dija? Dikur e kisha gjëndjen e reparteve në pëllëmbë të dorës, kurse tani... Të jetë e vërtetë se jam larguar nga puna e gjallë? Eh, s'është kjo e gjitha. Uzina është rritur kaq shumë, problemet janë shtuar kaq shumë, sa s'ka mundësi që një kokë e vetme... Atëhere, pse ngula këmbë në timen? Sedra?.. Hej, drej, ç'po mendoj kështu? S'po më liron as kjo dhimbja e kokës. Do shkoj të dëgjoj muzikë dhe nuk do mendoj për asgjë. Mjaft!

Arriti tek pallati dhe ngjiti shkallët me përtësë. Kur çeli derën e apartamentit, e goditi një kundërmim sapuni dhe plaçkash të lagura. Ndërsa po zhvishte pardesynë, dëgjoji zërin e Anit që po grindej me dikë në guzhinë.

— Vetë pranove! — thoshte ajo. — Aq sa ramë në ujdi po të jap. Pse ankoresh?

— Ti më dhe dyfishin e rrobeve që më tregove në fillim! — tha ajo tjetra. — Vështro sa ishin!

— S'di unë, hakun ta dhashë.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti Petrua, duke hyrë në guzhinë.

— O, mirëseardhe! — e përshëndeti Ani, me zë tjetër. — Ej, punë grash. Më ndihmoi të laj ca rrobe.

— E dëgjova bisedën! — tha Petrua, duke vështruar kanistrat me rrobe të lara. — Sa i dhe?

— Dhjetë.

Petrua futi dorën në xhepin e pasëm të pantallonave dhe i zgjati gruas një kartmonedhë të palosur.

— Merri! — nguli këmbë, sepse ajo nguronte. — Të takojnë.

Gruaja doli, duke falënderuar. Ani, gjithë inat, mbylli derën pas saj.

— Ke hak ti, se s'ke larë ndonjëherë aq rrobel  
— ju shkreh Petrua.

Ani nuk foli. E vuri re që ai s'ishte në orë të mira. Çoi në banjë kanistrat me rrobe dhe nisi të rregullojë dhomën.

— Kam një lajm të keq! — tha, duke fshirë mushamanë e tryezës.

— Hë, ç'tjetër? — mërmëriti ai.

— Më kanë caktuar në një ekip shëndetësor, që do shëtisë nëpër fshatërat e Tiranës. Një muaj. Ato që kanë fëmijë nuk i caktuan.

— Mirë, e pastaj?

— Si «mirë»! Kush do kujdeset për shtëpinë, për ty?

— Do bëjmë si do bëjmë një muaj.

— Po për mua, nuk mendon? E lehtë të duket?

— Si gjithë shoqet.

— Të thashë, ato që kanë fëmijë të vegjël, nuk i caktuan. Unë dhe nja dy të tjera e pësuam. Por, s'kam ç'bëj, do vete.

— Të vesh, posi! — tha ai, duke menduar gjetkë.

— Ta shtroj darkën? — pyeti ajo, si mbaroi pastrimin.

— S'do ta presim Florën?

— Më lajmëroi me telefon se do qëndrojë për darkë tek një shoqe.

— Tek cila?

— S'më tha. As unë nuk e pyeta.

— Shtrona, atëhere!

— Sigurisht do të ketë shkuar gjëkund me atë! — mërmëriti ajo, sikur fliste me vete.

— S'ta kërkoi njeri mendimin! — ja preu ai.

Ajo nuk u përmbajt dot.

— E di që nuk të pëlqen mendja ime! — shfryu duke zbratur supën. — Por, të paktën, thujë të mos vijë ta kërkojë mu këtu, se s'dua të më dalin fjalë. Bota nuk e di se për kë vjen. S'ja kam për borxh, more vesh?

— Pse, erdhi këtu ai? — pyeti Petrua, i ngrysur.

— Po.

— Kur?

— Sot pasdite.

— Qënka e nxehtë! — tha ai duke përzier supën. — Më sill pak piper. Ani ja solli dhe u ul përballë tij. Filluan të hanë në heshtje.

12

— Dilet me këtë shi! — u ankua Ani, duke vështruar nga dritarja.

Jashtë binte shi i dendur. Dukej sesi pikat e tij lagnin facadat e pallateve kundruall, lëpiheshin nëpër degët e trungjet e drurëve, pickonin sipërfaqen e pellgjeve dhe thërrmoheshin në asfaltin e rrugës. Buzë trotuareve rridhnin rrëkera të turbullta. Gjithshka ishte e lagur, me ngjyra të shuara, me shkëlqim të mugët.

Ani u largua nga dritarja, psherëtiu dhe nisi të përgatitej.

— Mirë tani, po kur të jem fshatrave si do t'ja bëj! — tha. — Eh, ç'më gjeti! Dhe im atë thoshte që mjekësia është zanat i mirë. Të të zëri një shi i tillë maleve dhe... bëhu gati për spital.

Florës nuk iu durua.

— Mos u tremb, nuk pëson gjë! — tha. — Kushedi sa herë jam lagur gjer në kockë dhe ja tek

më ke, mirë e shëndoshë, pa parë kurrë spital me sy.

— Ti je kalitur në kantier! — ja bëri Ani, me ironi.

— Edhe ti do kalitësh!

Petrua lexonte gazetën dhe nuk ua vinte veshin. Ani mbathi një palë çarape të leshta, që t'i rrinin këmbët ngrohtë, pastaj diç kërkoi nën divan.

— Nuk kam as çizme për të qënë! — u ankua. — Të vjen turp t'i mbathësh. E shoqja e Andreas ka blerë një palë të mira.

— Kini të fala prej saj! — u kujtua Flora. — E takova mbrëmë. E qortova pse s'na kanë ardhur.

— Ç'të tha? — pyeti Petrua, me kureshtje.

— Se s'kanë patur kohë. Andrea qenka shumë i zënë me punë. Po riorganizokeni një repart në uzinë?

— Po.

— Çudi!

— Ç'ka për t'u çuditur! — tha Petrua, duke vështruar titujt e lajmeve të feqes së katërt.

— Ti, që je kryeinxhinieri, nuk ke qënë dhe kaq i zënë.

— Ja kam lënë Andreas këtë radhë! — tha ai.

— U vendos të bëhet ai riorganizimi? — ndërhyri Ani.

— Po. Unë isha kundër, po këshilli teknik vendosi kështu.

— Pse, more burrë, dole kundër rrymës, ç'të duhej! — e qortoi Ani.

— Prandaj hiqesh mënjanë, se ishe kundër, hë? — pyeti Flora.

— Pse, mos duhet t'i bjerë bretku së punuari,

sa herë i teket ndokujt të bëjë propozime? —  
kërceu Ani, duke kopsitur pardsynë.

— Shokët nuk lihen në baltë! — tha Flora.  
— Ata mund ta kryejnë edhe pa Petron, por kjo  
nuk do ta nderojë.

— Ej, posi, nga kjo mbeti t'i çmohet vlera  
Petros! — Ani rregulloi shallin dhe mori çantën. —  
Megjithëse... — Ajo hezitoi një çast, e menduar,  
pastaj u kthye nga i shoqi. — S'thotë keq, Petro,  
mos u hiq mënjanë. Mund të kesh pasoja.

— S'ka mbetur t'i zgjidhni ju punët e mia!  
— i ndërpreu ai, duke flakur gazetën me zemërim.  
— E di vetë se ç'duhet bërë. Ti, Flora, vështro  
mësimet kurse ti, Ani, shko në punë, se u vonove.  
— Vërtet u vonova! — tha Ani, duke marrë  
çadrën. — Obobo, ku do dal unë e shkreta me këtë  
shi!

Ani psherëtiu dhe doli. Petrua u rehatua në  
divan dhe mori përsëri gazetën. Flora vështroi atë  
copë qielli me re që dukej nga dritarja dhe iu  
duk sikur pështjellimi i reve të ngarkuara me shi, po  
shtrihej edhe në brendësinë e saj. Nuk ju durua më.

— Petro, si mund t'i dëgjosh me gjakftohtësi  
ato që thotë Ani? — shpërtheu.

— Hë? — Ai nuk i shqiti sytë nga gazeta.

— Apo je dakord me të?

— Çfarë, të grindemi, thua ti?

— Edhe të grindeni, po qe nevoja!

— S'ka kuptim. Njeriu do të prehet në familje!  
— tha ai qetësisht dhe vazhdoi leximin.

— Të prehesh, hë? Ta gjesh tryezën të shtruar,  
gjellën të shijshme, kafën të bluar freskët,  
ndërresat të lara e të kollarisura... Dhe, për hir të  
këtyre, i fal të tjerat. Si duket, këto ke quajtur

kryesore, kur vendose të martohesh! — Flora fliste me rrëmbim, e revoltuar nga indiferentizmi i vëllait.

— Në këtë botë s'ka gjë të përkryer! — filozofi Petrua. — Çdo familje ka mosmarrëveshjet e saj. Ke për t'u bindur kur të martohesh. Pa lëshime reciproke, pa durim, nuk i dilet.

— Por, këto s'janë çështje të vogla, për të cilat mund të bëhen lëshime.

— Atëhere, ç'duhet bërë, sipas teje, të ndahemi? — u acarua Petrua.

— Gjymtyra e sëmurë pritet vetëm, kur s'ka shpresë shpëtimi! — tha Flora. — Por, ç'ke bërë ti për t'ja ndryshuar botëkuptimin Anit? Asgjë! Bisedat tuaja mbeten zakonisht brenda caqeve të problemeve familjare, ose për t'u argëtuar me ndonjë nga ato ngjarjet që ti i quan «kronika e pabotuar e ditës». Si duket, kjo bën pjesë në programin e prehjes. Rrallë e tek çelen biseda të mëdha, por edhe këto mbeten shpesh të papërfunduara. Nuk pajtoheni në mendime dhe atëhere, pas ndonjë kundërshtimi të zbehtë, ti hesht. Sigurisht për të mos dëmtuar prehjen.

— Mos do ta kthejmë kuzhinën në sallë mbledhjesh?! — tha Petrua, me shpoti. — Më mirë se fjalët e mia, vetë jeta do t'ja korigjojë Anit ndonjë mendim të gabuar që ka. Ajo nuk është një shtëpiake e mbyllur brenda mureve të shtëpisë, por mjeke, me jetë të pasur shoqërore. Me kohë do të ndryshojë.

— Sikur Ani të mos dinte të gatuate, për shembull, a do tregoheshe kaq zemërgjerë, a do t'ja lije kohës në dorë? — pyeti Flora, me një buzëqeshje të hidhur. — Ti dje kërceve përpjetë, pse nuk ishin zier mirë makaronat.

— Ej, djalli nuk është kaq i zi sa ç'e bën ti! — tha Petrua, duke mos ditur ç'të thotë. — Trego të drejtën, mos ke ndonjë arësye tjetër që nuk të pëlqen Ani?

— Më vjen keq që dyshon kështu! — u zemrua Flora dhe brofi në këmbë. Unë e kam më tepër me ty, sesa me atë. Fundja, ajo...

— Mirë, mirë! — e ndërpreu Petrua, me një mënyrë që donte të thoshte «më ler të qetë».

Mori përsëri gazetën dhe vazhdoi leximin, me një pamje të ftohtë dhe indiferente.

Flora e vështroi një copë herë me keqardhje e zemërim bashkë, pastaj u kthye përnjëherësh dhe iku në dhomën e saj. Mbylli derën me rrëmbim dhe u lëshua në karrige. Ishte e shqetësuar. I dukej vetja e pafuqishme, e paaftë për të ndikuar mbi të vëllanë dhe kjo e bënte të vuante. Ç'të bënte, si të vepronte? Me kokën të mbështetur në pëllëmbë, mendoi sa u lodh. Pastaj ndjeu nevojën të shkëputej nga ai ambjent, të ikte diku.

Brofi në këmbë. Ora ishte katër. Takimin me Arbenin e kishte në pesë e gjysëm. Ku të shkonte gjer atëhere? Hezitoi një çast, me pardesynë në duar, pastaj e veshi. Vendosi të shëtiste vetëm. Nuk i rrihej brenda. U kujtua se Ani e kishte porositur të hiqte mishin nga zjarri dhe u kthye nga kuzhina.

— Ku shkon? — e pyeti Petrua, pa e vështruar në sy.

— Po dal.

— Kjo duket, se je veshur. Po ku, se?

— Kam për të kryer disa punë! — u përgjegj Flora, e çuditur nga toni i pyetjeve të tij.



— Mos ke ndër mend të takohesh me atë bandillin?

Flora brofi, e fyer.

— Po bëhesh gazi i botës, duke bredhur me të! — vazhdoi Petrua, rreptë. — Shikon qimen në syrin e tjetrit, kurse trarin në syrin tënd, jo.

— Pse flet kështu? — e qërtoi ajo, duke u munduar ta përmbante veten. Unë të kam treguar si qëndron kjo çështje.

— Dokërra! Pse nuk bëni celebrimin, atëhere?

— Sepse nuk jemi njohur aq sa të arrijmë atje. Për të hedhur çatinë, duhet përfunduar së pari karabinaja. Çdo gjë do të ndodhi në kohën e saj, vëlla.

— Përralla! Kush t'i jep këto mënd, ai? Sigurisht, atij kështu i vjen për mbarë.

— Pse fajëson një njeri që nuk e njeh? — e qërtoi ajo.

— Ç'nevojë kam ta njoh? Fshati që duket, s'do kallauz. Ç'mund të presësh nga një njeri, i cili komprometon pa të keq vajzën e botës? Mua s'më kanë pëlqyer kurrë tipa të tillë.

— S'bën mirë që flet kështu për të! — tha Flora e acaruar. — Ai është djalë i ndershëm.

— Ashtu të duket ty, moj e shkretë, se je dehur nga pasioni.

— Atëhere, urdhëro e njifu me të, bindu si është e vërteta, pastaj bindëm edhe mua, në qofsha e gabuar.

— Ha-ha! — qeshi ai me shpoti. — Edhe kjo na duhet: vëllai që shoqërohet me dashnorin e motrës, ha-ha! Me që erdhi fjala, thuaji të mos ma shkeli herë tjetër pragun, për deri sa jeni në këto marrëdhënje.

— Të paska fryrë Ani. Por, ai nuk erdhi fshehurazi.

— Kështu t'i thuash, more vesh?

— Unë i them, por më vjen rëndë për ty.

— Në të vjen vërtetë rëndë, për vete dhe për mua bashkë, jepi fund kësaj gjëndjeje! — iu shkreh ai.— Ja bëj celebrimin, ja ndahu prej tij!

— Ti sikur fole keq për të. Si më kërkon të bëj celebrimin, atëhere?

— Bëj si të duash, ti do jetosh me të, veç të marrë fund kjo gjëndje.

Ajo buzëqeshi hidhur.

— Ashu? Pra, për ty s'paska rëndësi me kë e lidh jetën unë, ç'familje do ndërtoj, s'paska rëndësi lumturia ime, por vetëm dukja e jashtme. Vallë, nuk e di, nuk e ke kuptuar sa vuajtje dhe fatkeqësi, sa ndërlikime shpesh të vështira për t'u zgjidhur, ç'jetë me mundime dhe ndrydhëse mund të fshihet pas një celebrimi të vendosur me mendjelehtësi në pasticerinë «Tirana», midis një torte dhe një kafeje?

— Dokërra, të gjitha këto janë dokërra! — tha Petrua duke bërë një gjest përçmonjës me dorë. — Ju dashkeni të dilni më të zgjuar dhe më përparimtarë se të tjerët. Posi! Ky nuk është përparim, por shturje.

— Nuk është e vërtetë! — e ndërpreu Flora, me zemërim. — I urrej ndoshta më shumë se ti ata ose ato që e përlyejnë fjalën dashuri, duke bredhur lule më lule, por nuk mund ta pranoj se dashuria e pastër, baza më e shëndoshë për të ngritur një familje, është shturje. Prandaj në nuk ndruhem dhe as nuk fshihemi. Gjithshka e kemi hapur, pa prapamendime dhe rezerva. E dimë se

kështu ngarkohemi me detyrime dhe përgjegjësi karshi shoqërisë, por nuk i trembemi kësaj. A nuk dëshmon kjo për pastërtinë e qëllimeve tona?

— Dëshmia më e mirë do të ishte celebrimi!  
— nguli këmbë Petrua.

— Ne nuk jemi kundër celebrimit! — tha Flora. — As kundër normave të tjera të shëndosha të shoqërisë, por duam t'i respektojmë ato jo formalisht, jo me hezitime dhe me shpresë tek fati, por me bindje dhe besim të plotë tek njëri-tjetri. Unë do t'i them «po» nëpunësit të gjëndjes civile, jo për të patur thjesht një burrë, as për të siguruar Tiranën, as për të përmirësuar kushtet e jetesës, po për të ligjëruar lidhjen me një njeri që ta dua, me të cilin të më bashkojnë dëshirat, qëllimi i jetës dhe gjithshka.

— Në arrifsh ta thuash këtë «po»! — u tall Petrua. — Të shohim se ku do mbytesh, në të ktheftë krahët ndonjë ditë.

— Sa dyshoke! — tha Flora, duke tundur kokën me keqardhje. — S'lë rast pa ma përmendur këtë. E mirë pra, ne nuk mendojmë të ndahemi, por edhe sikur të ndodhte, do të kishte shkaqe të forta, domethënë nuk do të ishim të përshtatshëm për njëri-tjetrin. Në këtë rast, mundet që edhe unë t'ja ktheja krahët atij. Pse, vetëm burrat e kanë këtë të drejtë? Më mirë një ndarje e tillë, sado e hidhur qoftë, sesa një familje fatkeqe, ose një ndarje e mëvonshme, akoma më e hidhur. Por, ne nuk mendojmë të ndahemi.

— Ti po ngul këmbë si mushka në pikëpamjet e tua! — tha Petrua, që e kishte dëgjuar të motrën me një admirim të pavetëdëshëm. — Nuk të pëlqejnë këshillat e mia. Me një fjalë, dashke të

mos përzihem në punët e tua. Por, unë nuk mund ta pranoj këtë.

— Jo, Petro, ty të përket të interesohesh për sjelljet e mia, madje më tepër se mua për të tuat. Ti je më i pjekur dhe e ke për detyrë të më ndihmosh, të më ruash nga gabimet, por gjithmonë duke u nisur nga botëkuptimi ynë dhe për të mirën time. Ty të përkiste të shqetësoheshe kur more vesh se unë shoqërohesha me një djalë, veç jo për thashethemet, po për të mësuar a është ai shok i denjë për mua, a ishte shoqëria jonë mbi baza të drejta, sa premtonte kjo lidhje për të krijuar një familje të lumtur. Përgjigjet për këto nuk gjenden duke urdhëruar që ai të mos ta shkeli pragun dhe as duke kërkuar në mënyrë të prerë ja celebrimin, ja ndarjen. Nuk mendon, vallë, se unë mund të bëhesha fatkeqe si nga celebrimi, ashtu edhe nga ndarja pa bindje? Në këto rrethana, si mund të mbështetem në këshillat e tua?

— Ty s'të pëlqekan as këshillat e mia, as botëkuptimi im, as familja ime! — tha Petrua, i lënduar në sedër. — Atëhere, pse denjon të banolesh këtu?

— Sepse këtu është shtëpia ime, sepse ti je vëllai im! — u përgjegj Flora, ndërsa sytë ju mbushën me keqardhje. — Nuk lakmoj rehatinë e këtushme, jo. Ti e di, unë jam mësuar me jetën e konviktit.

— Sigurisht, se ashtu je më e lirë të bësh ç'të duash! — tha ai, me një buzëqeshje ironike.

— Flet shtrembër, vëlla! Unë tani jam e rritur dhe askush nuk mund të më detyrojë të veproj në kundërshtim me bindjet e mia, këtu apo gjetiu

qofsha. Por, ne kemi nevojë për njëri-tjetrin, sidomos në rrethanat e krijuara.

— Në këtë shtëpi mua më përket të vendos!  
— diktoi Petrua. — Ti, përderi sa jetojmë bashkë, do të më bindesh.

— Ne, që të dy, duhet t'i bindemi arësyes, Petro! Jo t'i diktojmë njëri-tjetrit, jo të grindemi, por të bisedojmë, të këshillohemi dhe ta gjejmë rrugën që duhet ndjekur bashkërisht. Ndërmjet nesh ka hyrë një e çarë, kjo duket, por jo aq e madhe sa të mbetemi në të dy anët e saj. Le t'ja shtrijmë pra dorën njëri-tjetrit, si shokë, si vëlla e motër, para se kjo e çarë të jetë zgjeruar shumë. Ne duhet të ecim në të njëjtën rrugë, Petro. Nuk e kam fjalën për çështjen time, por sidomos për të tjerat...

Flora fliste me pasion, por butë, plot dhembshuri duke shtrirë pëllëmbët e hapura drejt Petros.

— Mos kërko ta kalosh bisedën gjetkë! — tha ai, me sytë në tavan. — Në do që të jetojmë bashkë, duhet t'i dëgjosh këshillat e mia, përndryshe...

— Nuk e besoj të arrish gjer atje! — tha Flora, e goditur nga këto fjalë. — Në e bëfsh, do ta dëmtosh rëndë familjen tonë dhe në radhë të parë veten. Unë, megjithëse do më dhimbtë shumë një ndarje e tillë, jam në gjëndje t'i bëj ballë jetës edhe e vetme.

— E di! — ja priti ai, duke buzëqeshur hidhur. — Të janë rritur krahët. Por, nuk e di se si do të përfundojë fluturimi yt!

— Më mirë të biesh duke fluturuar, sesa të zvarrisesh! — tha Flora.

Ani mori një jastëk, romanin dhe duke kaluar nëpër dhomën e Florës, doli në ballkon. Rregulloi jastëkun në kolltukun prej kashte, u rehatua në të dhe çeli librin mbi prehër.

Posa i kishte mbaruar punët e shtëpisë. Drekën ja kishte bërë gati Petros, vetëm sa për ta ngrohur. Meqë shërbimin e fillonte pasdite, vendosi të lexonte një copë herë. Leximin e kishte ndërprerë në një pikë kyçe dhe që kureshtare për fatin e mëtejshëm të heronjve.

Ishte i bukur ai mëngjez pranvere të hershme. Ballkonin e zinte mirë dielli dhe Ani ndjente sesi ngrohtësia e tij po i shkaktonte një plogështi të këndshme. Ajri sillte ato kundërmimet e veçanta që paralajmërojnë pranverën. Drita ishte e kuartë dhe e gëzueshme. Në lulishten karshi, mimoza kishte çelur plotësisht dhe lulet e saj të shumta formonin një njollë të madhe verdhoshe, e cila sikur e gjallëronte sfondin laraman të godinave përtej. Degët e një panje të trotuarit arrinin gjer në buzë të ballkonit. Në to dalloheshin sythet e fryrë, gati në të shpërthyer. Që poshtë vinin britmat e hareshme të një tufe kalamajsh. Rrallë kalonte ndonjë automjet, po zhurma e tij humbiste shpejt në hapësirë.

Ani mbylli sytë dhe me ëndje nderi fytyrën drejt diellit. Sa mirë që ishte! I shijonte së tepërmi ai mëngjez i ndritshëm dhe i qetë, pas gjithë atyre ditëve të murme, të lagështa, me vetëtimat e bubullimave jo vetëm në natyrë, por edhe në jetën e tyre familjare.

Petrua vinte në familje si një re e ngarkuar

me shi dhe elektricitet. Ishte përherë i zyntë, i padurueshëm dhe shpërthente për asgjë. Si duket, i kishte nxjerrë shumë telashe ajo çështja e riorganizimit të repartit. Nuk ja dëgjoi këshillën asaj, që të mos delte kundër rrymës dhe ja se ç'po pësonte. Çfarë konkretisht, nuk e dinte, se ai nuk i tregonte dhe që ta pyeste, nuk guxonte, por dukej se nuk i kishte punët mirë. Mbi këto qe shtuar edhe çështja e asaj të mallëkuarës, Florës.

Të djeshmen mbrëma ishin grindur përsëri. Dëgjoheshin gjer në kuzhinë britmat e Petros. Ngulte këmbë që Flora të mos dilte nga shtëpia dhe të mos shkonte tek Arbeni, i cili qenkësh i sëmurë. Ajo nuk i bindej. Vërtet se u tregua e durueshme, s'e ngriti asnjëherë zërin, por s'hoqi dorë nga e saj, doli që doli. Ç'vendosmëri, ç'forcë! Ajo vetë s'do kishte guxuar të vepronte ashtu. Në gjithë jetën e saj nuk mbante mend të kishte ngritur ndonjëherë krye në mënyrë të atillë. Vallë, ku e gjente atë forcë Flora? Ja kishte lakmi, megjithëse nuk donte t'ja pohonte këtë as vetes.

Ajo s'qe përzier në këtë çështje, madje as që e kishte pyetur fare të shoqin. Ç'i duhej? E kishte bërë më kohë detyrën e saj. Megjithatë, shqetësohej. S'mjaftonin hallet e tjera, edhe kjo duhej!

Ani çeli sytë dhe i hodhi mbi faqet e librit. E verboi bardhësia e tyre, prandaj u kthye kundër dritës dhe vazhdoi të lexonte. Moti i bukur dhe qetësia e atij mëngjezi e bënë t'i dukej sikur shtërngata kishte kaluar edhe për familjen e tyre.

Dikur iu duk sikur kërciti dera e jashtme e apartamentit. Përtoi të luante nga vëndi.

«Ndoshta më bënë veshët!» — mendoi.

Sakaq u dëgjuan hapa në korridor dhe ja behu Flora te pragu.

— Oj, ti qënke! — tha Ani, që ndërkohë kishte brofur në këmbë. — Kujtova mos kisha harruar, derën të çelur. Kaq shpejt i mbaruat leksionet sot?

— Nuk isha në leksion! — iu përgjigj Flora thatë, duke lëshuar çantën mbi shtrat.

Zbriti nga dollapi valixhen e saj të vjetër, i shkundi pluhurin dhe e vendosi të çelur në dysheme. Hezitoi një çast, pastaj çeli të dy kanatët e dollapit dhe filloi të nxjerrë plaçkat e saj. I paloste dhe i rendiste ngjeshur në valixhe.

«Vallë, ç'i ka shkrepur kësaj marruke?» — mendoj Ani.

S'e kishte parë të kunatën qysh të djeshmen në drekë. Pas grindjes me Petron, Flora kishte dalë dhe qe kthyer në mbrëmje, vonë, kurse në mëngjez kishte ikur që pa gdhirë.

«Prapa diellit!» — tha me vete, duke u shtirur sikur nuk i interesonte se ç'po bënte ajo. Por më në fund e mposhti kureshtja.

— Për ku kështu? — pyeti, pa i ngritur sytë nga libri.

— Në konvikt.

— Në konvikt, the?

— Po.

— Pse, nuk je mirë këtu? — Ajo ngriti sytë nga libri, duke u shtirur e habitur.

— Vallë, nuk e kupton se jam e detyruar të veproj kështu? — tha Flora, me shpoti.

— Nuk të përzuri njeri!

— Ashtu! Mos duhet të pres që të më nxjerrin prej krahu jashtë? Unë nuk e desha këtë,



nuk më vjen mirë që ndodhi kështu, por s'mund ta pranoj kushtin që më është vënë. S'mund të shkel mbi ndjenjat dhe bindjet e mia.

— Petrua për të mirën tënde e ka! — tha Ani, duke kaluar në dhomë. U mbështet tek pragu i derës së xhamtë dhe qëndroi në këmbë, me duar të kryqëzuara mbi kraharor.

— Fatkeqësisht ka ardhur dita që e mira e tij nuk pajtohet me të mirën time! — tha Flora.

— Mos kujton se duke vajtur në konvikt do ta shpëtosh? — vazhdoi Ani, me një buzëqeshje ironike. — Nuk e besoj. Turpi njëlloj e zë Petron, këtu a gjetiu qofsh ti.

— Nuk kam bërë ndonjë turp! — u zemërua Flora, duke çuar kokën me krenari.

— Ja, kjo që bën, ç'është? E ke menduar ç'do thonë bota, kur ta marrin vesh?

— Kush, llafazanët? Le të thonë ç'të duan!

— Hallall të qoftë, unë s'do ta bëja kurrë këtë?

— E di. Ti je brumosur ndryshe! — shpërtheu Flora.

— Po. Dhe jam krenare për këtë! — u krenkos Ani, e ngacmuar nga ironia e tjetrës. — Njeriu për një nder jeton në këtë botë, përndryshe rro sa të duash!

— Varet si e kupton nderin secili! — tha Flora, duke palosur një bluzë.

— Nderi një është për të gjithë.

— Jo. Dashuria është turp për ty, kurse për mua jo. Unë, ndryshe nga ti, nuk e quaj aspak të ndershme një femër që në prag të fejesës me njërin, do të ishte e gatshme të përfundonte me një tjetër, po të qe ky një rast më i leverdisshëm.

— Hm, sipas teje qënka më mirë të bredhësh parqeve me bandillë që, nesër-dejë mund të të kthejnë krahët! — tha Ani, me një ton therës.

— Kur me ndërgjegje ose nga mendjehetësia njeriu vepron ashtu, është keq, shumë keq, po kur e nis me ndjenja të pastra dhe del e gabuar, s'ke ç'i bën. Ndodh edhe kështu në jetë. Veç, më mirë të përballosh rreziqe të tilla dhe të jesh e zonja t'i kapërxesh, sesa ta ndërtosh familjen, duke e zëvendësuar bazën e saj, dashurinë, me një akt marrëveshje interesi reciprok.

— Ku e ke të bësh edhe ti një martesë si tonat! — tha Ani gjithë vrer.

— Kurrën e kurrës! E di ç'janë martesat e tilla? Simbioza, lidhje për plotësimin reciprok të nevojave të rëndomta, të cilat shëmben në goditjen e parë të fortë.

— Megjithatë, dije se të tillat si ne i duan burrat më tepër nga ato si ti.

— Hm, e varfër dashuri! Thuajmë, a ke ndjerë ndonjëherë mornica mallëngjimi vetëm duke dëgjuar zërin e Petros, a ke nuhatur ndonjëherë me mall bluzën e tij, a ke dëshiruar të vijë rasti që të bësh një sakrificë të madhe për të?..

— Këto janë gjepura. Jeta kërkon të tjera gjëra. Unë e bëj ç'duhet bërë, madje me të tepërt. Nderin ja ruaj, rrogën ja sjell, shtëpinë ja mbaj, shërbimin ja bëj, njerëzit ja pres dhe ja përcjell. Ç'i mungon, pra?

— I mungon një shoqe që ta dojë me një dashuri të madhe, një shoqe jete që t'i bëhet krah, jo vetëm për të përballuar nevojat e rëndomta të jetës së përditshme, po për ta nxitur dhe ndihmuar që të qëndrojë gjithmonë në radhët e para.

— Gjepura, fjalë të mëdha! — Ani bëri me dorë një gjest përçmonjës.

— Po, për ty gjepura janë, se ti mendon vetëm për një lumtëri të vockël, brenda mureve të këtij apartamenti dhe nuk do ta kuptosh se veç saj ka një lumtëri tjetër, më të madhe, pa të cilën ajo e vogla s'vlen. Ti i ngjan bretkocës që kënaqet me një copë pellgu dhe aspak shqiponjës që s'jeton dot pa qiellin.

— Ku i ke lexuar këto? Më mirë shko e recitoi diku dhe mos m'i dërdëllit mua.

— Ti nuk di ç'domethënë një ndjenjë e madhe, një gëzim i madh! — vazhdoi Flora, duke e gozhduar me sy. — Njerëzit si ti janë të destinuar për vogëlimes. S'të kam parë kurrë të kthehesh në shtëpi e lodhur, por e lumtur se i ke shpëtuar fëmijën një nëne, apo se i ke kthyer shëndetin një njeriu. Kam parë shkëndijëza lumtërie në sytë e tu vetëm kur bleve frigoriferin, qilimin, kur ke vënë pare në arkën e kursimit, kur ke blerë ndonjë fustan apo ndonjë plaçkurinë tjetër. Sa të varfra janë gëzime të tilla, pa ato të tjerat, të mëdhatë! Gjynah që ke një profesion të tillë; kaq njerëzor!

— Gjer më sot s'më ka thënë njeri as kaq për punën! — tha Ani, duke treguar majën e thoit.

— Mundet. Ti ndoshta e respekton rregulloren e brëndshme të ambulancës me atë përpikmëri që respekton edhe kontratën e martesës, veç për të gjitha këto nuk të shtyn zjarri i brendshëm, pasioni, por dëshira e ftohtë për të qenë në rregull, për të ruajtur situatën e krijuar dhe emrin e mirë karshi botës. Ti nuk i dashuron njerëzit. U bëre doktoreshë që të kënaqje egon tënde

dhe të familjes, që të gjeje një burrë sa më të përshtatshëm, që të siguroje mirëqenjen dhe ca më pak për t'u shërbyer njerëzve.

— Tepër kam bërë për njerëzit! — tha Ani, duke buzëqeshur hidhur. — E ç'tu shërbesh atyre, që të ta shpërblejnë kështu, si ti? Hëngre e pive dy vjet me radhë në shtëpinë time, s'dëgjove kurrë fjalë të hidhura nga goja ime dhe ja ç'po marr në vend të falënderimit!

— Kjo është e vërteta, Ani! Sa mirë do të ishte sikur ta kuptoje këtë. Por ti e ke të vështirë për ta kuptuar. Të afërmit e tu të kanë mbjellë dhe kultivuar në ndërgjegje jo virtute, siç kujton ti, por barëra të këqia. Nga ana tjetër, shkëlqimi i rremë i situatës që ke krijuar, ka shërbyer si pleh për këto barëra. Ai që duhej të të ndihmonte për t'i shkukur, yt shoq dhe im vëlla, po mbytet vetë prej tyre. E shikoj, po buzëqesh me ironi; e di që kujton se këto t'i them nga inati dhe më vjen keq, po s'kam ç'bëj. Jeta është e gjatë dhe me siguri do të vijë një ditë, kur do ta kuptosh sa shtrembër ke shkuar. Veç mos qoftë vonë!

— Folë, folë, por sado të thuash, sado të çirresh, bota e dinë kush je ti dhe kush jam unë! — tha Ani, duke iu zënë fryma nga inati.

— Cila botë, ajo që t'i ka vrrarë ty ndjenjat dhe dëshirat e mëdha, ajo që t'i ka zhgulur dalëngadalë krahët dhe të ka shndruar në një zvarnike të mjerë?...

— Lere botën time ti, se nuk e arrin dot, po vështro e mblidh plaçkat dhe ecë në rrugën që ke nisur!

— Në atë rrugë do të eci! — tha Flora, me krenari. — Jam e bindur se ajo nuk të çon në batak.

— Hm! — kërciti dhëmbët me urrejtje Ani, pa ditur ç'të thotë.

I hodhi një vështrim përçmonjës së kunatës dhe doli në ballkon. U ndodh ballëpërballë panoramës që pak më parë i kishte sjellë aq kënaqësi. Tani e vështroi me indiferentizëm. Madje drita e fortë dhe ngjyrat e gjalla iu dukën të ashpra, armiçësore. Ngrohtësia e diellit i shkaktonte zagushi. Britmat e gëzuara të kalamajve i ngacmonin nervat. Dëgjoi krisjen e bravës së valixhes.

«Hajt, thyeje qafën!» — tha me vete. Dëshironte të mbetej vetëm sa më parë.

Flora ngriti valixhen, e nxori në koridor dhe u kthye një çast përsëri. Hodhi sytë rrethëqark. Përveç abazhurit të saj të vockël, gjithë orenditë ishin në vendet e tyre. Megjithatë dhoma dukej tani e ftohtë, pa jetë. Kujtoi, si në një film të përshpejtuar, ditët dhe netët që kishte kaluar aty, mendimet dhe ëndërrimet që kishte thurur. I erdhni keq që po ikte kështu. Ndjeu se po i mbusheshin sytë me lot.

— Mbi tryezë kam lënë një pusullë për Petron!  
— tha duke mbledhur vehten sakaq. Tungjatjeta!

— Udhëmbarë!

Këto fjalë nuk tingëlluan aspak si një urim.

Ani dëgjoi çape në korridor, pastaj derën e apartamentit që u çel e u mbyll dhe mori frymë, e lehtësuar.

Flora i zbriti me vështirësi shkallët, se librat ja kishin rënduar shumë valixhen. Bëri sikur nuk i dëgjoi përshëndetjen dhe pyetjen e Ksanthipit që doli sakaq tek parmaku. Vetëm kur arriti poshtë lëshoi valixhen dhe u çlodh.

— Ku po shkon, teta Flora? — e pyeti fëmija e një fqinji, që po luante aty.

— Po iki, xhan i tetës! — Ajo i përkëdheli faqet. E donte shumë atë fëmijë.

— Kurr të kthehesh, ç'do më sjellësh? — e pyeti ai, duke e zënë prej fustani.

-- Karamele, xhan, nga ato me mjaltë. Mirë? Tani merri këto lekë dhe shko e blej vetë tek ai xhaxhi atje! — I futi në dorë një kartmonedhë të vogël, ja shtrëngoi gishtat përmbi të, e puthi në faqe dhe ngriti përsëri valixhen.

— Teta Flora po ikën, teta Flora po ikën! — thirri kalamani, duke ecur pranë saj dhe duke nxitur kështu kureshtjen e disa grave që dolën menjëherë në dritare.

— Pusho, mos thirr! — e qërtoi Flora me zë të butë dhe nxitoi nëpër trotuarin e ngushtë buzë apartamentit.

Në stacionin e autobuzave nuk priste njeri. Ishte ora në të cilën dyqanet janë mbyllur, fëmijët akoma s'kanë dalë nga shkolla, të rriturit janë në punë, kurse amvisat përgatitin drekën nëpër shtëpi. Rruga dukej e qetë. Edhe autobuzi arriti pothuaj bosh.

Flora rregulloi valixhen në një qoshe, pagoi biletën dhe zuri vend pranë xhamit. Vështroi stacionin që i ishte bërë aq familjar, godinat pranë të cilave kalonte përditë dhe e pushtoi përsëri nostalgjia.

Zbriti në stacionin e qëndrës. Pesha e valixhes ja mpiu shpejt krahun, por ajo nuk u ndal veçse përbri parkut «Rinia». Bulevardi ishte i qetë dhe i kredhur në dritë. Në fund zbardhonte godina e lartë e Universitetit. Ajo e ndjente veten të lodhur dhe pak të trishtuar. I vinte mirë që s'po

takonte ndonjë të njohur. U ndruhej pyetjeve që mund të ndillte valixhja.

Rinën e takoi, kur hyri në shëtitoren «Marsel Kashen».

— Ku je, moj, se plasa duke të kërkuar! — thirri ajo dhe u mat t'i merrte valixhen.

— Lere se e mbaj vetë! — tha Flora.

— Hajt, mos bëj naze, dukesh që je e lodhur. Ou, sa e rëndë qënka! Si e mbajte vetë gjer këtu? — Ajo fliste shpejt dhe në zërin e saj ndjehej një përkëdhelje gadi feminare. — E di? E rregulluam me administratën që të vish në dhomën tonë.

— Do t'ju ngushtoj tepër, moj Rinë!

— Punë e madhe, se mos do hedhim valle në të! Jemi për bukuri. Do ta shikosh vetë. Shtratin ta vendosa pranë timit. Mirë? Madje ta kam shtruar. I mora unë paisjet në dorëzim.

— Faleminderit! — Flora buzëqeshi, e prekur nga kujdesi i shoqes.

— Sa mirë do t'ja kalojmë! — vazhdoi Rina, gëzueshëm. — Vështro, paskan çelur shëlgjet!

Flora ngriti sytë, pa gjethet e vockëla e të tejudkshme, qiellin e kaltër, retë e pakta, që dukeshin si shkumë, dhe ndjeu se ajo bukuri e freskët po i vërshonte në brendi.

Pas pak arritën në konvikt. Edhe atje kishin çelur pemët e oborrit. Një studente e veshur me tuta po nderte rrobet në degët e tyre. Dy të tjera, ulur në shkallët e hyrjes, po ngroheshin në diell dhe kuvëndonin.

— S'ka filluar ende gjallëria, se janë në lek-sione! — tha Rina.

— Po ti? — u kujtua Flora.

— Mora leje dy orët e fundit.

Flora e vështroi shoqen me dashuri dhe mirënjohje.

— Arbeni kishte ardhur sot? — pyeti pastaj.

— Jo.

— Kushedi, t'i ketë rënë temperatura, vallë?

— Sa bëhesh merak edhe ti, Flora! Se mos ka gjë të madhe! Ku do t'ja dijë ai nga gripi.

Ato përshkuan korridorin e gjatë dhe qëndruan para një dere.

— Uf, sa e rëndë qënkësh! — tha Rina duke lëshuar valixhen. Nxori shaminë, fshiu bulëzat e djersës nga balli, pastaj edhe xhamat e syzeve.

Flora vështroi përreth me kureshtje, ashtu siç e vështroi kushdo vendin e ri të banimit. Shtretërit prej hekuri, të renditur pranë e pranë, ishin të shtruar me kujdes. Në qoshen afër portës ndodhej një raft i madh prej kompensatoje, kurse në qoshen tjetër, përballë dritares, një tavolinë dhe dy karrige. Në shpinëzën e njëres prej tyre qenë hedhur një fund dhe një bluzë e leshtë. Mbi tavolinë ishte një vazo e vogël porcelani me lule mimoze. Dhoma, si çdo dhomë, kishte kundërmimin e saj të veçantë, që ishte i ri për Florën. Megjithatë, ky ambient i ngjalli asaj kujtimet e jetës së kaluar në konvikte, dhe ndjeu një farë kënaqësie që po rikthehej në të.

— Ja, ky është shtrati yt! — tha Rina duke i rënë me pëllëmbë batanijes së murme. — Nuk nxinte vendi komodinë tjetër, po s'ka gjë, na mjafton e imja. Të kam liruar sirtarin. Unë do përdor raftin e poshtëm. Tani eja të rregullojmë plaçkat e tua.

— Mirë! — Flora çeli valixhen dhe i hodhi një vështrim pyetës shoqes.



— Fustanet m'i jep t'i var në dollap! — tha ajo.

Punuan të heshtura pranë e pranë, gjersa i renditën të gjitha plaçkat në vendet e duhura. Pastaj Rina doli jashtë dhe u kthye duke mbajtur në dorë një degë të lulëzuar, që lëshonte një kundërmim të lehtë. E vendosi me kujdes në vazo dhe e admiroi.

— Budallaqe, mos u mërzit! — i tha Florës që ishte tretur në mendime. — Unë do isha e lumtur sikur të kisha dikë, për të cilin të bëja diçka të tillë! — Ajo buzëqeshi, por kishte diçka të trishtuar në buzëqeshjen e saj.

— Sa e mirë që je! — i tha Flora dhe i shtrëngoi dorën me dashuri. Befas ai ambjent iu bë i dashur, i ngrohtë dhe i gëzueshëm.

Në oborr u dëgjuan zëra.

— Po kthehen shoqet! — tha Rina dhe rendi në dritare.

Flora ktheu kokën andej dhe pa degët e lulëzuara të një qershie.

#### 14.

Po ngrysej dhe drita që hynte nga dera e xhamtë e ballkonit pakësohej dalëngadalë. Arbenin e kishte rrëmbyer aq shumë romani «Si u kalit çeliku», sa nuk i bëhej të ngrihej nga shtrati për të ndezur dritën. Vetëm kur e mbaroi kapitullin, mbylli librin, fërkoj sytë me pëllëmbë dhe vështrou atë copë qielli të perëndimit që dukej ndërmjet prevazeve të ballkonit. Ajo pamje plot dritë dhe ngjyra të përflakura, iu duk si sfondi i mbetur nga ngjarjet e porsalexuara.

Atij gjithmonë i kishin pëlqyer tregimet për njerëzit e fortë. E kishte bërë zakon që pasi lexonte vepra të tilla, të gjykonte me vete nëse ai, po të ndodhej në të njëjtat rrethana, do të ishte i zoti të vepronte ashtu, apo jo. I pëlqente të arrinte në përfundimin se po dhe inatosej me veten kur dyshonte. Nganjëherë i vinte keq që s'kishte patur rast të vihej në provë, sepse e kaluara e tij kishte qënë e thjeshtë.

Arbeni ishte biri më i vogël i një familjeje të madhe, me dy vëllezër dhe tri motra. I ati kishte punuar gjithë jetën si murator. Gjersa kishte dalë në punë vëllai i madh, jetonin fare thjesht, por asnjëri nuk ankohej nga kjo. Arbeni nuk mbante mend të ishte turpëruar ndonjëherë nga arnat në pantallona, apo nga këpucët e vjetra, as t'i kishte bërë ndonjëherë naze bukës me domate. Qysh atëhere që mësuar të përballonte çdo vështirësi pa u ankuar dhe i kishte zët qarramanët.

Si nxënës, Arbeni ishte bërë shpesh objekt diskutimesh ndërmjet mësuesve, sepse në disa lëndë shkëlqente, kurse në disa të tjera ishte nën mezataren, por asnjëherë s'kishte mbetur për riprovim. Atij nuk i bëhej të mësonte rregullat e gramatikës, emrat dhe datat, madje i qesëndiste bashkënxënësit që ishin në gjëndje t'i rrjeshtonin pa gabuar gjithë datat e librit të historisë. Megjithatë, kur mbaroi teknikumin e ndërtimit, projekti i tij i diplomës pat qënë ndër të mirët. Pastaj, në kantjer e mbanin për teknik të zotin dhe i besonin punë të vështira. Ai, qysh në vegjëli, ishte mësuar t'i shikonte njerëzit e rrethit të tij duke punuar dhe puna i që bërë nevojë.

Edhe në fakultet ai iu vu punës me ngulm qysh

në fillim. Shënonte çdo shpjegim të pedagogut dhe lexonte literaturën e rekomanduar, duke u munduar të zbërthente e të përvetësonte gjithshka. Tashmë e dinte se pas një fraze, pa rëndësi në dukje, mund të fshihen zgjidhjet e shumë problemeve të praktikës. Nuk mërzitej aspak kur ndonjeri nga shokët e vitit e thërriste me shaka «kallëpi».

Dashuria për Florën ishte për të diçka e re dhe krejt e ndryshme nga ato pak simpatira që kishte patur, pa ruajtur prej tyre ndonjë mbresë. Kjo dashuri nuk i kishte ardhur si ujërat e rrëmbyera të një përroi që vërshen pas shiut, por i qe rritur si një lis, që lëshon rrënjë përherë e më të thella.

Dashuria nuk i kishte sjellë atij kotje të ëmbla, arratisje nga jeta, soditje resh të trëndafilta, psherëtima dhe vështrime të humbura, por nxitje të forcave, aftësive dhe dëshirave. Ai i përvetësonte tani më mirë leksionet, i zgjidhte më shpejt detyrat e praktikave, ishte më i shkathët në ndeshjet e basketbollit, e ngulte më thellë kazmën gjatë punës vullnetare, i donte më fort shokët, i dukeshin më të bukura lulet dhe më i kaltër qielli.

Flora ishte e pranishme në të gjitha planet dhe ëndërrimet e tij të guximshme, jo duke gatuar gjellë në kuzhinën e ngrohtë, as duke qëndisur në kopshtin e gjelbëruar, apo duke e pritur buzagaz tek pragu i shtëpisë, por gjithmonë krah tij, në shtegëtimet nga një kantier në tjetrin, mbi skelat e ndërtesave, në pushimet buzë detit, në inaugurimin e një objekti të përfunduar, në ditën e parë të shkollës për fëmijën e tyre...

Më parë, martesa e trembte me të panjohurën e saj, i dukej si një prag i madh e i vështirë për

t'u kapërxyer. Kishte marrë pjesë dikur në fejesën e një kushëriri, kur shkuan të pijnë kafet. Paskëtaj, sa herë vinte fjala për martesë, i kujtohej pamja e tronditur e kushëririt gjatë ceremonisë, fytyra e tij e dirsur nga sikleti, duart që ai s'dinte ku t'i fuste dhe përgjigjet çaprazçe që jepte gjatë bisedës. Tmerrohej kur e imagjinonte veten në një situatë të atillë. Tani të gjitha këto i dukeshin qesharake. Sepse ai me Florën, si dy degë të një lumi, ishin bashkuar në mënyrë të natyrshme me njëri-tjetrin, për ta vazhduar bashkërisht gjithë pjesën tjetër të rrugës.

Në copën e qiellit që vështronte Arbeni, qenë shuar tanimë flakërimat e perëndimit, por në sytë e tij digjej një flakë tjetër. Duke menduar për jetën, për të ardhshmen, ai ndjente një ngazëllim të parrëfyshëm, aq sa i vinte të hidhej nga shtrati, të delte jashtë dhe të bridhte, të bridhte, i etshëm që ta shijonte, ta prekte, ta përqafonte gjithësinë.

E shkëputi nga mendimet krisja e derës. Dikush çeli dritën. Duke picëruar sytë, ai pa Ibrahimin që flaku çantën mbi shtrat.

— E, si ndjehesh, të kaloi gripi? — e pyeti ai.

— Mirë jam. Madje mund të kisha dalë, por s'ka gjë, lexova diçka të bukur.

— Aha, «Si u kalit çeliku» ! — tha Ibrahim, duke hedhur sytë nga libri. — Nuk e kishe lexuar?

— Po, qysh në shkollën shtatëvjeçare.

— Erdhi të të kërkonte sot Flora? — pyeti Ibrahim, gjoja i shkujdesur.

— Jo.

— Por, ndoshta ti e di! — mërmëriti ai.

— Çfarë? — pyeti Arbeni, duke brofur nga shtrati.

— Që ajo ka shkuar të banojë në konvikt.

— Ashtu?!

— Më tha Rina. Sot në mëngjez. Kujtova se e dije.

— Jo! tha Arbeni dhe filloi të vishej me ngut.

Ibrahimi ngriti supet, i habitur, diç mërmëriti dhe u mor me punët e tij.

Arbeni doli pa përshëndetur, i zbriti shkallët nga dy dhe nxitoi nëpër shtegun më të shkurtër drejt konviktit të vajzave. Të parën studente që takoi tek hyrja, e luti t'i thërriste Florën.

— Kë, atë që erdhi sot? — pyeti ajo, me djallëzi.

— Po, atë! — iu përgjigj ai, pa u kujtuar për djallëzinë e saj.

I erdhi inat pse studentja po ecte aq ngadalë drejt konviktit dhe e brente padurimi, ndërsa priste, duke vështruar me ngulm portën e xhamtë, nga ku duhej të dilte Flora. E njohu menjëherë siluetën e saj dhe diç u qetësua kur vuri re se ajo po i buzëqeshte që larg.

— Ç'qe kjo? — e pyeti, duke i shtrënguar fort dorën.

— Pse dole, Arben, do të të kthehet gripit! — e qortoi ajo, butë.

— Jam mirë tani. Ç'ndodhi? — pyeti përsëri ai.

— Durim, do të ta tregoj. Eja të shëtisim pak!

Ajo tregoi me dorë nga fakulteti i gjeologjisë dhe kaloi përpara.

— Hë? — ja bëri ai, me kureshtje, duke ecur krah saj.

— Dje, para se të vija tek ti, bëra fjalë me

vëllanë. Më pyeti ku do të shkoja dhe unë i tregova të vërtetën. Atëhere nuk deshi të më linte.

— Pse?

— Të kam thënë, atij nuk i pëlqen kjo lloj miqësie që kemi ne. Sipas tij shoku i jetës duhet zgjedhur si një palë këpucë në mapo: i pe, të pëlqyen, merri pra! Më kishte dhënë ultimatum: -ja celebrim, ja ndarje.

Arbeni u mendua një hop.

— Fundja, për t'u bërë është! — tha.

— Por jo kur të urdhërojë një i tretë, as me ultimatum. Kjo do të ishte fyese për ne dhe për miqësinë tonë.

— Po, ke të drejtë! — tha ai.

— E pra, dje im vëlla deshi të zbatonte ultimatumin! — vazhdoi ajo. — U mundova boll ta bindja se s'kishte të drejtë të më kërkonte diçka të tillë, por më kot. Kur u ktheva dje mbrëma në shtëpi, ai nuk më foli me gojë. Atëhere vendosa. Në asnjë rrethanë, me çdo kusht qoftë, s'mund të pranoj që të merret nëpër këmbë dinjiteti im, e drejta ime për të jetuar sipas bindjeve të mia.

Ndërsa shqiptonte këto fjalë, asaj i vetëtitën sytë me krenari.

— Ke të drejtë! — tha përsëri Arbeni, duke e vështruar me admirim.

— Megjithatë, më vjen keq! — vazhdoi Flora. — Më vjen keq pse ndodhi pikërisht në një kohë kur Petrua ka nevojë për ndihmë. Ai duhet ndihmuar të gjejë vetveten. Po si? Thua të bisedoj me shokët e tij?

— S'do ishte keq! — tha Arbeni.

— Sidoqoftë, diçka duhet bërë! — tha ajo dhe u tret në mendime.

Ata e kishin lënë pas fakultetin e gjeologjisë dhe po i ngjiteshin kodrës së parkut të madh. Ecnin të heshtur në rrugën e errët dhe të rrethuar në të dyja anët me kurora të dendura drurësh. Mes tyre dukeshin yjet.

— A u sistemove në konvikt? — pyeti ai.

— Po, fare mirë. Në fillim deshën të më vinin me studentet e vitit të parë, por pastaj më bënë vend shoqet e vitit në dhomën e tyre. Shtratin e kam pranë atij të Rinës. U bë copë sa më rregulloj, madje humbi leksionet për shkakun tim. Sa e mirë që është!

— Po! — tha Arbeni dhe heshti.

Vriste mendjen për gjëndjen e Florës. Ajo e kuptoi ç'mendonte. E zuri prej dore dhe tha, me një pamje të gëzuar:

— Jam mirë në konvikt, Arben! E ke provuar atë lloj gëzimi që ndjen kur kthehesh në mënyrën e vjetër të jetesës? Ja, diçka të atillë ndjeva edhe unë sot. Sa e dashur dhe optimiste m'u duk gjallëria e konviktit!

— Blokun e mensës, e more?

— Po. Të gjitha në rregull i kam. Ja, do mbarojmë vitin, pastaj do shkojmë së bashku në aksion...

— Pastaj? — e ndërpreu ai.

— Edhe këtë e kam menduar! — buzëqeshi ajo. — Do shkoj të punoj në kantierin tim. Jam e sigurtë se ata do më presin krahëhapët. Dy javë çlodhje më mjaftojnë. Tek e fundit, gjithë punonjësit aq pushojnë, apo jo? Sa më ka marrë malli të ngjitem në një skelë të lartë!

— Ç'punë do të bësh atje? — e pyeti ai, duke e vështruar me dashuri.

— Muratore, për shembull. Pse qesh? Ta shikosh se ç'punë nxjerr! Besoj se ta kaloj, megjithëse je bir muratori.

— Mos u lavdëro kaq shumë!

— Me gjithë mend e kam! Mësova kur isha në kantier. Po nuk dite vetë, s'je ballëhapur, kur i kritikon punën tjetrit. Punoj ngadalë, por atë që bëj, e bëj!

— Prandaj i ke duart kështu, të ashpra! — tha Arbeni, duke i ledhatuar pëllëmbat.

— Pse, nuk të pëlqejnë? — Ajo i hodhi një vështrim çapkën.

— Përkundrazi! — Ai ja shtrëngoi duart me dashuri në pëllëmbë, pastaj tha: — Mirë, trimëresha ime, bukur paske merduar, veç të mbarojmë një herë me sukses vitin, pastaj aksionin, pastaj... shohim e bëjmë!

Kishin arritur në kulmin e kodrinës. Hëna s'kishte dalë ende dhe liqeni nuk dukej, por ndjehej prania e tij, nga puhija e lagësht që sillte ajri. Dëgjoheshin fëshfëritjet e gjetheve dhe lëvizjet e papritura të gjalesave ndër kaçuba, që ja shtonin fshehtësinë natës.

— Zbriti vesa! — tha Flora, duke përkëdhelur me pëllëmbë barin e dendur e të njomur të lëndinës, përmes së cilës kalonin; pastaj i shkoi mbi fytyrë pëllëmbët e lagura dhe lëshoi një klithmë kënaqësie.

## 15

Petro Lisi mori dosjen e çështjeve të ditës dhe e shfletoi. Asgjë me rëndësi. I kërkoi punë vetes, se po e brente mërzia. Nisi t'i përgjigjej një kërkese, por sakaq e bëri shuk konceptin dhe e flaku



në shportë. Pastaj mblodhi ato pak fletë që kishte përhapur mbi tryezë dhe i rراسi grumbull në sirtar. Si gjithmonë kur ishte i shqetësuar, nisi të endej me çape të rënda nëpër zyrë.

Prej disa ditësh nuk ndjehej në ujërat e veta. Vinte rregullisht në punë, shfletonte dosjet, jepte e merrte përgjigje për probleme të ndryshme, udhëzonte, firmoste, pyeste për realizimin e planit, por të gjitha këto i bënte ftohtë, pa shpirt, si ndonjë robot.

Në shtëpi shkonte sa për të ngrënë e për të fjetur, por edhe kur qëndronte, dergjej i ploget në divan, me kokën të turbulluar nga turli mendimesh.

Ani mendohej si e si t'ja bënte qejfin: i gatuanë gjellët e preferuara, ja ndërronte shpesh këmishët dhe të linjtat, ngutej t'i plotësonte çdo dëshirë, por këto e shqetësonin më tepër, sepse i kujtonin gjëndjen e tij të veçantë.

Shqetësimet më të mëdha i filluan me ikjen e Florës. Atë ditë që e mori vesh se ajo ishte transferuar në konvikt, shau, bërtiti dhe u betua se nuk do ta quante më për motër. Të nesërmen dukej i qetë, por me një qetësi të zyrtë. Mendime të ndryshme, krejt të kundërta, i fshiheshin nën këtë maskë.

«Mirë shokët, mirë Andrea, po motra, motra që më donte aq shumë, pse ma bëri këtë?» — mendonte. — «Vallë, as ajo s'ma do të mirën? Po të ma donte, pse iku? Por, a mund të qëndronte duke pranuar kushtet që i vura? Mos jam vetë fajtor për të gjitha? Unë kurrë s'kam menduar për keq. Pse ndodhi kështu, atëhere?»

Atij i qe lëkundur tashmë besimi në drejtësinë

e mendimeve dhe të veprimeve të tij. Bota e tij e brendshme i ngjante një qyteti, pas një tërmeti të fortë.

Për këto mendonte Petrua, duke u endur nëpër zyrë, ku sundonte një qetësi e pazakontë. Asnjëri nuk kishte trokitur në portë, as telefoni nuk binte. Vetëm që poshtë vinte zhurma e pandërprerë e punës. Dukej sikur askujt nuk i bëhej vonë në ishte ai aty, apo jo, dhe puna vazhdonte pa të. E ndjeu veten të tepërt, të padobishëm, të braktisur. E rëqethi ky mendim. Dëshiroi të largohej nga ajo zyrë, të kishte njerëz përreth. Si i shtyrë nga një forcë e jashtme, mbylli zyrën dhe zbriti shkallët.

Pa e kuptuar, u gjënd në repartin e parë. Kaloi si në revistë pranë makinerive dhe aty-këtu bëri ndonjë pyetje, shqyrtoi ndonjë detal, tha ndonjë vërejtje. Pyeti përgjegjësën e repartit për problemet e ditës dhe diçka shënoi në bllokun e tij. Pyeti nëse i kishte penguar riorganizimi i repartit të tretë dhe i thanë se jo. As u gëzua, as u hidhërua.

Kaloi repartin e dytë dhe u step tek hyrja e të tretit. Për shumë arësye nuk desh të shkonte atje, por diçka e pakuptueshme e shtynte të hyjë.

Hyri. Pa një gërshetim të çuditshëm rregulli dhe rrëmujë. Disa nga makineritë punonin, disa ishin në montim e sipër, të tjerat po i çmontonin. Mbi dysheme kishte detale të sapoproduhuara, pjesë të çmontuara, dado, çelsa, llaç çimentoje, lopata. Asnjëri nga punëtorët, për asnjë çast, nuk qëndronte kot. Ngado vështrime të përqëndruara, muskuj të tendosur, fytyra të djersitura, lëvizje. Ishte një vajtje-ardhje e pandërprerë, dëgjoheshin thirrje,

zhurma dhe krisma metalike, por në të gjitha këto sikur kishte një harmoni të veçantë që e mundte përshtypjen e rrëmujës.

Petrua vuri re Andrean që punonte në një cep, së bashku me punëtorët. Edhe ai ishte me kominoshe, i zhyer me graso e vaj, i pluhurosur dhe i dirsur. Vetëm të bardhët e syve i kishte mbetur pa iu përlyer.

Kujtoi kohën, kur edhe ai punonte kështu, si Andrea, dhe e ndjeu veten të shkëputur, të larguar nga ajo punë, nga ata njerëz. I erdhi keq. Uli sytë. Vuri re rrobet e tij të pastërta, duart e bardha, të vetmet të atilla atje. I erdhi turp. Sakaq i shkrepri dëshira të flakte xhaketën, të përvishte mëngët dhe të radhitej krahas shokëve. Bëri disa çape drejtë cepit ku punonte Andrea, po pastaj u step. E pengoi krenaria.

Kohët e fundit Andrea ishte munduar disa herë t'i afrohej, të bisedonte me të, por ai i qe shtëmangur. Nga njëra anë kishte nevojë të bisedonte me një shok, t'i qante hallin, të shfrente, por nga ana tjetër nuk i vinte mirë që ai ta merrte vesh se ç'ndodhte në bren-dinë e tij. Kjo e dyta kishte dalë më e fortë dhe ai e kish pritur dhe përcjellë Andrean me mirësjellje, por ftohtë. Kurse të djeshmen ishin zënë. Andrea qe treguar i ashpër këtë radhë, madje kishte arritur t'i thoshte se ai po ecte në kundërshtim me interesat e popullit, kurse në familje po sillej si një feudal. Sigurisht kishte marrë vesh çështjen e Florës. Petrua ja kishte prerë shkurt. I kishte thënë se nuk e lejonte t'i ndërhynte në çështjet familjare, mjaft që ishte i detyruar ta dëgjonte për punët shtetërore. Pastaj i qe lutur

ta linte të punonte. Andrea kishte dalë nga zyra i pezmatuar, kurse ai sakaq ishte penduar që e nxori jashtë.

Këto kujtoi Petrua dhe shkoi më tej, duke u shtirur sikur nuk e pa Andrian. Kërkoj për-gjegjësin e repartit dhe e pyeti për prodhimin. I thanë se prodhimi qe ulur, por në sajë të rezervave që kishin krijuar para se të fillonte riorganizimi, nuk qe penguar aspak puna e reparteve të tjera. Përsëri as u gëzua, as u hidhërua.

Ju afrua xha Vasilit. Ai e përshëndeti shkurt dhe vazhdoi punën. Petros iu ndez përsëri dëshira që të përvishte mëngët dhe të punonte bashkë me të, madje vendosi të vepronte kështu. I solli gëzim të madh ky vendim. Kërkoj mënyrën si t'ja fillonte.

— Ta kishe vendosur ca më pranë asaj tjetrës!  
— i tha mjeshtrit. — Ashtu s'do të dilte nevoja për t'i transportuar detajet gjer tek ajo.

Xha Vasili vuri duart në ije, e vështroi me keqardhje tornon e montuar dhe mërmëriti:

— Hej, drej, si s'më shkoi ndër mend!

Pastaj ngriti sytë nga Petrua dhe i tha, ashpër:

— Të kishe ardhur mbrëmë natën të ma bëje këtë vërejtje!

Petrua ndjeu se po skuqej nga turpi dhe nga sedra e lënduar. Do të desh t'i përgjigjej edhe ai ashpër, por e kuptoi se do bëhej qesharak, prandaj heshti.

Tani donte të dilte sa më parë nga reparti. Nuk dinte si! Askush nuk po e thërriste nga zyra ose nga repartet e tjerë. Tek ecte mes makinerive, i dukej sikur e përqueshte ajo njolla e vogël që

kishte marrë në manshetën e bardhë të këmishës dhe që i dilte para syve sa herë luante krahun. Bëri si bëri dhe iu afrua daljes.

Jashtë u ndie disi më mirë, por i kishte mbetur një ndjenjë e papëlqyer, brejtëse, helmin e të cilës e ndjente edhe në gojë. U drejtua për në zyrë. I ngjiti shkallët me mundim duke u mbështetur në parmakun e tyre, sikur kishte një barrë të rëndë në shpinë. Përplasi pas vetes derën e zyrës dhe shkoi drejt tavolinës. U lëshua mbi karrige, mbështeti bërrylat në xhamin e ftohtë dhe ballin përmbi grushta. Mbylli sytë dhe e lëshoi veten në tallazin e mendimeve.

«As më kishte shkuar kurrë ndër mend se ti do bëheshe i tillë!» — i kishte thënë Andrea.

«Ta kanë cmirë, prandaj flasin ashtu!» — thoshte Ani.

«Ti më detyrove të veproj kështu. Më vjen keq jo pse u ktheva në konvikt, por pse u largova prej teje në një kohë kur ke nevojë për ndihmë që të dalësh nga batak!» — i shkruante Flora.

«Të kishe ardhur mbrëmë natën të ma bëje këtë vërejtje!» — tha xha Vasili.

«Ti kështu po shkon në kundërshtim me interesat e popullit!» — qe nxehur Andrea.

«Po unë, unë ç'them?» — pyeti veten Petrua.

Brofi në këmbë. Nxitoi tek dritarja dhe e çeli. Kishte nevojë për ajër.

Sapo mbaroi mbledhja e partisë, Petro Lisi nxitoi drejt derës, por sakaq ajo ishte dyndur me njerëz dhe iu desh të priste.

E gjatë dhe e vështirë iu duk ajo pritje. Qëndronte kokulur, por e ndjente se vështrimet e të tjerëve qenë përqëndruar tek ai. Mundohej ta përmbante veten, të shtirej i qetë, por s'ja dilte dot dhe kjo ja shtonte shqetësimin.

Kur kapërxeu pragun, sikur iu hoq një peshë nga kraharori. Çau nëpër koridor, i zbriti dy e nga dy shkallët, përshkoi me hap të shpejtë oborrin e uzinës dhe nxitoi t'i hipte autobuzit urban. Vetëm kur e vuri re se nuk kishte pranë ndonjë nga të uzinës, e ndjeu veten disi më të qetë. U mblodh kuspull në një fron dhe mbështeti ballin në xhamin e freskët. Kokën e ndjente të turbullt, kapakët e syve, të rëndë. Zërat e pasagjerëve i duke-shin të largët, bota që vështronte, ireale. Sikur gjithshka ndodhte rë film.

Dëshironte që autobuzi të ecte sa më shpejt dhe ta çonte diku larg, larg gjithshkaje. U mundua ta hidhte mendjen gjatë. Nisi të numërojë apartamentet, pastaj makinat që kalonin përbri. Më kot. Mendimet, me një kryeneçësi të çuditshme, i riktheheshin më të forta, më shqetësuese.

Ai që mësuar të dilte nga mbledhjet me kokën lart, që mësuar të dëgjonte fjalë të mira, lavdërimi dhe rrallë, shumë rrallë ndonjë kritikë, të cilën e pranonte sakaq, medje e nënvizonte kur merrte fjalën.

Asnëherë s'i që trembur vështrimit të shokëve, si këtë radhë.

Pesëmbëdhjetë shokë kishin folur për të. Të pesëmbëdhjetët e kritikuan. Në fillim e mbajti veten, i dëgjoi me kokën lart, po pastaj i erdhi rëndë, ndjeu se po skuqej, po dirsej dhe uli sytë.

Në ato çaste sesi i pat shkrepur në kujtesë

një rast i largët nga jeta shkollore kur mësonjësi e kishte pyetur në befasi dhe ai, nxënësi i shkëlqyer, s'kish ditur të përgjigjej. Por ajo s'ishte gjë përpara kësaj. Për të parën herë i ranë djersë të ftohta, për të parën herë iu muar goja, kur u ngrit të flasë.

...I dukej sikur i dëgjonte akoma fjalët e shokëve. Në kujtesë i endej oshëtima e tyre. Sidomos i qenë ngulitur fjalët e xha Vasilit:

«... Ju e kritikuat rëndë Petron. Mirë ja bëtë. I duhej. Por unë do ta kritikoj akoma më rëndë. Kam sepse. Ne njihemi prej kohe, apo jo, Petro? Kur erdhe së pari. në uzinë, ti ishe ende çunak, kurse unë mbahesha mirë dhe s'guxonte njeri të më propozonte për pension, si tani. Ne bashkë kemi kaluar ditë të vështira, kur edhe bukë harrohim të hanim nga puna e shumtë. Ne kemi gdhirë bashkë kushedi sa net, duke montuar makineritë dhe kemi ndarë përgjysëm cigaren e fundit. Të kam parë me sy të skuqur dhe qepalla të fryra nga pagjumësia, por me bebëza plot dritë. Të kam parë t'u vësh shpatullat arkave të makinerive dhe të shtrëngosh dado krahas me ne, gjer sa të gjakoseshin duart.

Unë, ne krenoheshim me ty. Me të drejtë krenoheshim, me të drejtë të pranuar në rradhët e Partisë dhe, me të drejtë të vumë atje ku je sot. Jo për mirënjohje, jo, por të bindur se e meritoje, se ishe më i përshtatshmi. Bir mekaniku, i rritur me njëmijë mundime, i mësuar, i papërtuar, gjithë të mirat i kishe.

Për shumë kohë ti nuk i zhgënjeve shpresat tona, por pastaj.. pastaj u largove dalëngadalë prej nesh, madje edhe nga unë që dikur më quaje si

baba. Fillove të dukesh gjithmonë e më rrallë në për reparte, përtoje t'u thoshje njerëzve «mirë-mëngjesi», flisje së larti, zemëroheshe me ata që nuk i zbatonin symbyllur urdhërat e tua. Të dukej sikur dije gjithshka, sikur ish i pagabueshëm! Ke bërë njëmijë pelivanllëqe për ta realizuar sa më lehtë planin, gjoja në interes të uzinës dhe ke harruar se interesi i vërtetë i uzinës është të prodhojë shpejt, mirë dhe lirë ato që i nevoiten popullit. Ja, kështu, Petro, nise t'i shtëmangesh shtegut të vështirë që të nxjerr në majë dhe anove gjithmonë e më shumë nga ai tjetri, që shkon tërthorazi. Mbetë në krye, por në vend që të prish, të shtyjnë.

Pse ndodhi kjo? Kujtove se kishe dhënë boll, se ishe lodhur boll dhe se paskëtaj u përkiste të tjerëve të kërrusnin shpinën, kurse ti vetëm të urdhëroje, të komandoje dhe të korrje lëvdata. Harrove se vendi që të dhamë ishte një barrë më e rëndë nga ajo që kishe dhe jo një kolltuk lavdie e rehatllëku. Ti je biri ynë, i njerëzve me duar të tilla, të ashpra ti je komunist dhe s'të përket ajo rrugë që ke zënë, s'është rruga jote! As forcat të janë mbaruar, as zgjuarsia dhe aftësia të mungojnë. Vetëm se e pe veten lart dhe t'u morën mendtë. Të mori në qafë krenaria e tepërt, egoizmi.

Prindit i dhëmb kur godet birin, por e godet kur duhet, për të mirën e tij. Ne të godasim se duam që të shkundesh, të vish në vete...»

... Petrua u kujtua se kishte mbërritur në stacionin e fundit, kur zbritën gjithë pasagjerët. Brofi në këmbë dhe zbriti me nxitim. Vështroi orën. Gjashtë. Ku të shkonte gjetkë, veçse në shtëpi? Nuk i hipi përsëri autobuzit. Vendosi t'i



bënte në këmbë ato dy stacione që kishte kapërxyer.

Ecte i hutuar, pa vështruar as majtas, as djathtas. Dikë shkeli rregullat e qarkullimit dhe dëgjoi pas bilbilin e rreptë të policit, dikë tjetër sa s'u përplas me një grua që mbante në duar disa qelqurina. Arriti shpejt në shtëpi.

Pothuaj nuk iu përgjigj përshëndetjes së Anit dhe shkoi e u lëshua në divan. Mbështeti kokën në mur dhe i nguli sytë në tavan. I buçisnin ende në veshë fjalët e mbledhjes.

— Do një kafe? — e pyeti me merak Ani, që e kishte vënë re shqetësimin e tij.

— Ma bën.

Ajo mori xhezven njëshe, tereziti sasinë e kafesë dhe të sheqerit, se Petrua e donte të rëndë dhe me pak, sidomos kur ishte i lodhur, pastaj e vuri të ziej mbi furnelën elektrike.

— Si dolët në mbledhje? — pyeti me ndrojtje, ndërsa po përziante kafën.

— Më kritikuan rëndë! — tha Petrua, duke thithur me afsh cigaren.

— Vërtet? Ç'thua, more! — Ajo e lëshoi lugën dhe ra mbi fron, sikur t'i kishte kositur njeri këmbët.

— Më dhanë një dajak që më këputën kër-bishtet! — vazhdoi ai.

— E pse?

Petrua ja tregoi shkurt.

Ajo e dëgjonte si e shastisur. Nuk e vuri re kafënë që u fry dhe u derdh. Tek deshi ta shpëntonte, e derdhi më keq dhe guzhina u mbush me tym. Me duar të dridhura çeli dritaren, pastaj mbushi xhezven dyshe. I qe krijuar sakaq një

boshllëk në lukth dhe mendoi se kafja do t'i bënte mirë.

— Eh, si ta punuan! — tha pastaj, me një zemërim të mbytur. — Ty, që ke punuar gjithmonë si kalë! Si duket, duan të sjellin ndonjë tjetër në vendin tënd dhe kërkojnë shkak.

— Jo.

— Atëhere, do ta ketë kurdisur ndonjë nga ata që ta kanë cmirë.

— Jo! — përsëriti ai, me nervozizëm.

— Po pse, atëhere?

— Sepse unë nuk jam në rregull!

Ajo mbeti si e ngrirë. Me duart të kryqëzuara në prehër dhe me atë pamjen e trembur e të përvojtur, i ngjante një ikone.

— Derëzi, mos të të transferojnë! — tha, me një fije zëri.

— Mundet, por kjo s'është kryesorja!

— Si s'është! Mezi u rregulluam dhe tani...

— Zjeu kafja? — ja preu ai. — «Sa u tremka se mos humbasi këtë copë rehat!» — mendoi.

Ajo i mbushi filxhanët me duar të dridhura, ja vuri njerin përpara dhe u ul përballë tij. Rufisi me ëndje kafen që sikur ja mbushi boshllëkun e lukthit.

— Po ti, fole? — guxoi pas një copë here.

— Fola.

— Ç'the?

— Ato që mu duk se duheshin thënë.

— Bëre autokritikë, të paktën?

— Merre filxhanin! — tha ai me zemërim dhe thithi fort cigaren.

Kishte filluar të errej dhe ata mezi e shquanin njëri-tjetrin, kurse maja e cigares skuqte gjith-

një e më dukshëm. Të dy e ndjenin veten më mirë në atë gjysëm errësirë, prandaj asnjëri s'u kujtua të ndizte dritën. Heshtnin, secili me medimet e tij.

Në ato çaste, më fort se kurdoherë, Petrua ndjeu nevojën për një njeri të afërt, që ta kuptonte, me të cilin të ndante hallet dhe shqetësimet, me ndihmën e të cilit të kthjellonte mendimet. Për të parën herë, pas tre vjet martesë, ai u ndesh fort në murin që e ndante prej Anit. Dhimbja e kësaj goditjeje iu shtua asaj tjetrës.

Ju duk sikur muret e guzhinës po e ndrydhnin, sikur errësira po i depërtonte përbrenda vetes. Brofi në këmbë.

— Po dal! — tha dhe u drejtua nga dera.

— Mirë! — psherëtiu Ani dhe nuk luajti nga vendi.

Ai i zbriti me nxitim shkallët dhe përshkoi me hap të shpejtë rrugën gjer tek stacioni i autobusave. Aty u step. Ku të shkonte? Në kafene? Jo, kurrësesi! Ku atëhere, tek ndonjë shok? Tek cili? Kush i kishte mbetur nga shokët e ngushtë të dikurshëm?

Ecte pa qëllim drejt qendrës së qytetit, duke vështruar pllakëzat e trotuarit dhe majat e këpucëve të tij.

Ishe ora kur qytetarët dalin për shëtitjen e mbrëmjes. Rrugët po mbusheshin plot dhe gumëzhitja e qytetit po shtohet. Ajri që i freskët dhe në të ndjeheshin kundërmimet e natës së qershorit.

Dikush lëshoi përpara Petros një bërthamë pjeshke. Ishte një fëmijë. Petrua e shtyti në rrëzë me majën e këpucës. Pastaj u kujtua se pjeshkët i pëlqenin shumë Florës.

«Vallë, ç'bëhet ajo?» — mendoi. — «Sa kohë

kam pa e parë! Çudi, si ndodhi kjo! Dikur bëja qindra kilometra për ta takuar, kurse tani në një qytet dhe... Ishim aq të dashur dhe të afërt me njëri-tjetrin, për çdo gjë këshilloheshim bashkë, bisedonim. Nuk ishim vetëm vëlla e motër, por edhe shokë. Kurse tani... Eh, jetë o jetë, sa e ndërlikuar qënke!... Po sikur të vete ta takoj? Fundja, gjaku ujë s'bëhet, motër e kam. Sikur të më presi ftohët, në s'më daltë fare? Një dhëmbje më shumë. Jo, mjaft i kam. Megjithëse nuk e bësoj të sillet ashtu. Ajo ka qenë gjithmonë e dashur me mua. Edhe në ju duktë se i përulem, punë e madhe, në vllzëri s'vihen re këto. Aq më tepër se unë jam fajtori, po, unë jam. Le të bëhet si të bëhet, do vete!»

Si e mori këtë vendim, Petrua e ndjeu veten më të lehtësuar. Një fije gëzimi rodhi në bren-dësinë e tij. Drejtoi trupin, sikur shkundi diçka të bezdisshme nga supet dhe mori nga rruga e Elbasanit.

«Si, të shkoj kështu, duar bosh?» — u kujtua dhe pa për ndonjë pemëshitës.

Ca më tej dalloi vitrinën e ndriçuar të një dyqani «Fruta-zarzavate.» Qëndroi përballë saj dhe kërkoi me sy.

«Sa mirë, paska pjeshkë që i pëlqejnë asaj!» — mendoi.

— Të lutem, peshomë një kile! — e porositi plakun e ngjallmë që rrinte pas tezgës. Pagoi dhe doli me qesen prej letre në dorë.

Përbri tij ecte një trumbë e gëzueshme studentësh. Ata bisedonin për sportin, bënin shaka, ngacmonin njëri-tjetrin dhe qeshnin me të madhe. Petrua kujtoi me nostalgji kohën kur edhe ai qe-

shte kështu, i shkujdesur, kohën kur jeta i dukej pothuaj përherë e bukur dhe gjithë ëndërrimet të realizueshme. Duke pritur në udhëkryq që të kalonte një makinë, u bashkua me trumbën e studentëve dhe për një çast, vetëm për një çast, provoi një ndjerijë të çuditshme. Ju duk sikur koha u kthye menjëherë prapa dhe ai po rijetonte diçka të jetuar, të njohur.

Tek porta e jashtme e konviktit të vajzave, si gjithmonë kishte vizitorë, shumica djem. Petrua lajmëroi me dikë për Florën dhe priti. Pas një copë here doli një studente e imët, më syze.

— Kush e kërkon Florën? — pyeti ajo, duke vështruar përreth.

Petrua doli nga errësira dhe iu afrua.

— Ah, ju?

«Si duket më një!» — mendoi Petrua.

— Më vjen keq, por nuk ndodhet në konvikt!  
— tha ajo.

«Ose nuk do të dali!» — mendoi me dhëmbje ai.

— Ka më se një orë që ka dalë! — theksoi studentja, që e vuri re dyshimin e tij.

— Ju lutem, jepjani këtë! — tha Petrua, duke i zgjatur qesen me pjeshkë. — I thoni se e kërkoja. Jam...

— I vëllai, në mos gabohem! — e plotësoi ajo.

— Po. I thoni se kam nevojë për të. Po deshi, le të vijë.

— Mos kini merak, do t'i them. Më vjen keq që nuk e gjetët.

— Natën e mirë! — tha Petrua dhe iku.

I shterri edhe ajo fije gëzimi që pat. U ndie i vetmuar, aq sa i erdhi keq për veten. Mendimet

filluan t'i gëlojnë përsëri, të shkëputura, të turbullta, pa ndonjë lidhje logjike ndërmjet tyre. Vetëdijen e kishte si të mpirë. Çdo gjest, çdo lëvizje e bënte mekanikisht.

Vështroi orën dhe ngadalësoi hapat. Jo, nuk do të kthehej në shtëpi kaq herët. S'kishte qejf të vështronte fytyrën e pezmatuar të Anit dhe as të dëgjonte ankimet e saj ndaj jetës dhe shoqërisë.

Hyri në një berrari të vogël, ajri i së cilës qe i rënduar nga frymët e klientëve, tymi i duhanit dhe errërat e guzhinës. Qëndroi në këmbë pranë banakut dhe kërkoi një krikëk berrë. Kur e vuri në buzë, kuptoi se ishte i etuar. E piu me fund dhe porositi një tjetër. Ndezi cigaren, e thithi me afsh dhe nisi të pijë me gllënjka gotën e dytë. Pastaj pagoi, doli dhe nisi të endej pa qëllim nëpër rrugët e qytetit.

Ora ishte pothuaj dhjetë kur arriti pranë shtëpisë. Tek hyrja e shkallës pa dy silueta, njëra prej të cilave iu duk e njohur.

«Motra!» — tha me vete dhe nxitoi hapin.

— «Po, ajo qënka!»

Njera nga siluetat u largua, kurse tjetra eci drejtë tij.

Flora ja zgjati e para dorën.

— Mirëmbërëma, Petro!

— Erdhe? — tha ai dhe nuk diti ç'të thotë tjetër. Ja shtrëngoi fort dorën dhe u ndie i mallëngjyer.

— Si të mos vija! — tha ajo. — Madje u shqetësova shumë.

— Kemi kohë pa u parë, motër!

Ai vazhdonte t'ja mbante dorën në të tijën.

— Po, kemi.

- Si ke qënë?
- Mirë, po ti?
- Hiç mirë, për të mos thënë keq!
- Pse kështu, vëlla?
- As unë nuk e di mirë pse. Do bisedojmë.

Ec të ngjitemi lart.

— Është vonë dhe më mbyllet konvikti, tjetër herë vij! — tha Flora, e zënë ngushtë. — Po deshe, ecë e më përcill. Rruga është e gjatë dhe kemi kohë të bisedojmë.

Mirë, si të duash. Ke shumë që më pret?

— Jo dhe aq. Nja gjysmë ore.

— Vetëm ishe?

— Jo.

— Kush të përcolli, Arbeni?

Flora u çudit. Për të parën herë e dëgjonte këtë emër nga goja e të vëllait.

— Po, — tha pastaj.

— Ai që iku ishte?

— Po. S'të prisja dot vetëm.

— Ashtu është. Erdhët e më pritët, megjithëse jam sjellë keq me ju! — pëshpëriti ai, sikur fliste me vete.

Ajo u çudit akoma më shumë.

Petrua e zuri për krahu dhe dolën në rrugë, e cila tani ishte pothuaj e shkretët.

— Ç'të ka ndodhur, vëlla? — pyeti Flora me padurim.

— Vërtet, ç'më ndodhi kështu? — tha ai, sikur pyeste vetveten.

Kërkoi në xhep paqetën e cigareve, ndezi një dhe mbasi e thithi fort, nisi të flasë. Rrëfeu gjithë ç'i kishte ndodhur, gjithë mendimet, ndjenjat, dyshimet, shqetësimet që i vlonin përbrenda,

pa i zgjedhur, pa i renditur, disa të kjarta e disa të turbullta, ashtu siç i vinin.

Fliste ngadalë, me zë të ulët, me një zë që dukej sikur dilte nga thellësia e brendësisë së tij të plagosur. Shpesh vinte dorën mbi gjoks, me gishtërinjtë të kthyer në trajtë kthettrash, sikur donte të arrinte zemrën dhe të zhgulte së andejmi diçka të ligë që e mundonte.

Duke treguar, ai ndjente se po i lehtësohej dhembja, ashtu siç lehtësohet dhembja e një plage të maisur, kur shpërthen qelbin.

Flora e dëgjonte kokulur. I vinte keq, por edhe gëzohej. Gëzohej sepse në vend të atij vëllait të vetkënaqur, me dukje krenare e të sigurtë, por që e brente vazhdimisht e keqja, tani kishte pranë një vëlla që vuante dhe përpëlitej, por që e ndjente të keqen e vetvetes dhe ishte ngritur kundër saj. Gëzohej sepse tashmë që shëmbur ai muri që i kishte ndarë shumë kohë dhe ata ishin përsëri miq, shokë.

Ajo e ndiqte me vëmendje e dhembshuri tregimin e tij dhe mendohej ta ndihmonte, ku me një pyetje, ku me një fjalë, ku me një mendim.

Pasi i derdhi gjithë ç'kishte përbrenda, Pëtrua heshti, duke e vështruar të motrën me ankth. Ajo e kuptoi ç'priste ai, e kuptoi sa rëndësi kishin fjalët që do t'i thoshte, prandaj u mendua një hop, duke i bërë thirrje gjithë intelektit të vet. Pastaj ngriti sytë, dy sy plotë dritë e besim dhe i tha:

— Po, vëlla, vështirë e ke të dalësh nga ajo që ti vetë e quajte baltovinë. Ndoshta do të duhet që diku të kthehesh prapa, diku tjetër t'ja fillosh përsënjëzaj, por s'ka gjë, ti do t'ja dalësh mbanë. Si vëlla që të kam, ta njoh karakterin, t'i di for-



cat. Ti ke shumë forca, Petro, pastaj nuk je vetëm dhe do t'ja dalësh mbanë, shpejt bile.

— Ashtu qoftë! — tha ai dhe psherëtiu nga thellësia e kraharorit.

16

Dëgjohej si gulçonte toka nga goditjet e kazmave dhe si fërfërinte dhe kur flakej nga lopatat, përtej piketave të bardha. Tarraca mernte trajtë dalëngadalë. Një pluhur i imët ngrihej vazhdimisht së poshtëmi, ngjitej në trupat dhe fytyrat e dirsura të aksionistëve duke sajuar vraga, zbardhte vetullat, qepallat dhe kërciste në gojë.

Dielli i Korrikut derdhte me bollëk dritë dhe nxehtësi mbi tokën e thatë, mbi bustet lakurige të djemve, mbi bluzat e lehta të vajzave, mbi kapelet e kashta me sprethe të gjëra dhe mbi detin që shkëlqente madhërisht atje poshtë.

Arbeni ngriti kazmën sa munda dhe goditi fort me majën e saj. Ajo u ngul me një zhurmë të mbytur dhe ngeci.

— E marrtë dreqi, përsëri zuri në dru! — mallëkoi ai, duke u munduar ta nxirrte.

— S'e shkul dot vetëm! — tha Ibrahim. — Nuk e shikon ç'rrënjë e madhe që është! Ec ta provojmë së bashku.

Ata rrokën kazmat dhe iu përveshën punës. Pranë tyre Flora dhe Rina qëronin dheun me lopata.

— Hiquni më tej, se mos ju godasim! — tha Ibrahim. — Pritni të gërmojmë ca.

Ato u bindën. Flora përfitoi nga rasti dhe

rregulloi në kokë shaminë e aksionisteve, kurse Rina u mbështet në bishtin e lopatës dhe fshiu djersët me kurrizin e dorës. Dukej e lodhur.

Si ndjehesh sot? — e pyeti Flora. — Të janë marrë përsëri mendtë.

— Jo, jam fare mirë. Kushedi pse ndodhi dje.

— Ti punon më shumë nga ç'ke fuqi, Rinë! e qërtoi shoqja.

— E ç'punoj unë! — tha ajo me një buzëqeshje të thjeshtë. — Ja, këta punojnë! — Dhe tregoi me kokë nga shokët.

Flora ktheu vështrimin andej. Ata gërmonin me duf. Tek ngrinin dhe lëshonin kazmat, muskujt iu ndëreshin dhe tkureshin, duke marrë trajta të hijshme. Lëkura e nxirë dhe e njomur u shkëlqente butë, si kadife. Fytyra u qe veshur me bulëza djerse që bashkoheshin me njëra-tjetrën, u rridhnin nga rrëza e vetullave nëpër faqe, u pikonin nga maja e hundës, u lëpuheshin në qafë, në zverk, përgjatë shpinës dhe mbi gjoks.

— Të heqim dheun një herë! — ndërhyri Flora, duke u afruar me lopatën në gadishmëri.

— Ju çlodhuni pak. Shikoni si jeni bërë!

— Mirë, hiqeni! — tha Ibrahim.

Ato filluan të punojnë me shpejtësi, si të molepsura nga vrulli i shokëve.

— Ç'etje që kam! — tha Arbeni. — Ka mbetur ujë në pagure?

— Jo, por tani duhet të arrijë «këmbëshpejti!» — tha Flora, pa e ngritur kokën.

— Akullloreee! — briti dikush, me shaka.

— Kasataaaa! — ja priti një tjetër.

— Plaçi! — mallëkoi një i tretë.

Arbeni lëshoi kazmën, fshiu djersët me llërë

dhe u ul në pjesën e pagërmuar. Soditi me ëndje Florën tek punonte. Ajo shkelte zbathur mbi plisa, ngjeshte lopatën në dheun e gërmuar dhe pastaj e flakte përtej piketave, me ritëm të shpejtë dhe të barabartë. Pluhuri i qe ngjitur në pulpa, në llërë dhe në fytyrë, duke ja errësuar edhe më tepër ngjyrën e bronxtë të lëkurës. Nga shamia e aksionit, që kishte lidhur në kokë, i dilnin ca cullufe rrebele ngjyrë kalliri, që hovnin me ritmin e lëvizjes së lopatës. Buzët e njomura, në ngjyrën e qershive të pjekura mirë, i mbante gjysëm të çelura. Për një çast ajo drejtoi trupin dhe fshiu ballin me gishtin tregues, të kthyer si kosore. Ca pikla djerse ranë mbi plisa, duke lënë gjurmëza rrumbullake bojë kafe.

Arbeni do dëshironte t'ja fshinte më pëllëmbët e tij djersën dhe t'ja përkëdhelte ato cullufet e arta rrebele. Buzëqeshi me këtë mendim, se u kujtua që pëllëmbët i kishte të ndotura. Pastaj i vajti mendja tek letra që priste nga prindërit. Ja, ditët e aksionit po mbaronin, kurse përgjigjia ende s'po vinte. Ai ishte i sigurtë se prindërit do të pranonin, madje me gëzim të madh, por megjithatë e priste me ankth letrën e tyre.

— Urraaa, arriti «këmbëshpejti»! — brohoriti Ibrahimimi.

Një djalosh i gjatë, i ngarkuar me bidona, po i ngjitej me shkathtësi kodrës. Ai ndalej pranë çdo grupi dhe së largu dukej ujët tek rridhtë si një fjollë e ndritshme në paguret që zgjatnin aksionistët. Duke e vështruar, Arbeni lëpiu buzët.

Pas pak «këmbëshpejti» arriti edhe pranë tyre. Rina dhe Flora nxituan me të katra paguret në duar.

— Me kujdes, mos derdhen! — thirri ai, duke anuar bidonin.

Djemtë i zbrazën paguret drejt e në gurmaz dhe rrëmbyen kazmat.

— Ec t'i japim dërmën e fundit, se po mbaron dita e punës! — tha Ibrahim, duke vështruar diellin që tani binte pingul.

— Uh-uh, uh-uh! — filluan të ofshajnë, duke goditur me kazëm.

— Hëni, më ju lumçin krahët! — i përshëndeti «këmbëshpejti»; rrëmbeu bidonin dhe iku me nxitim.

— Uh-uh, uh-uh!

Nga rrënja shkëputeshin copa dheu, të mpleksura me fije të holla.

— Mjaft u gërmua. Sikur ta provonim me leva? — propozoi Arbeni.

— E provojmë! — tha Ibrahim. — Çupa, futni edhe ju lopatat. Ashtu. Prisni shënjën. Gatil!

— Ho-hop, ho-hop!

Rrënja lëvizi nga vëndi, duke kërcitur.

— Ho-hop, ho-hop!

U dëgjua një krismë më e fortë dhe blloku i madh u shëmb mënjanë, duke u çarë vende-vende.

— Urraaa! — brohoritën që të katër.

Lëshuan një hop veglat dhe soditën rrënjën e shkukur. Në të çarat e bllokut dukeshin një mori fijezash e rrënjëzash të këputura.

— Kushedi sa vjet ka qëndruar në tokë, pa është bërë kaq! — tha Arbeni.

— Ç'pyet!

I futën përsëri kazmat e lopatat përfund rrënjës dhe pas pak ajo u rrokullis mëtëposhtë, duke lënë pas një gropë të madhe.

— Tani forca të sheshojmë vendin! — tha Flora dhe nisi të mbushë gropën.

Pas pak gropa u bë një me sipërfaqen e terracës.

Ndërkohë u dëgjua shënja e mbarimit të punës. Për një hop u bë qetësi. Pastaj një mërmëritje përshkoi kodrën. Aksionistët mblidhnin plaçkat, hidhnin veglat e punës në sup dhe zbrisnin mëtëposhtë grupe-grupe.

Grupet bashkoheshin me njëri-tjetrin, duke formuar një rrjedhje të fuqishme, të gjallë, të gëzuar. Trupat ngjyrë bronxi, bluzat shumëngjyrëshe, kapelat e kashta, shamiat laramane të aksionit, tehet e kazmave e të lopatave, ndritnin hareshëm nën diellin e fortë.

Buçiti kënga, vërstnike me ata që e këndonin:

*Haj t'punojmë  
Djersët le t'kullojnë,  
Se ndërtojmë  
Njeriun e ri.*

Kjo këngë, duke u bashkuar me muzikën e alto-parlantëve të kampit, llapashitjen e valëve të detit, thirrjet entuziaste dhe me zërat e panumërta të asaj dite vere, formonte një hymn ngazëllenjës.

— Unë po shkoj drejt e në det! — tha Arbëni, sa arritën pranë çadrave.

— Edhe unë! — tha Ibrahim. — Zhvishemi në breg.

— Më prisni edhe mua! — i luti Flora. — Ja, erdha, sa të vesh rrobet e banjës.

Pas pak u ndalën që të tre në breg të detit, ku ishin dhjetra aksionistë të tjerë.

Flora bëri disa hapa dhe ra me not. Godiste fort me krahë ujët, sikur donte ta mposhte, vështronte bulëzat që krijoreshin nën pëllëmbët e saj dhe ndjente qysh çante përpara, ndërsa vrobujt e ujit i rrëshqisnin përgjatë trupit, duke i sjellë dridhje dhe freski të këndshme.

Dikur mori hov dhe u zhyt. Pa gurët e mëdhenj të fundit, të mbuluar me leshterikë që sikur donin a kapnin me fijëzat e tyre të blerta transparente, një peshk të vogël që dredhoi mes tyre, çà molusqe të qullëta, një njollë të errët dhe me gjithë ndrojtjen që i ngjallte kjo botë e panjohur, nuk u shkëput prej saj veçse kur pati nevojë për ajër. Doli në sipërfaqe dhe u ngop me frymë. Vështroi nga bregu. Shkëmbejti e hirtë, çadrat dhe njerëzit që lëvrinin pranë tyre dukeshin të vegjël.

— Ej, unë po kthehem! — u thirri shokëve.

«Sa mirë, sa mirë që është!» — mendonte, duke u rrëkëlyer nëpër valë.

Kur doli në breg, ndeshi me Hajrien që vërtitej aty ecë e jak, fuste pak këmbët në ujë dhe pastaj tërhiqej.

— S'ma mban! — mërmëriti kur pa Florën. — Kam frikë nga iriqët e detit!

— Sa më shumë t'u ndruhesh, aq më keq e gjen prej tyre! — qeshi ajo dhe rendi drejt çadrës.

Shkoi tek vëndi i saj dhe u vesh. Ndërsa po krihej, sodiste ambientin e çadrës, që i dukej aq i dashur dhe familjar. Shoqet ndërroheshin, bisedonin, qepnin, lexonin ose çlodheshin në ato shtrojet e sajvara me batanije mbi kashtë dhe të renditura varg, përgjatë anës së çadrës. Në faqet e saj ishin varur një mori laramane bluzash, fusta-

nesh, ndëresash e peshqirësh, diku qe kapur me gjilpëra një fotografi e nxjerrë nga revista «Ylli», diku tjetër, mbi një valixhe, qe vendosur një gotë plastike me një tufë lulesh të egra në të. Gjithëshka ishte kredhur në dritën verdhacuke që depëronte nëpërmjet dokut të çadrës.

Flora ndjente një mpirje të ëmbël të gjymtyrëve, por nuk u shtri, se aty bënte vapë. Doli përsëri në bregdet, u ul nën strehishten e mensës dhe mbështeti shpinën tek njëra nga shtyllat e drunjtat të saj.

Përballë dukeshin çadrat e gjata të banimit, rreth të cilave lëvrinin aksionistët. Në një cep, pas tyre, disa po lanin. Më tej, disa të tjerë qenë mbështjellë grumbull dhe po lexonin gazetën.

Qëndra e zërit ndërpreu muzikën dhe lajmëroi emrat e atyre që u kishin ardhur letra. Flora nuk ja vuri veshin. Dy ditë më parë kishte marrë një kartolinë nga vëllai dhe s'priste letër nga tjetër kush.

Duke kujtuar kartolinën, ajo filloi të mendojë për Petron.

Mbas asaj dite që ai e kishte kërkuar në kornvik, qenë takuar shpesh dhe kishin biseduar gjatë me njëri-tjetrin. Në fillim ai e pati shumë të vështirë; hezitonte, dyshonte, ishte i pa qëndrueshëm në mendime, nuk dinte si të sillej, si të vepronte dhe vuante. U dobësua shumë, aq sa mori trajta fëminore; e kishte humbur sigurinë e dikurshme në vetvete, madje dukej i ndrojtur, por ndërkohë ajo vërente me kënaqësi qysh i kthjelloheshin mendimet, qysh i shkoqeshin ato vetijat e huajtura, qysh ai po kërkonte vetveten.

Një ditë Petrua i tha se kishte bërë lutje të kalonte në një uzinë të re, e cila po ngrihej me rezervat e brendëshme të disa ndërmarrjeve. Sigurisht që atje do të kishte shumë punë se makineritë ishin të përdorura dhe duheshin adoptuar, se proceset e prodhimit ishin të reja dhe të panjohura për të, por të gjitha këto do kapërxeheshin.

Ajo kishte dalluar në zërin dhe vështrimin e tij po atë gëzim të singertë, po atë vendosmëri, po atë entuziazëm rinor që e karakterizonin dikur dhe që bindur se i vëllai e kishte gjetur vetveten.

Në vigjiljen e nisjes së saj për në aksion, Petrua e kishte ftuar për darkë. Gjer atëhere ajo u qe shtëmangur me takt ftesave të tilla, sepse në ato pak vizita që u kishte bërë, sa për të mos i prishur qejfin vëllait, kishte ndjerë se Ani ushqente për të një armiqësi të heshtur. Megjithatë ftesës së fundit nuk iu shtëmang dot dhe vajti.

Ani e priti mirë në dukje dhe shtroi një darkë të pasur, por veç gjellëve, nuk pati asgjë të ngrohtë në atë darkë. Përpjekjet e Petros për të krijuar gjallëri dështonin dhe biseda lëngonte, duke kaluar nga një temë në tjetrën. Kur ra fjala për kërkesën e Petros që të kalonte në uzinën e re, si përgjegjës reparti, Ani pati një drithmë nervoze të fytyrës dhe menjëherë ktheu kokën në anën tjetër.

Gjatë asaj darke Flora kishte ndeshur shumë herë vështrimin e ftohtë të së kunatës dhe kishte ndjerë përbuzjen e saj pas mirësjelljes së tepëruar, madje edhe në mënyrën sesi ja mbushte plot pjatën. Hëngri sa për të mos fyer Petron dhe foli aq sa të mos mbetej e heshtur. Ajo nuk shtirej dot.

Duke kujtuar atë mbrëmje, Flora mendoi sa të



vështirë do ta kishte i vëllai për të zgjidhur problemin e familjes së tij. Tani që ai e kishte gjetur vetveten, pa tjetër do të ndeshej me botëkuptimin e ndryshëm të së shoqes dhe do ta ndjente gjithmonë e më fort gabimin që kishte bërë, duke ndër-tuar një familje të atillë.

Vallë, si do ta zgjidhte Petrua këtë problem? A do të mundej ta kthente edhe Anin në rrugën e tij, apo do ta vuante gabimin e bërë, duke duruar pranë vetes një bashkëudhëtare të thjeshtë, apo do ta zgjidhte këtë nyje me shpatën e Damokleut?

Ajo mendonte se tani Petrua ishte i aftë për ta gjetur vetë zgjidhjen më të përshtatshme dhe se asai nuk i takonte të ndërhynte në asnjë mënyrë. Prandaj kishte vendosur të mos e pranonte ftesën e tij për t'i kaluar tek ata pushimet e verës. Nuk i qe përgjigjur ende kartolinës, por do t'i përgjigjej sa të vendoste përfundimisht se ku do t'i kalonte pushimet.

Mendimi i parë, për të punuar në kantierin ku kishte qënë gjersa të fillonte viti i ri akademik, i dukej më i miri. Në konvikt nuk mund të kthehej para asai kohe, sepse atëhere Petrua do të ngul-te këmbë që të banonte tek ata. Në rrethanat e krijuara, ajo do të ishte e tepërt atje, në mos e dëmshme.

Një hije që u afrua dhe ndaloi pranë saj, e shkëputi Florën nga mendimet. Ngriti kokën dhe pa Arbenin që po e vështronte me buzë në gaz.

— Paske gjetur vend të mirë! — tha ai, duke u ulur pranë saj.

Nuk rrihej në çadër, bënte vapë! — tha ajo.  
Arbeni futi dorën në xhep dhe nxori një zarf.

— Mora letër nga prindërit! — tha:

— Sa mirë! — u gëzua ajo. — Janë shëndoshë, besoj. Do t'i ketë marrë malli !

I sëmboi, duke menduar se atë s'kishte kush ta priste me një mall të atillë.

— Na presin të dyve! — tha Arbeni.

Florës iu duk sikur nuk dëgjoi mirë dhe ktheu kokën nga ai, e habitur. Atëhere i njohu në sy një gëzim të madh dhe e kuptoi se kishte dëgjuar saktë. Sakaq iu mblodh një xhëng në gjoks dhe riktheu përnjëherësh vështrimin nga deti, për të fshehur mallëngjimin.

— Prindërit dëshirojnë të të njohin sa më parë! — vazhdoi ai. — Dhe të lutem që t'i kalosh në familjen tonë pushimet e verës.

Ajo kishte picëruar sytë dhe vështronte atje tek bashkohej kaltërsia e lëvizshme e detit me kaltërsinë e palëvizur të qiellit. Në ato çaste i dukej sikur e brendshmjaja e saj ishte një copë e asaj kaltërsie të ndritëshme.

— Pranon, apo jo? — e pyeti Arbeni me ankth, sado që kishte qenë i bindur se ajo do të pranonte.

Flora nuk foli se ndruhej mos i dridhej zëri. Vetëm tundi kokën në shënjë pohimi.

— Do ngelesh e kënaqur, ke për të parë! — vazhdoi ai, i ngazëllyer. — Prindërit e mi janë njerëz të mirë. Ata do të të duan fort. Shiko se ç'më shkruajnë! — Nxori letrën nga zarfi, e shpalosi para syve të saj, tregoi diku me gisht dhe lexoi: — «Thuaji asaj, i dashur djalë, se ne do ta presim me krahë hapët dhe do ta duam si bijën tonë...»

Flora vështroi një hop ato radhë të shkrua-

ra me germa të mëdha e të pasigurta, por sakaq gerrat iu mjegulluan dhe ndjeu se po i njomeshin sytë. Mbështeti kokën në shtyllën e drunjtë dhe pati nevojë të mbushej me frymë. Shtriu dorën, gjeti atë të Arbenit dhe e shtrëngoi fort. Ai e kuptoi dhe heshti.

— Megjithatë, më vjen keq që do ndahemi nga aksioni! — tha pastaj. — Vështro sa bukur që duken! — Shtriu dorën në drejtim të kodrave, faqet e të cilave ishin të brazduara nga tarraca, që, nga larg, dukeshin si breza të kafejtë paralele.

— Ne i bëmë! — tha Flora, me një farë krevarie. — Atje ku derdhëm djersë, do të lulëzojnë një ditë portokallet.

Ajo soditi një copëherë kodrinat dhe i pa me sytë e mendjes ashtu siç do të ishin në të ardhshmen. Pastaj mbështeti rishtazi kokën tek shtylla dhe u lëshua në prehrin e ndiesive.

Dëgjonte një larmi gazmore tingujsh e zërash, të cilat sikur i kumbonin në thellësinë e vetvetes. Nuhaste me ëndje aromën e detit, kundërmimin e athët të strehishtes prej fieri dhe erën e gjellës që po e ndanin në pjata. Ndjente nën vete afshin e ngrohtë të tokës dhe i dukej sikur i kishte rrënjët thellë në të. Vështronte kreshtat e ndritshme të valëve dhe i bëhej të vraponte drejt tyre, duke thirrur:

— Sa bukur është të jetosh!

Biblioteka personale

B. Tushe № 68